

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI III (XVII) 2015 NR. 13 (166)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2015

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI III (XVII), tetor, nëntor, dhjetor 2015, nr. 13 (166)

Nën kujdesin e

kryetarit të KMSH-së: H. Skender Bruçaj

Drejtor: Dr. Genti Kruja

Bordi editorial: Ali Zaimi

Prof. dr. Ayhan Tekinesh

Dr. Brikena Smajli

Dr. Fahredin Ebibi

Dr. Ferdinand Gjana

Prof. dr. Hajri Shehu

Prof. dr. Njazi Kazazi

Prof. dr. Qazim Qazimi

Prof. Asoc. dr. Rahim Ombashi

Redaktor: Andrin Rasha

Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame

Tefsir

Hadith

Fikh

Sociologji

Filozofi

Gjuhësi

Letërsi

Psikologji

Histori

Kulturë

Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: Ceremonia e rihapjes së xhamisë së Plumbit,
Shkodër, 16 nëntor 1990.

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Rr. "George W. Bush", Nr. 50,

Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al

www.zaninalte.al

Përmbajtja

Studime

1. Përtej “kafazit” tredimensional...,
Blerim Lazimi5
2. Shqipëria: një shembull i bashkëjetesës ndërfaqetare në Evropë,
Mons. Lucjan Avgustini, Dioqeza e Sapës.....15
3. Omer Kajami, poeti që e bëri matematikën të rimonte,
Redi Shehu21

Histori

4. Pasqyrimi i përvjetorëve të pavarësisë në shtypin fetar 1913-1944,
Ma. Gazmend Leçini28
5. Pikëpamjet e Abdyl bej Frashërit dhe Dr. Ibrahim Temos për reformimin e sistemit arsimor osman dhe shkollat e huaja në vilajetet shqiptare,
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë – Tiranë43

Gjuhë

6. Mësimi i gjuhës shqipe gjatë Rilindjes Kombëtare e deri në fillimin e viteve '20 të shekullit të kaluar - 1 -
Prof. dr. Njazi Kazazi, Universiteti i Shkodrës, “Luigj Gurakuqi”58

Letërsi

7. Pavarësia në shkrimet letrare të ulemave shqiptarë,
Prof. dr. Hysen Matoshi, Instituti Albanologjik i Prishtinës77

Filozofi

8. Çfarë do të thoshte Hipokrati?
Ilir Akshija, M.D., M.Sc., Spitali Universitar “Nënë Tereza”, Erion Akshija, M.D në Farmaci83

Sociologji

9. Toleranca dhe bashkëjetesa fetare në Shqipëri gjatë viteve 1912-45
(bazuar në praktikën dhe ligjëratat e klerit),
Ahmed Kalaja, Doktorant/Universiteti European i Tiranës93
10. Toleranca fetare në Vilajetin e Kosovës dhe shpallja e Pavarësisë së
Shqipërisë (1908-1912),
Nuridin Ahmeti, Instituti Albanologjik - Prishtinë104

Shkenca Komunikimi

11. Zani i naltë, një model etik dhe përgjegjësie i komunikimit fetar
shqiptar,
Prof. assoc.dr. Mark Marku, Universiteti i Tiranës111

Personalitete

12. Hafiz Ymer Shemsedini, Me rastin e 120 vjetorit të lindjes dhe 70
vjetorit të vdekjes,
Prof. dr. Musa Kraja118

Retrospektivë

13. Jeta e njeriut një udhëtim
Fehmi Xhepa123
14. E vërteta triumfoi mbi të kotën125
15. Abstracts in English128
16. Rregullat e shkrimit136



Përtej “kafazit” tredimensional...

Blerim Lazimi

Mësues i Fizikës në gjimnazin “Said Najdeni”

Peshkopi

Abstrakt

Me sa duket, vetë matematika (bashkë me të edhe fizika) dëshmon ekzistencën e shpirtit të njeriut. Që nga lindja e saj si shkencë, ajo vazhdon të zhvillohet e pasurohet me një shkallë të lartë abstraksioni, gjë që nuk është cilësi e materies (sendeve, apo e trupit të njeriut). Kjo shkallë e lartë e të menduarit, intuitës dhe abstraksionit, shpjegohet dhe e ka shtysën te prania e elementit shpirtëror në natyrën e qenies njerëzore. Çdo pemë ka frytet e saj. Matematika është një prej fryteve të shpirtit. E më tej: “Gjeometria është shkencë. E vërteta e saj, duke arritur emrat Adl (I Drejtë) dhe Mukaddir (Përcaktues i Përsosur) të Zotit, reflekton në tërë shkëlqimin e vet në pasqyrën gjeometrike shfaqjet urtësiplote të emrit Allah.

“Falënderimi i qoftë Allahut, Krijuesit të qiejve e tokës. Sajuesit të engjëjve me nga dy palë, tre palë dhe katër palë krabë, ndërmjetësues (në mes Tij dhe pejgamberëve)...”¹

“Mandej, Ai e formëson atë (në barkun e nënës) dhe nga ana e Vet i jep shpirt atij dhe Ai është që juve ju pajis edhe me dëgjim, me të parit e me zemër, e pak send është ajo që ju falënderoni.”²

“Të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, e juve ju është dhënë fort pak dije.”³

“Thuaj: “Engjëlli i vdekjes, i cili është caktuar për ju, ua merr shpirtërat, e pastaj do të kethebeni te Zoti juaj.”⁴

1. Kur'an (35/1), f. 496, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

2. Kur'an (32/9), f. 475, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

3. Kur'an (17/85), f. 335, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

4. Kur'an (32/11), f. 475, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

1. Hyrje: besimi në engjëjt (melekët) ...

Këto janë disa ajete kuranore, ku Zoti shfaq disa të vërteta, në të cilat njeriu vetëm mund të besojë, për shkak të aftësive të kufizuara që ka për t'i perceptuar. Falë shqisave dhe aftësive me të cilat është pajisur, njeriu percepton objekte e dukuri si në Tokë edhe përtej saj. Me shtimin e njohurive ai kërkon të njohë sa më shumë nga universi, me të dukshmen dhe të padukshmen e tij. "Meqë për njeriun, gjërat që i di ia hapin derën për të ditur shumë gjëra që s'i di, atëherë ne jemi të detyruar t'i kërkojmë ato"- thotë një dijetar islam bashkëkohor. Toka është pjesëz e universit. Ndërkohë që planeti ynë vazhdon të përjetojë gjallërinë e vet, mund edhe të pyesim: po kjo gjithësi madhështore a mundet të ketë banorët e saj? Ashtu si Toka, universi është i përgatitur për jetën dhe për t'u banuar nga qenie të vetëdijshme. "Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe shpërndarja e gjallesave në të dyjat..."⁵ Në një tjetër ajet kuranor Zoti betohet: "Pra, Unë betohem në atë që e shihni! Edhe në atë që nuk e shihni!"⁶

Komentuesit e Kur'anit theksojnë që në ajetin e sipërpërmendur aludohet, ndër të

tjera, edhe për krijesa si engjëjt, xhindet etj. Në pjesë të tjera të Kur'anit termat janë më të qartë, konkretë dhe të drejtpërdrejtë. "Falënderimi i qoftë Allahut, Krijuesit të qiejve e tokës. Sajuesit të engjëjve me nga dy palë, tre palë dhe katër palë krabë, ndërmjetësues (në mes Tij dhe peygamberëve) ..."⁷ "E sa engjëj ka që janë në qiej, e që ndërmjetësimi i tyre nuk bën dobi asgjë."⁸ Nga Kur'ani informohemi edhe për engjëj të veçantë si Xhibrili (engjëlli komunikues me peygamberët), Mikaili, tetë engjëjt bartës së Arshit, engjëjt shkrues, engjëlli i vdekjes, engjëjt e Luftës së Bedrit etj. Në një kapitull (sure "Xhin") tregohet për xhindet dhe jepen disa nga cilësitë e tyre. Sigurisht, çfarë ka shpallur Zoti në Librin e Qartë dhe çfarë kanë transmetuar peygamberi Muhamed, sa e sa peygamberë dhe njerëz të urtë, duhen besuar pa asnjë rezervë. (Koha për të provuar të kundërtën ka qenë më se e mjaftueshme...) Dëshmimi në ekzistencën e engjëjve është një nga gjashtë kushtet e besimit islam.

2. Diçka nga matematika për të kuptuar më mirë.

Matematika zë një vend të veçantë ndërmjet fushave të

5. Kur'an (35/1), f. 496, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

6. Kur'an (53/26), f. 609, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

7. Kur'an (35/1), f. 496, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

8. Kur'an (53/26), f. 609, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

ndryshme të dijes. Ajo zbatohet në shkenca të ndryshme, qofshin këto natyrore apo jo. Madje, shpesh, ajo orienton në gjetjen e shpjegimeve bindëse të fenomeneve që studiohen, në zgjidhjen e problemeve të larmishme teorike dhe praktike. Për vetë natyrën e veçantë që ka, matematika jep koncepte e pohime të formuluar në trajtën e tyre të përgjithshme, të ngritura në shkallën më të lartë të abstraksionit. Kjo veçori e bën të nevojshme dhe të mjaftueshme që ajo të përdoret edhe në formulimin e dijes mbi “Hapësirën”.

Njeriu, i shtyrë nga kureshtja, që buron tej natyrës fizike të tij, është akoma në kërkim të së vërtetës hapësinore të Universit dhe të popullimit të tij. Vrojtimit astronomike, në sajë të një teknologjie gjithnjë e më të përparuar, depërtojnë në gjithësinë fizike, duke zbuluar trupa të rinj qiellorë, yje, yjësi, galaktika etj. “Hapësira” është kuptuar dhe kuptohet si “mjedis”. Është e qartë se hapësira e gjithësisht nuk mund të “preket” tërësisht. Vërtetë njeriu, për shkak të natyrës lëndore me të cilën është krijuar, nuk mund ta perceptojë drejtpërdrejtë këtë hapësirë, por ai, me mendimin dhe intuitën e tij, mund ta përshkojë atë. Pjesë e kësaj është edhe mendimi matematik. *Kanti e ka quajtur gjeometrinë “shkenca e të gjitha llojeve të hapësirës”.*⁹ “Hapësira”, në

9. “Endje nëpër hapësirat me “N” përmasa”,

tërë shtrirjet e saj, mund të kuptohet vetëm në rast se mendimi i shmanget pengesave që ngre tradita e të menduarit njerëzor.

Hapësira matematike është hapësirë shumëpërmasore. Matematika studion hapësirat “zeropërmasore”, “njëpërmasore”, “dypërmasore”, “trepërmasore”, “katërpërmasore” e kështu me radhë (të gjitha këto plotësisht të pranueshme matematikisht).

1) Hapësira “zeropërmasore” është hapësira e përfshirë brenda një pike, një hapësirë pa lëvizje, një “botë” e ngrirë, e vdekur. Vetë pika, që përbën tërë hapësirën, është pa përmasa.

2) Hapësira “njëpërmasore” është hapësirë që mund të mendohet e të studiohet vetëm me anë të fantazisë. Asnjë send në botën që na rrethon nuk është e nuk mund të jetë njëpërmasor. Hapësirat njëpërmasore janë “botë” të menduara të shtrira tërësisht në një drejtëz, apo segment drejtvizor. Një “botë” e tillë (imagjinare) do të “banohej” vetëm prej “qeniesh pikësore” ose “qeniesh segmente vijëdrejtë”, vetëm me gjatësi, pa gjerësi dhe pa lartësi (trashësi). Ato do të mund të endeshin vetëm nëpër drejtëz. Një “qenie” njëdimensionale, e “burgosur” ndërmjet dy skajeve të një segmenti të zgjedhur mbi një drejtëz, do të mund të dilte nga “burgu” vetëm në rast se do të kishte vetinë të lëvizte sipas një

Arion Hysenbegas, Tiranë, 1985, f. 13.

përmase të dytë, domethënë të ishte një “qenie jashtëhapësirë” për hapësirën njëpërmasore ku gjendet. “Banorët” e hapësirës njëpërmasore do ta kishin të vështirë, ndoshta të pamundur, ta imagjinojnë hapësirën me dy apo tre përmasa. Për ta është e paperceptueshme një hapësirë me më tepër se një përmasë, është e pamundur ekzistenca e hapësirave të tilla, është jashtë realitetit të tyre. Sipas tyre, gjithçka që do të jetonte në një hapësirë me dy, tre apo katër përmasa, do të ishte një sajësë, diçka fantastike.

3) Hapësira “dypërmasore” përfshin një botë imagjinare pikash, segmentesh apo figurash plane. Elementët që do të jetonin në të do të ishin dypërmasorë, domethënë do të kishin gjatësi e gjerësi, por kurrësi lartësi (trashësi). “Banorët” e kësaj bote dydimensionale do të jenë pa vëllim dhe do të mund të zhvendosen vetëm duke rrëshqitur mbi sipërfaqen plan, që përbën “gjithësinë” për ta, pa u shkëputur dot prej saj. Sipas tyre, hapësira me tre përmasa do të ishte jashtë realitetit, nuk do të perceptohej dot kurrë, pra, për ta nuk do të ekzistonte. Një “qenie” dypërmasore, e “burgosur” brenda një vije të mbyllur, do të çlirohej nga “burgu” dydimensional në rast se do të ishte e aftë të lëvizte sipas një përmase të tretë, domethënë në rast se do të ishte një “qenie” jashtëpërmasore për botën dypërmasore ku jeton.

4) Nga përvoja e tij mijëra vjeçare, njeriu është i bindur se hapësira ku jeton është tredimensionale. Këtë pohim e pranon tërësisht mendimi tradicional. Bota jonë reale, hapësira e vërtetë e menduar në tërë shtrirjen e saj është trepërmasore. Objektet që na rrethojnë, gjithçka shohim e prekim ka gjatësi, gjerësi dhe lartësi, pra ka vëllim. Sipas mendimit matematik tradicional, tre përmasat mjaftojnë për të kuptuar, përshkruar dhe njehsuar kënaqshëm çdo vendndodhje në hapësirën rrethuese. Çdo shkuarje më tej për të është absurde. Ai ngul këmbë për të mos lejuar që numri i përmasave të tejkalojë treshin. Njeriu e ka të vështirë të imagjinojë një përmasë të katërt. Pranimi i saj të shpie jashtë hapësirës me të cilën jemi mësuar, jashtë hapësirës që përbën “gjithësinë” e përfytyruar nga ne. Kalimi në hapësirën katërpërmasore çon në veti që në hapësirën trepërmasore nuk gëzohen, madje konsiderohen fantastike.

5) Në të vërtetë, edhe pse në mënyrë të pavullnetshme e të nënkuptuar, njeriu e ka përdorur edhe një përmasë tjetër, me natyrë të veçantë nga përmasat e tjera. Kjo përmasë është “Koha”.

Si përmasë e katërt hapësirë, matematikisht mund të merret një përmasë e çfarëdoshme, që për njeriun do të jetë gjithmonë përmasë imagjinare. Mendimi i mbështetur fort në eksperiencën nuk mund

ta pranojë atë. Njeriu do ta ketë të vështirë, ndoshta të pamundur, ta perceptojë këtë përmasë në përballjet e drejtpërdrejta me botën ku jeton. Megjithatë, për mendimin matematik, përmasa e katërt është plotësisht e pranueshme. Njeriu nuk mund të shohë më gjërë, përfaqësojë nuk çrrënjës paradykimin e ngulitur fort në ndërgjegjen e tij nga përvoja mbi hapësirën, përderisa fantazia njerëzore ushqehet nga kontakti i drejtpërdrejtë me realitetin tokësor tredimensional me të cilin është familjarizuar. “Koha bëhet hapësirë”¹⁰, theksojnë në studimet e tyre Hartl dhe Hawkins, duke nënkuptuar që, “Koha” është pranuar si përmasë e katërt e hapësirës përkrah tre përmasave të mirëfillta të mendimit tradicional.

6) Natyrshëm pranohet që hapësira njëpërmasore është e futur në hapësirën dypërmasore. Po ashtu, pranohet që hapësira dypërmasore është e futur në hapësirën me tre përmasa. Përkundër vështirësive, logjika matematikore pranon që hapësira trepërmasore është e futur në një hapësirë me katër përmasa. E kështu me radhë...

7) Pika, drejtëza, plani (e në përgjithësi figurat plane) janë elementë edhe të hapësirës me tre përmasa. Ato nuk ndryshojnë aspak kur kalohet nga hapësira

dypërmasore në atë trepërmasore. Vetitë e tyre vetëm mund të shtohen, të pasurohen me të tjera.

8) Gjeometria euklidiane dhe arkimediane është gjeometria me të cilën jemi familjarizuar, është gjeometria që kemi mësuar në shkollë dhe kemi përdorur në praktikë. Kjo gjeometri, me ndërtimin e saj të përpiktë aksiomatik, me elegancën e saj, me përgjithësimin dhe abstraksionin e saj të shtrirë kudo brenda horizonteve tokësore apo të arritshme nga njeriu, ka gjetur aplikime të shumta e të dobishme.

Megjithëkëtë, ajo nuk arrin të përfshijë tërë larminë e strukturave hapësinore të mundshme, tërë vërtetësinë në Gjithësi. Prandaj sot zbatohen edhe gjeometri të tjera: ajo e Rimanit (hapësira eliptike), apo e Lobačevskit (hapësira hiperbolike). Hapësira të tilla janë të lakuara. Të shkruajmë pak fjalë për këto hapësira. Lakimi i vijës (hapësirës njëpërmasore) ndiqet nga pikat brenda saj, por nuk mund të kuptohet prej “banorëve” të kësaj “bote”. Kjo “botë” është drejtvizore për ta, sepse ashtu e perceptojnë në sajë të “verbërisë” së tyre. Vetë vija, lakimi i saj, shihet qartë dhe studiohet në hapësirën me dy apo tre përmasa. Edhe hapësira dypërmasore mund të pësojë përkulje (lakime) sipas përmasës së tretë. Ajo mund të ketë valëzime: “gropa” dhe “kreshta”. “Qeniet” dypërmasore (“banorët”

10. “Endje nëpër hapësirat me “N” përmasa”, Arion Hysenbegas, Tiranë, 1985, f. 87.

e hapësirës me dy përmasa) nuk do ta kuptojnë që hapësira e tyre fizike është e përkulur. Për ta Gjithësia do të ishte me dy përmasa. Ata “jetojnë” në “botën” e tyre (ku përmasa e tretë është e huaj), rrëshqasin gjithmonë sipas sipërfaqes, shikimi i tyre nuk del dot jashtë sipërfaqes ku enden. Ndërsa ne, si qenie trepërmasore, e vërejmë menjëherë përkuljen, valëzimin e hapësirës dypërmasore sipas përmasës së tretë. Krejt ngjashëm, njeriu (qenie tredimensionale) e ka të pamundur të perceptojë një përkulje të çfarëdoshme të botës sonë, të Gjithësisë, të hapësirës trepërmasore sipas një përmasë të katërt. Shikimi i tij nuk del dot jashtë hapësirës ku jeton. Mirëpo, matematika i jep mundësi të “shikojë” përtej aftësive perceptuese natyrore. Duke shfrytëzuar mendimin matematik, duke u bazuar në ligjet e njohura, astrofizika ka propozuar modele matematike të Universit tonë. Në këto modele flitet për një përkulje të hapësirës sipas një përmasë të katërt.

3. Diçka edhe nga fizika (Teoria e Relativitetit): Hapësira katërpërmasore është e qenësishme, ngjarjet që zhvillohen në to janë reale.

Ajnshtajni në studimet e tij mori si hapësirë studimi gjithë hapësirën e perceptueshme nga njeriu: trupat qiellorë, grumbullimet

yjore, galaktikat, mjegullnajat e çfarë ndodh në to. Ai e pa këtë ndërtim madhështor si një të tërë, si një hapësirë katërpërmasore (3 përmasat fizike + përmasa kohë). Kështu, ai hodhi bazamentin për të parë qartë shtrirjen e vërtetë të hapësirës, në mënyrë që të shpjegonte gjithçka ndodh në të, pa kufizimet e ndjekura nga përvoja e ngushtë tokësore. Ajnshtajni ishte i detyruar të pranonte plotësisht të qenësishme si përmasë me të gjitha të drejtat edhe “Kohën”. Pa këtë përmasë të katërt nuk do të mund të formulohej matematikisht Teoria e Relativitetit. Meqë fizika relativiste përshkruan saktë e në mënyrë plotësisht bindëse dukuritë fizike që zhvillohen në Gjithësi, veprimet e fushave gravitacionale, dukuritë lidhur me lëvizjet afër shpejtësisë së dritës, do të ishte pa bazë të dyshohej në qenësinë e “hapësirës relativiste”, të hapësirës katërpërmasore që ajo përfaqëson. Pa përmasën shtesë (Kohën) nuk mund të shpjegohen dukuritë fizike relativiste: “... shumë autorë, në mënyrë të veçantë filozofë e fizikanë, kanë përqaftuar pikëpamjen se vetëm ngjarjet në hapësirën me katër përmasa janë reale dhe se një paraqitje në hapësirën me tre përmasa është vetëm një përshkrim subjektiv i realitetit...”¹¹ Vrojtimet tregojnë se trupat qiellorë, me masa relativisht të mëdha, përkulin rrethanimin e

11. “Albert Ajnshtajni”, Filip Frank, Tiranë, 1989, f. 138.

tyre hapësinor, bëjnë që edhe drita, kur kalon në afërsi të tyre, detyrohet të ndjekë përkuljen hapësinore përkatëse. Hapësira jonë është e lakuar sipas shpërndarjes së masës dhe energjisë në pika të ndryshme të saj. Dukuritë gravitacionale nuk mund të “shihen” në këtë “botë të rrafshët”. *Njeriu është i detyruar që, për hir të së vërtetës, të pranojë si krejt të qenësishme një hapësirë katërpërmasore, madje të pranojë se në këtë hapësirë zhvillohen dukuritë fizike relativiste dhe në mes të saj jeton edhe ai vetë.*¹²

4. Gjithësia është banesa e ndërtuar për t’u banuar nga qenie të vetëdijshme.

Çështjet e parashtruara më sipër, të trajtuara nga matematika dhe fizika, na bëjnë të mendojmë dhe reflektojmë ndryshe ndaj realitetit që na rrethon. Ato na detyrojnë të pranojmë që bota e njohur nga ne është pjesë e hapësirës katërpërmasore. Kjo hapësirë katërpërmasore (ndoshta edhe pesë apo më shumë përmasore), në të cilën përfshihet edhe vetë njeriu dhe bota ku jeton, duhet të ketë dukuritë dhe qeniet që i përjetojnë ato, në përshtatje me cilësitë e kësaj hapësire. Sigurisht që këto banorë kanë cilësi të ndryshme dhe më të shumta se njeriu fizikisht. Ato qenie e njohin Universin dhe marrin pjesë në jetën

e tij. Në një kumtesë (të përgatitur për librin kushtuar Lui de Brojtit me rastin e 60-vjetorit të lindjes) Ajnshtajni shpreh një qëndrim të qartë shkencor dhe filozofik, duke pohuar ekzistencën e një realiteti jashtë nesh, jashtë gjithçkaje që dimë dhe gjithçkaje që jemi. Ai deklaron: *“Ka diçka si një gjendje reale të një sistemi fizik që ekziston objektivisht, pavarësisht nga çdo vërtetim apo matje dhe që parimisht mund të përshkruhet nëpërmjet mjeteve shprehëse të fizikës.”*¹³ Përjetuesit e realiteteve të tilla në Gjithësi janë pikërisht ato krijesa të padukshme (për shqisat tona): engjëjt, shpirtërat, xhinnet. Në ekzistencën e tyre vetëm mund të besohet. Nisur nga arsyetimi matematik, ne (si qenie trepërmasore) e kemi të vështirë, thuajse të pamundur, t’i perceptojmë drejtpërdrejtë qenie të tilla të dimensioneve më të larta. Përkundër kësaj, ashtu si ne njohim, studiojmë, kuptojmë dhe analizojmë gjithçka mbi hapësirat dypërmasore, ashtu edhe engjëjt apo xhindet njohin, kuptojnë dhe dinë për qeniet njerëzore dhe realitetin tredimensional.

Këto qenie (të hapësirave katër apo më shumë përmasore) nuk janë si ne. Matematikisht (siç është trajtuar më lart në pikën 7) theksohet që elementët e hapësirës trepërmasore gëzojnë më shumë veti nga ato të hapësirës me dy apo një përmasë. Po

12. “Endje nëpër hapësirat me “N” përmasa”, Arion Hysenbegas, Tiranë, 1985, f. 151.

13. “Albert Ajnshtajni”, Filip Frank, Tiranë, 1989, f. 232.

ashtu, është plotësisht e logjikshme të pranojmë që shpirti, engjëlli apo xhindi (si qenie me më shumë se tre përmasa) të kenë cilësi më të shumta nga ato që ka qenia njerëzore fizikisht. Madje edhe ligjet kanë formë tjetër nga tonat. Domethënë, në atë raport dimensional (për rrjedhojë edhe cilësish) që është njeriu ndaj hijes së tij, në atë raport qëndron engjëlli, xhindi apo shpirti ndaj njeriut. Hiya nuk mund të njohë e perceptojë njeriun, po ashtu edhe njeriu nuk mund të dijë shumë për shpirtin, engjëjt dhe xhindet. “Të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, e juve ju është dhënë fort pak dije.”¹⁴ Kjo “pak dije” që mund të ketë njeriu për “shpirtin” vjen për shkak të pranisë së elementit shpirtëror në natyrën e dyfishtë, me të cilën Zoti e ka krijuar atë.

Më 1980, Dewdney, profesor në Universitetin e Ontarios, specialist në informatikë, në veprën e tij “Planivers” ndërton një “një botë të gjallë” imagjinare dypërmasore. “Gjithësia” e tij është fantastike. Në të e gjithë e vërteta e perceptueshme nga njeriu në botën tokësore gjen shëmbëllimin e vet. Me fantazinë e tij, ai i bën “qeniet e sheshta” - dypërmasore të zhvendosen lirisht në botën e tyre, të punojnë, të ndërtojnë, të bëjnë shpikje, të

prodhojnë ingranazhe e mjete të ndryshme. Natyrisht, me gjithë analogjinë, shumë tipare, që janë karakteristike vetëm për këtë botë dypërmasore të ekranit kompjuterik, janë të ndryshme nga ato të botës sonë me tre përmasa.¹⁵ Ngjashëm me këtë shembull, engjëjt, xhindet dhe shpirti gjenden në të njëjtin raport me njerëzit. A mundet vallë që “qeniet e sheshta e zvarranike” të ekraneve të ordinatoreve apo të televizoreve të mohojnë ekzistencën e qenies njerëzore apo të trupave përreth nesh, për shkakun se nuk mund të na perceptojnë ne dhe botën ku jetojmë?! A mundet vallë që ato të mohojnë cilësitë tona dhe ligjet që veprojnë te ne?! Duke nënkuptuar përgjigjen mohuese “Jo!” për dy pyetjet e mësipërme, po e zgjerojmë arsyetimin më tej, në marrëdhëniet ndërmjet qenieve trepërmasore dhe atyre katërpërmasore. Edhe njeriu nuk mund të mohojë ekzistencën e engjëjve dhe xhindeve, pse nuk mundet t’i shikojë a perceptojë ato. “Shpirti, engjëlli, xhindi dhe djalli nuk janë të dimensioneve tona, që të mund t’i shohim. Me organet tona, ne mund t’i shohim dhe ndiejmë vetëm ata që hyjnë në dimensionet tona...” – shkruan, plot ma’rifet dhe irfan (intuitë dhe kulturë shpirtërore), F. Gylen në librin “Nën hijen e besimit”¹⁶. Pra, të besosh në

14. Kur’an (17/ 85), f. 335, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

15. “Endje nëpër hapësirat me “N” përmasa”, Arion Hysenbegas, Tiranë, 1985, f. 47.

16. “Nën hijen e besimit”, F. Gylen, PRIZMI, Tiranë, 2004, f. 81.

ekzistencën e engjëjve, xhindeve dhe shpirtit, si qenie të dimensioneve më të larta, është plotësisht korrekte sipas koncepteve të matematikës dhe fizikës, të paktën teorikisht.

5. Njeriu është një mikrokozmos që merr jetë nga shpirti.

Shprehur thjeshtë, njeriu përbëhet nga shpirti dhe trupi. Trupi ka të gjitha cilësitë e materies: i dukshëm, ka peshë, ka vëllim (zë hapësirë), i nënshtrohet ndikimit kohor, tërheqjes gravitacionale, ndryshon nga një gjendje në një tjetër etj. Domethënë, fizikisht njeriu prezantohet si pjesë e hapësirës tredimensionale. Po të analizohet eksperiencia e gjatë njerëzore, në të do të gjejmë plot argumente që të shtojnë të besosh në ekzistencën e shpirtit. Dëshmitë e sa e sa njerëzve besnikë e të urtë (në fe), që përjetojnë përvoja të veçanta në botën shpirtërore; dëshirat (antivdekje) të çdo njeriu për përjetësi e kënaqësi të përgjithmonshme, reflektimet e çdonjërit kundrejt të bukurës dhe të shëmtuarës, të drejtës e të padrejtës, të mirës e të keqes etj., të gjitha dëshmojnë për shpirtin.

Madje, mendoj se edhe vetë lindja dhe zhvillimi i shkencës së matematikës dëshmon bindshëm për shpirtin. Disa veçori të shpirtit janë pandryshueshmëria, pakufizueshmëria në kohë dhe hapësirë dhe përhershmëria. Pra,

matematikisht mund të themi se shpirti është qenie përtej dimensioneve tona fizike.

*“Shpirti është horizonti nga i cili vështojmë rrjedhën e kohës dhe kuptojmë lëvizjet e saj. Nga ai e shohim edhe kalueshmërinë e kësaj bote.”*¹⁷

Sipas fizikës, lidhur me relativitetin e lëvizjes, dihet se është e pamundur të kuptosh lëvizjen (gjendjen), për aq kohë sa vëzhguesi ndodhet në trupin që studion. Për shembull nuk do ta ndiejmë lëvizjen e ashensorit për deri sa jemi në të dhe s’mund të shohim ndonjë objekt jashtë tij. Lëvizjen e tij e hetojmë vetëm nëse mund të shikojmë nëpërmjet një dritareje ndonjë objekt jashtë, ose nëse gjendemi jashtë ashensorit. E njëjta ligjshmëri na mëson se rrjedhën e kohës e kuptojmë ngaqë te ne ekziston elementi i pavarur me kohën. *“Shpirti e vështron kohën nga pika e palëvizshme kohore, e njëj atë dhe në rrjedhën e saj nuk merr pjesë. Për këtë, ky element i njeriut nuk zhduket. Atë ditë kur trupi shndërrohet në dhé, shpirti ruan veçoritë e tij, mbetet gjallë...”*¹⁸ Ajeti kuranor *“Secili njeri (nefs) do ta shijojë vdekjen”*¹⁹, tregon që vetëm elementi fiziko-vegjetativ i njeriut (nefs) është i vdekshëm. Thënë ndryshe,

17. “Prej dyshimit në besim”, Mustafa Mahmud, Shkup, 1994, f. 37.

18. “Prej dyshimit në besim”, Mustafa Mahmud, Shkup, 1994, f. 35.

19. Kur’an (3/ 185; 21/ 35; 29/ 57), f. 105; 373; 460, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

vdekja është një proces që (në terma matematikorë) paraqet kalimin e njeriut nga “burgu trepërmasor” në hapësira të dimensioneve më të larta, në shoqërinë e engjëjve përkatës. Në këtë proces merr pjesë pikërisht elementi “jashtë tredimensional”, shpirti. Mjaft bukur e kanë shprehur këtë aspekt të parët tanë të sinqertë në besim: shpirti-zog çlirohet nga trupi-kafaz.

“E më pas, kur zërin e Shpirtadhbënësit të dëgjoj,

*do ta braktis dikë këtë kafaz e do të shkoj...”*²⁰

6. Përfundim

Me sa duket, vetë matematika (bashkë me të edhe fizika) dëshmon ekzistencën e shpirtit te njeriu. Që nga lindja e saj si shkencë, ajo vazhdon të zhvillohet e pasurohet me një shkallë të lartë abstraksioni, gjë që nuk është cilësi e materies (sendeve, apo e trupit të njeriut). Kjo shkallë e lartë e të menduarit, intuitës dhe abstraksionit, shpjegohet dhe e ka shtysën te prania e elementit

shpirtëror në natyrën e qenies njerëzore. Çdo pemë ka frytet e saj. Matematika është një prej fryteve të shpirtit. E më tej: “Gjeometria është shkencë. E vërteta e saj, duke arritur emrat Adl (I Drejtë) dhe Mukaddir (Përcaktues i Përsosur) të Zotit, reflekton në tërë shkëlqimin e vet në pasqyrën gjeometrike shfaqjet urtësiplote të emrit Allah.” – siç shprehet Bediuzzaman Said Nursi.

*“Në gjithësi ka bilbila që u këndojnë bukurive të universit. Si bilbilat e kopshteve tona, këto bilbila ciërojnë me falënderime në yjet që janë lulet e kopshtit qiellor. Ata janë adhurues të përvetshëm të Zotit të botëve. Ata janë engjëjt.”*²¹ Edhe ti, o njeri, bashkohu me ta! Kjo është rruga e harmonisë.

“Ti je pa të meta. Ne nuk kemi dije tjetër përveç atë që na e mësove Ti.

Vërtet, Ti je i Gjithëdijsbmi, i Urti.”

20. “Nga Penza e Thyer dhe Dritat e Rrugës”, F. Gylen, Izmir, 1997, f. 214.

21. “Nën hijen e besimit”, F. Gylen, PRIZMI, Tiranë 2004, f. 88.

Shqipëria, një shembull i bashkëjetesës ndërfetare në Evropë

Mons. Luçian Avgustini
Dioqeza e Sapës

Abstrakt

“Shqipëria e re dhe ajo e vjetër karakterizohet nga marrëdhënie të mira mes besimeve. Toleranca dhe harmonia fetare është vlera më e madhe e Shqipërisë dhe kjo nuk është vetëm diçka proverbiale. Shqiptarët ditën të përballen me holokaustin. Pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ishte vendi i vetëm ku numri i hebrenjve u rrit gati 10-fish. Megjithëse në Shqipëri ekzistojnë 4 komunitete fetare dhe nuk shqubemi si popull i urtë, nuk i kemi njohur konfliktet fetare. 2 vëllezër, njëri katolik e tjetri mysliman kanë jetuar në një pullaz”.

Ismail Kadare

Bashkëjetesa fetare në Shqipëri është një pasuri prej së cilës mund të mësojnë shumë popuj dhe vende të botës, në mënyrë të veçantë aty ku dominon urrejtja, jotoleranca dhe joharmonia ndërmjet besimeve.

Shqipëria është shtet laik dhe sipas kushtetutës së vendit, shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare. Shqiptarët janë një popull i vogël në krahasim me shumë popuj të tjerë. Ata janë të ndarë pjesë-pjesë në shtete të ndryshme ballkanike, ndërsa gjysma e tyre jetojnë brenda kufijve të Shqipërisë.

Nga pikëpamja e përkatësisë fetare, sot në Shqipëri jetojnë së bashku:

të krishterët: ortodoksë, katolikë dhe ungjillorë – protestantë;

myslimanët: bashkësia islame dhe ajo bektashiane (bektashizmi është tarikati islamik sufi);

Pastaj ka një përqindje të atyre të cilët nuk janë deklaruar si pjesëtarë të një besimi, nuk janë ateistë, por ka edhe të deklaruar si ateistë;

Një përqindje e vogël janë **hebrenj** si dhe pjesëtarë të besimeve dhe sekteve të ndryshme.

Populli shqiptar, duke qenë

i vetëdijshëm se feja, si një prej komponentëve shumë të rëndësishëm në jetën e tyre shpirtërore, luajti një rol të rëndësishëm në formimin e vetëdijes së tyre si popull dhe shoqëri, gjithmonë arriti që të ruante vlera shpirtërore, pa marrë parasysh se për cilin konfesion fetar bëhej fjalë, atë mysliman, të krishterë apo ortodoks.

Bashkëjetesa, harmonia dhe toleranca midis feve të ndryshme është një karakteristikë e veçantë si për të kaluarën, ashtu edhe të sotmen e shqiptarëve.

Për të kuptuar më mirë bashkëjetesën ndërmjet besimeve në Shqipëri po paraqesim një historik të shkurtër

Krishterimi u përhap në trojet ilire, pasardhësit e të cilëve janë shqiptarët, gjatë shekujve I-II. Vetë Shën Pali pohon se shkeli në trojet ilire gjatë misionëve të tija drejt Romës, nëpër Udhën Egnatia dhe Portin e Durrësit, për të kaluar pastaj në Itali.

Në vitin 395, pas ndarjes së Perandorisë Romake në Perandori të Perëndimit dhe të Lindjes, trojet e sotme shqiptare kaluan nën sundimin e Perandorisë Romake të Lindjes, ndërsa në këndvështrimin kishtar, vijoi lidhja e pashkëputur me Romën. Në vitin 732, Perandori bizantin, Leon Izauriku, ia nënshtroi zonën Patriarkanës së Kostandinopojës.

Shqipëria ka qenë zona ku takoheshin dhe ndaheshin dy perandoritë më të mëdha të mesjetës: Roma dhe Bizanti. Po ashtu, Shqipëria ishte vendi ku takohej dhe ndahej autoriteti i dy kishave: asaj romane dhe bizantine. Dy perandoritë dhe dy kishat te shqiptarët asnjëherë nuk u bënë shkak konflikti.

Nga fundi i mesjetës filloi islamizimi i një pjese të shqiptarëve. Me përhapjen e fesë islame në trevat shqiptare, gjatë sundimit osman, u thellua më tej diversiteti fetar, gjë që potencialisht krijonte kushte për përçarje. Mirëpo kjo gjë nuk ndodhi. Toleranca fetare e pranishme në Shqipëri gjatë shekujve, u ruajt edhe gjatë përhapjes së Islamit në hapësirën shqiptare, sepse vazhduan të veprojnë pothuajse të njëjtët faktorë: territori i përbashkët, gjuha, traditat etnokulturore, lidhshmëria familjare apo farefisnore, si dhe marrëdhëniet shpirtërore.

Si Krishterimi (ortodoks apo katolik) ashtu edhe Islami te shqiptarët përgjithësisht mbeti një fe popullore, larg intolerancës dhe fanatizmit doktrinar.

Periudha e sundimit komunist ka qenë e egër dhe tepër armiqësore sa i përket sjelljeve dhe qëndrimeve ndaj fesë. Diktatura u përpoq të asgjësonte besimin dhe të ngrinte në kult ateizmin. Feja u ndalua me ligj, ndërsa institucionet fetare u mbyllën.

Sigurisht që kjo ideologji ateiste solli dëme të mëdha, por megjithatë besimi mbeti i gjallë në shpirtrat e njerëzve, për t'u rizgjuar me një fuqi të re në vitet paskomuniste.

Me shembjen e komunizmit në Shqipëri, me rihapjen e institucioneve fetare, myslimanë, ortodoksë dhe katolikë morën pjesë së bashku në rindërtimin e institucioneve fetare duke ndërtuar objektet e kultit, kisha dhe xhamia, por gjithashtu edhe duke marrë pjesë në ceremonitë fetare të krishtera apo islame.

Ka shumë shembuj të mirëkuptimit, harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare te shqiptarët. Këtu po përmend vetëm shembullin historik në meshën e parë dhe në rihapjen e xhamisë së parë në Shkodër, në nëntor të vitit 1990, pas ndalimit të besimit prej gati një çerek shekulli. Bashkëpunimi i të rinjve të krishterë e myslimanë në meshën e parë të zhvilluar në varrezat katolike dhe në predikimin e parë të xhumasë në Xhaminë e Plumbit në Shkodër, qenë shprehje e harmonisë dhe e vëllazërimit ndërfetar përballë regjimit komunist që ende ishte në fuqi.

Kështu ka vazhduar për shekuj me radhë bashkëjetesa dhe harmonia ndërfetare mes shqiptarëve, e sot ka mbërritur te ne si një vlerë e madhe kombëtare e një populli të vogël. Por këtë vlerë të rrallë, duhet ta ruajmë, ta kultivojmë dhe ta promovojmë

me të gjitha mënyrat, nëpërmjet arsimit, medias, etj., kudo qoftë, si brenda vendit ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Shën Gjon Pali II, gjatë vizitës së bërë në Shqipëri në prill të vitit 1993, tha: *“Populli shqiptar, është për t'u marrë si shembull në këtë pikëpamje. Ku komunitetet fetare mbajnë një raport respekti reciprok dhe të një bashkëpunimi të njerëzishëm. Dubet mësuar arti i dialogut dhe i të dëgjuarit, qoftë edhe kur kjo duket e pamundur. Uroj që Shqipëria të bëhet përherë e më tepër atdheu i ekumenizmit dhe i dialogut ndërfetar. A ka lëvdatë më të denjë për ju, sesa të tregoheni me gisht nga Evropa dhe mbarë bota, si shembull dialogu, mospërdorimi të dhunës dhe mirëkuptimi fetar të ndërsjellë”*.

Shembujt e kohëve të fundit në botë, por edhe në rajonin e Ballkanit kanë dëshmuar se ekuilibrat fetarë janë shumë të brishtë dhe shpeshherë manipulimet me to kanë sjellë pasoja të rënda. Në Shqipëri ekziston një pluralizëm fetar, i cili ka treguar se i mbart dozat e duhura të tolerancës së ndërsjellë, ashtu siç ekziston i konturuar mirë sfondi i një harmonie ndërfetare, e cila pjesërisht trashëgohet nga e kaluara dhe pjesërisht vazhdon të mbrohet në sajë të punës së lavdërueshme të komuniteteve fetare, për të ruajtur dhe zhvilluar vlerat e saj gati unike.

Ky model përbën një pasuri të çmuar për ne shqiptarët, por edhe një realitet pozitiv, me vlerë në rajonin

ku jetojmë dhe më gjerë. Shoqëritë tona po shkojnë në mënyrë të pashmangshme drejt globalizmit dhe integritit, duke tentuar krijimin e një familjeje të madhe në të cilën ka vend për të gjitha vlerat dhe pasuritë e kombeve dhe popujve. Në botën globale, vendet e vogla nuk pritët të konkurrojnë me ekonominë dhe pasuritë e tyre materiale. Megjithatë, me identitetin dhe vlerat më të çmuara të tyre, ato mund të kontribuojnë në pasurimin e shoqërisë globale, duke krijuar një mozaik të pasur vlerash, kulturash që njohin, respektojnë e zhvillojnë njëra tjetrën. Kontributi ynë, harmonia fetare, është mesazhi më i lartë i miqësisë dhe mirëkuptimit që Shqipëria u dërgon popujve.

Toleranca fetare të shqiptarët nuk është një cilësi e kohërave të sotme, nuk është as e formuar me arsim dhe shkollë. Ajo është një traditë që vjen nga thellësia e shekujve. Në Shqipëri tejkalohet shumë më tepër kuptimi i tolerancës fetare; aty jetojnë së bashku të krishterë e myslimanë në harmoni dhe mirëkuptim të plotë me njëri-tjetrin.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Zoti Bujar Nishani në fjalën përshëndetëse drejtuar Papa Françeskut me rastin e vizitës së tij në Shqipëri në shtator të vitit të kaluar, ndër të tjera tha:

“Ne shqiptarët jemi një popull i vjetër, me vetëdije të fortë kombëtare, kemi një gjuhë po aq të rrënjësuar e përbashkuese,

tradita e zakone të njëjta, por i falemi Zotit në mënyra të ndryshme. Këtë akt themelor të jetës sonë e kemi bërë gjithmonë në paqe e harmoni me njëri-tjetrin. Ngrehinën tonë shpirtërore e përbëjnë Krishterimi me Islamin, këto dy besime të mëdha të botës, përkatësisht me Katolicizmin, Ortodoksinë, Muhamedanizmin (Islamin) sunit dhe atë bektashi, të cilat në gjirin e këtij populli të lashtë, bashkautor në ngjizjen e qytetërimeve mesdhetare, dinë veç të dialogojnë.

Mes nesh nuk ka diskriminim, nuk ka intolerancë, nuk ka ekstremizëm, por respekt reciprok të trashëguar brez pas brezi, harmoni e barazi të plotë të komuniteteve fetare të garantuara nga Kushtetuta e shtetit tonë laik”.

Ndërsa Papa Françesku në takim me krerët e komuniteteve fetare u shpreh:

“Shpirti njerëzor nuk dubet të humbasë shpresat, ndaj njerëzit mund të ofrojnë një kontribut të pazëvendësueshëm. Nuk mund të vlerësoh, nëse nuk nisësh nga identiteti. Pa identitet nuk ekziston dialogu. Ajo që na bashkon është rruga e jetës dhe vullneti i mirë, pra, është që t'i bësh mirë vëllezërve dhe motrave dhe në këtë mënyrë ne ecim përpara. Ndaj secili prej nesh ofron dëshminë tek tjetri, pra, me dialog ne ecim përpara dhe është e bukur”.

Papa Françesku shtoi se, “liria e vërtetë fetare i shmanget tundimit të mostolerancës e të sektarizmit dhe mbështet qëndrimet e respektit dhe të dialogut konstruktiv”.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se vlerat nuk janë të përrjetshme, ato duhen ruajtur e kultivuar në mentalitetin e qytetarëve dhe kulturën demokratike nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm.

Toleranca dhe dialogu duhet të përfaqësohen në vendin tonë në mënyrën më të mirë që të jemi shembull për mbarë botën, ashtu si në të kaluarën tonë.

Mendime mbi bashkëjetesën në pullin shqiptar

Kemi shembuj të shumtë të tolerancës fetare në të kaluarën ndër shqiptarë të tre besimeve që nuk mund të gjes askund tjetër në Evropë. Shembuj që kanë lënë gjurmë edhe në ditët e sotme.

“Kemi tri fe, por kemi vetëm një Atdhe të përbashkët, një gjak vëllazëror, një gjuhë, një diell e një Zot. Detyrë mbi detyrat kemi bashkimin dhe mbrojtjen e Atdheut!”

Mulla Idriz Gjilani

Ndërsa, kryemyftiu i Shqipërisë, H. Vehbi Dibra, në Kongresin Musliman Shqiptar të mbajtur më 1923, duke u treguar delegatëve për gjendjen fetare dhe duke u treguar se vëllazërimin e bashkimin kombëtar duhet mbajtur mbi gjithçka, ka thënë:

“Mysliman, Katolik dhe Ortodoks, në pikëpamje të Kombësisë kemi një lidhje

të plotë e të patundshme, e nuk mund të thubet e të kuptohet asnjë send qi e tund atë vllazni të plotë. Çështja e fesë asht një çështje e posaçme e secili asht i lirë për me e sigurue forcimin e fesë së vet”.

“Mos vështroni besë e fe, muslimanë dhe katolikë, ortodoksë, gjithë shqiptarë sa janë dhe tek janë, janë vëllazër. T’ecim të dliër n’udhë të Perëndisë, n’udhët të drejtësisë... në mes të shqiptarëve të vërtetë s’ka ndonjë ndarje, ndonjë çarje, ndonjë ndryshim! Janë të tërë vëllazër të gjithë: janë një trup, një mendje, një qëllim, një besë!”.

Sami Frashëri

Kur më 28 dhjetor, 1913 u ngrit në Shkodër flamuri kombëtar, mysli-manë e katolikë, kambanoren e kishës së Gjuhadolit e lidhën përmes një konopi me minaren e xhamisë së Fushë Çelës, në të cilën valëvitej flamuri kombëtar ndërmjet rreshtit të gjatë të kandilave kuq e zi. Duke karakterizuar këtë ngjarje, Fishta tha:

“...mysli-manë e të krishterë, katolikë e ortodoksë qofshin, dijnë me u vëllaznue në idealin kombëtar. Ky vëllaznim, u shpreh edhe në këtë natë simbolikisht me drita kandilash, që si varg yjesh lidhnin minaren e Xhamisë së Fushës së Çelës me kumbanaren e kishës së Gjuhadolit...”

Në vitin 1914, në kohën e Austro-Hungarisë, në Gjakovë, duhej të ndërtohej një kishë për nevojat e shqiptarëve të besimit katolik, Bajram Curri i thotë

Konsullit austriak: “Ne shqiptarët e komunitetit musliman në Gjakovë, i kemi 18 xhami, zgjidhe njëren prej tyre ta bëjmë kishë”.

Një rast tjetër i ngjashëm: disa katolikë deshën të djegin xhaminë e Lezhës. Këtë e merr vesh At Gjergj Fishta dhe me t’u errësuar, shkon te xhamia. Kur ata shkuan për ta djegur, Fishta u flet në emër dhe ata të çuditur i thonë: “Si mor At, ti edhe prift edhe hoxhë?” Fishta iu përgjigjet thjesht: “Jo, unë jam prift, por meqë Hoxha kishte ca punë në Shkodër, me tha mua me e rujtë se edhe kjo është shpia e Zotit për shqiptarët!...”

“Harmonia fetare, sa është madhbështore si ngrehinë, aq është edhe e brishtë. Mjafton e çara e parë serioze, radikalizimi i njërit prej besimeve, që ngrehina të shembet.”

Ismail Kadare

“Unë besoj se shqiptarët gjithkund janë tolerantë për besimet e tjera dhe ndoshta ky është i vetmi vend në Evropë ku nuk ka pasur luftëra fetare.”

Faik Konica

**Kumtesë e mbajtur në konferencën “Shqipëria: një shembull i bashkëjetesës ndërfetare në Evropë”, Milano, korrik 2015.*

Omer Kajami, poeti që e bëri matematikën të rimonte

Redi Shehu


Abstrakt

Shumë prej nesh, kur bëhet fjalë për Omer Kajamin (1044-1123), menjëherë biem pre' e asociimit tradicional të emrit të tij me poezinë dhe mundësisht me Rubairat e famshme, por, në fakt, ekzistenca e personalitetit të tij në historinë dhe kulturën e Orientit dhe Perëndimit lidhet mbi të gjitha me të qenët e tij shkencëtar, matematikan e astronom i spikatur. Kështu kontributi i tij në epokat dhe rrymat kulturore i kalon caqet e njohura të poezisë dhe shtrihet në një oqean dijeje e kontributesh të pazëvendësueshme në këto fusha, duke u bërë një ndër kolosët e mëdhenj që i qëndroi kohërave.

Shumë prej nesh, kur bëhet fjalë për Omer Kajamin (1044-1123), menjëherë biem pre' e asociimit tradicional të emrit të tij me poezinë dhe mundësisht me Rubairat e famshme, por, në fakt, ekzistenca e personalitetit të tij në historinë dhe kulturën e Orientit dhe Perëndimit lidhet mbi të gjitha me të qenët e tij shkencëtar, matematikan e astronom i spikatur. Kështu kontributi i tij në epokat dhe rrymat kulturore i kalon caqet e njohura të poezisë dhe shtrihet në një oqean dijeje e kontributesh të pazëvendësueshme

në këto fusha, duke u bërë një ndër kolosët e mëdhenj që i qëndroi kohërave.

Ajo që njihet si lëvizja e tij e rëndësishme është shkuarja na qytetin e Isfahanit në fillimet e shekullit të 11-të, për të ndërtuar një observator, i cili ishte nën






Figura 2

Një ilustrim nga libri i Al Birunit (lindur në shtator të 973) në të cilin tregohen fazat e ndryshme të hënës

patronazhin e sulltanit selxhuk të asaj kohe Malikshah. Është pikërisht me anën e këtij observatori që Kajami realizoi jo vetëm kalendarin e ashtuquajtur “*Kalendari Maliki*”, i cili përdorej për mbledhjen e të ardhurave financiare dhe për punë të tjera administrative, por edhe në hartimin të ndoshta katalogut më të madh e të rëndësishëm astronomik, të cilit fatkeqësisht i gjenden vetëm pjesë të vogla të mbetura të tij.¹ Kalendarin e Kajami është konsideruar si kalendar me epërsi të shumta krahasuar me atë Gregorian. Ai, duke i kushtuar vëmendje saktësisë, arriti që në bazë të matjeve të tij të përcaktonte kalendarin diellor me 365.24219858156 ditë. Duke e krahasuar me kalendarin vjetor të ditëve të sotme, i cili është 365.2421190 ditë, shohim që diferenca nga kalendarin e hartuar nga Omer Kajami qëndron në disa decimal.²

1. Moore Patrick, “*The Data Book of Astronomy*”, Institute of Physics Publishing, Philadelphia 2000 Star Catalogue, f. 327.

2. Richards E.G. “*Mapping Time: The Calendar and its History*” Oxford University Press, 1998, f. 23

Kontributet e Kajamit në shkencën e Algjebrës janë domethënëse. Në librin e tij “*Makalat fi al-Xhebr ue al-Mukabila*” klasifikoi shume ekuacione algjebrike duke identifikuar 13 forma të ndryshme të ekuacioneve kubike. Ai ishte i pari që arriti të gjente teoremën e binomeve. Ai shkroi një traktat të titulluar “*Problemet e Aritmetikës*”, duke zhvilluar konceptin e rrënjës së n -së. Ai pohon se metodat e rrënjës katrore dhe të kubit, vijnë nga India, por ai i shtriu ato duke përfshirë të gjitha rendet matematikore përmes metodash pastërtish aritmetike. Kështu Kajami mund të konsiderohet si babai i teoremës binom: $(a + b)^n = a^n + na^{n-1}b + \dots + b^n$ e cila u bë baza në zbulimet e rëndësishme të mëvonshme në Islam.³

Figura 3

Shënime të Omar Kajamit mbi ndërthurjen e seksioneve konike⁴

3. Youschkevitch, Adolphe & Boris Rosenfeld: “Al-Khayyami” In *Dictionary of Science Biography*. Bot. Charles Gillispie, New York 1973 vol 7, f. 323-334.

4. Faqe e parë e dy kapitujve në dorëshkrim të Kajamit, marrë nga Universiteti i Teheranit.



1. Autograph of Ibn Khaldun (upper left corner)
From MS. U (1447) (Shah, 1999)

Figura 4

Libri “Makalat fi al-Xhebr ue al-Mukabila”, botim i cili klasifikoi shumë ekuacione algjebrike. Mbahet si qasja gjeometrike e Kajamit në zgjidhjen e ekuacioneve

Pasioni i Kajamit për shkencat ekzakte nuk ndalet këtu. Ai është edhe zgjidhësi i ekuacioneve kubike përmes ekuacionit:

$x^3 + 200x = 20x^2 + 2000$. Me anë të përdorimit të numrave në ekuacion, ai përcakttoi trajektoret ndërthurëse të dy seksioneve konike (një rreth dhe një hiperbolë) dhe tregoi se zgjidhja x është e barabartë me gjatësinë e një pjesëze të linjës në diagramë. Në fakt, paraardhësit e tij *Al-Hauarizmi* në shekullin e 9-të si dhe *Thabit Ibn Kurra* (836-901), kishin arritur të zgjidhnin ekuacionet katrore duke përdorur elementet e Euklidit. Mirëpo, në atë kohë nuk ishin zbuluar akoma numrat negativë, për rrjedhojë kishin ngelur 14 tipe ekuacionesh të pazgjidhura. Në librin e tij “*Traktat i Demonstrimit të Problemeve Algjebrike*”, Omar Kajami merret në mënyrë sistematike me të katërmbëdhjetë ekuacionet kubike. Ai arrin të zgjidhë secilin prej tyre duke përdorur seksionet konike




Figura 5

Zgjidhja e ekuacioneve kubike sipas Kajamit




Figura 6

Zgjidhja sipas Kajamit e ekuacioneve të pazgjidhura ($x^3+qx=r$ e modifikon në $x^3 + b2x = b2c$)

Në veprën e tij “*Shpjegime të Vështirësive në Postulatet e Euklidit*”, Kajami merret me postulatet paralele të përcaktimit të raporteve të drejta. Ai rikonstrukttoi teorinë e Euklidit duke mos u përpjekur për të provuar postulatet paralele, ai i zëvendësoi ato me dy pohime ku dy vija që nuk puqen duhet të ndërpriten dhe dy vija që puqen nuk mundet kurrë të ndërpriten në drejtimin e puqjes. Ai beson se kjo qasje e tij është një qasje përmirësuese krahasuar me atë të *Ibn al-Hejthemit*, sepse metodologjia e përdorur nga ky i fundit mbështetej në konceptin e lëvizjes, e cila duhet përjashtuar në rastin e gjeometrisë, sepse Kajami i bashkëngjiste lëvizjen botës materiale dhe e shkëputte atë nga bota jomateriale e përkuptueshme e gjeometrisë.

Me këtë ai arriti të pasuronte boshllëqet e teoremave të Euklidit. Gjithashtu në studimet e tija për postulatet e pestë, ai u fokusua gjerësisht në konceptin e hapësirës

dhe rendit gjeometrik, baza këto të rëndësishme për filozofinë e matematikës. Ndërkohë që *Nasirudin al-Tusi* e aprovoi teorinë e Kajamit teksa një shekull më vonë zhvilloi më tej teorinë e tij. Po ashtu, Kajami në sajë të punimeve të tija në dy fushat si të algjebrës dhe gjeometrisë, si dhe ndërthurjes që i bëri të dy lëmenjve, mbahet edhe sot si personi i cili arriti të gjeometrizojë algjebrën.




Figura 7

Teoria e linjave paralele





Figura 8

(Nasirudin al Tusi 1274) Faqe të punimeve të tija në arabisht mbi gjeometrinë duke komentuar

elementet e Euklidit bazuar në teorinë e Kajamit⁵

Një pikë interesante në të cilën ia vlen të ndalesh, është edhe dallimi që Kajami bëri në studimet e tij, bazuar edhe nga trashëgimia e Ibn Sinës, të trupëzimit natyror dhe trupëzimit matematikor. I pari është botë substanciale e cila qëndron në vetvete, ndërsa trupëzimi matematikor i titulluar edhe volum, futet në kategorinë e pasojave të ardhura si aksident dhe të cilat nuk përbëjnë në vetvete substancë të pavarur. I pari i përket shkencës së natyrës me të cilën ajo rreket të shpjegojë gjërat, ndërsa koncepti i dytë është domethënie e cila lidhet me matematikën. Pikërisht për këtë arsye të ndarjes konceptuale mes këtyre dy disiplinave, Kajami arriti të respektonte këtë ndarje gjatë gjithë punimeve të tij. Ai pikërisht për këtë arsye kritikoi teorinë e *Ibn Hejthemit*, i cili e kishte përfshirë lëvizjen në kategorinë gjeometrike. Kajami argumenton se lëvizja është kategori e cila i përket trupëzimit natyror dhe nuk duhej futur në disiplinën e gjeometrisë e cila i përket trupëzimit matematikor.

Figura 9 Zgjidhja gjeometrike që Kajami i bëri ekuacioneve kubike



Ky dallim thelbësor i Kajamit u pasua nga *El-Tusi* më vonë duke hedhur themelet e mekanikës kuantike. Sot për shembull, ka një perceptim për sa i përket elektroneve dhe protoneve si përbërës të trupëzuar, ngjashëm me trupa të tjerë të një shkallë minimale. Por, këto dy kategori i përkasin dy natyrave të ndryshme ekzistenciale. Këtë e përmend edhe Wolfgang Smith në veprën e tij *“The Quantum Enigma”*, i cili i ndan këto dy kategori në konceptuale dhe trupore.⁶ Ky dallim është bazuar në ndarjen konceptuale të Kajamit në filozofinë e matematikës mbi trupëzimet e ndryshme.

Është interesant fakti se ajo që njihet që nga shekulli i 17-të si Trekëndëshi i Paskalit, bazuar në teorinë e matematikanit francez

5. MS Trinity College Bodleian Library in Oxford.

6. Smith Wolfgang, *“The Quantum Enigma”*, Peru (Ill.), Sherwood Snyder, viti 2000.

Blaise Pascal, është përpunuar dhe përshkruar nga Omer Kajami i cili së bashku me matematikanin indian Halaudha, njihen si hartuesit e këtij trekëndëshi⁷

			1					Row 0
			1		1			Row 1
		1		2		1		Row 2
	1		3		3		1	Row 3
	1	4		6		4	1	Row 4
1		5	10		10	5	1	Row 5
1	6	15		20		15	6	Row 6
1	7	21	35		35	21	7	Row 7

Figura10
Trekëndëshi i përshkruar së pari nga Kajami

Kajami ishte gjithashtu ai që arriti të provonte domethënien gjeometrike të $A/C = (A/B) (B/C)$, e cila përdorej në elementet e Euklidit, por nuk ishte provuar kurrë më parë teorikisht. Kajami arriti të ndërtonte një magnitudë fikse e cila i shërbeu si njësi lidhëse me të gjitha magnitudat e tjera të të njëjtit lloj. Me këtë Kajami arriti të bashkonte në një të vetme si numrat ashtu edhe magnitudat gjeometrike brenda të njëjtut sistem. Për Kajamin magnitudat irracionale janë numra në vetvete të cilat përcaktojnë termin “*numer real*” të cilin neve e përdorim të gatshëm sot. Ky koncept i futur nga ai shënoi edhe ndryshimin e madh mes matematikës së lashtë

7. www.hotmath.com/hotmath_help/topics/yang-huis-triangle.html vizituar më 04.06.2012.

greke dhe asaj të kohëve të sotme. Gjenialiteti i Kajamit shtrihet përtej këtyre fushave. Ai është edhe hartuesi i metodologjisë së përcaktimit të gravitetit specifik. Trashëgimia e Kajamit në këto fusha arrin në katër libra mbi matematikën, një libër mbi algjebren, një tjetër mbi gjeometrinë, si dhe tre libra në fushën e fizikës duke shtuar edhe tre librat në fushën e metafizikës.

Në Perëndim bota akademike zbuloi veprat në shkencat ekzakte të Kajamit që në vitin 1880-të, që u pasuan pastaj me botimin dhe hulumtimin e tyre nga qarqet më të rëndësishme akademike të kohës. Ata e krahasuan Omer Kajamin si dhe pikëpamjen dhe punimet e tij, me matematikanët më të mëdhenj që ata njihnin si Johannes Kepler, Gottfries Wilhelm Leibniz dhe Isak Njuton. Kjo trashëgimi më pas u përmbledh në artikullimin akademik të Perëndimit që në këtë fushë njihet si “*Omeriada*”.

Karakteristikë e Kajamit në qasjen e tij ndaj shkencave ekzakte, është përpjekja për t’i dhënë shpirt atyre. Ndoshta mund të përbëjë një rast të rrallë që një poet e filozof i një dimensionit të tillë, të arrijë të ruajë staturen e tij edhe në lëmenj të komplikuar siç janë matematika, algjebra, gjeometria dhe fizika. Në përgjithësi letërsia dhe matematika janë konsideruar dhe kanë qëndruar në një distancë të konsiderueshme nga njëra-tjetra për vetë natyrën

e tyre tejet të kundërt. Prania e Kajamit në të dy natyrat pa humbur nga asnjëra prej tyre, duke i zhvilluar e ngritur në një nivel akoma më të lartë, përbën edhe një model të

asaj që mund të quhet poetizimi i shkencave ekzakte, dhënies shpirt përmes formulimeve filozofike të matematikës e gjeometrisë.

Pasqyrimi i përvjetorëve të pavarësisë në shtypin fetar 1913-1944

Ma. Gazmend Leçini*

Abstrakt

Sipas artikujve të botuar në shtypin fetar gjatë periudhës 1913-1944, mund të vërehet se klerikët e të gjithë besimeve kanë kontribuar fuqishëm në shpalljen e pavarësisë. Studuesit e huaj, disa të motivuar edhe nga synimet lidhur me aneksimin përfundimtar të trojeve shqiptare prej fqinjëve të tyre, e konsideronin të pamundur opsionin e ekzistencës së shqiptarëve të unifikuar në një shtet, për shkak të diversitetit të tyre fetar. U ngritën edhe teori, sipas të cilave, duhet të ketë një fe dominante mbi të tjerat në mënyrë që të arrihet stabiliteti i brendshëm.

Angazhimi i klerikëve të besimeve të ndryshme në të mirë të vendit, është një tregues i qartë se nocioni i besimit dhe identitetit nacional nuk e kanë përjashtuar ose mbuluar njëri-tjetrin, por vendi ka shijuar një mozaik identitetesh, ku çdo individ i vetëm nuk është shkak për kalimin nën hije të të tjerëve - në një situatë ku në qoftë se besimet e ndryshme trajtohen në mënyrë të barabartë, ka vend për secilin prej tyre.

Kontributi i këtyre klerikëve patriotë për të mirën e vendit, ka qenë i pranishëm gjatë gjithë periudhës kur ky shtyp ka gëzuar publikun e lexuesit e tij, duke i frymëzuar me frymën kombëtare dhe respektimin e institucioneve shtetërore. Ky shtyp, - në sajë të botimeve të tij, - ndihmoi shqiptarët të largojnë çdo urrejtje në mesin e pasuesve të besimeve të ndryshme. Kjo është një nga vlerat kryesore që na bën të ndihemi krenarë edhe sot. Në sajë të këtij kleri atdhedashës një vlerë e tillë u miratua dhe u trashëguar si tipar i identitetit kombëtar.

Pothuajse të gjitha organet e këtij shtypi fetar, preferuan të përdornin artikuj historikë në mënyrë që të provokojnë Shpalljen e Pavarësisë, duke kujtuar detajet e datës kur dashuria dhe sakrifica për atdheun janë të theksuar në zëmër.

Këto revista, edhe pse të spektrit fetar, nuk u kufizuan në artikuj vetëm teologjikë, por u përqopën të publikonin poezi, tregime, studime të aspekteve të ndryshme, të cilat i kthyen këto revista në elitën e shtypit të kohës.

Uroj që shpirti i respektit ndaj njëri-tjetrit, të kuptuarit e shfaqur dhe vënia e interesit kombëtar përpara çdo interesi tjetër - siç tregon shtypi fetar në botimet e tij gjatë viteve 1913-1944, - të vazhdojë dhe pasurohet më tej.

Po ashtu shpresoj që ky studim t'i shërbejë në mënyrë modeste këtij qëllimi.

1. Hyrje

Historia e pavarësisë së Shqipërisë ka njohur ngjarje, problematika dhe vështirësi të panumërta. Ajo që më së shumti i ka shqetësuar “Rilindësit” tanë ka qenë pikërisht ngulitja në popull e ndjesisë kombëtare. Kjo nuk ka qenë e lehtë, duke pasur parasysh dhe të veçantën e popullit tonë, i cili është homogjen në etni (me përjashtim të disa pakicave të etnive të tjera), por është heterogjen në përbërjen fetare. Për këtë arsye identiteti kombëtar i shqiptarëve nuk mund të konsiderohej si një identitet i shkëputur nga pjesët e tjera përbërëse të atij që ne e quajmë “IDENTITETI”. Ndaj dhe u desh një punë e madhe nga të gjithë patriotët për të nxjerrë në pah, në këto momente kyçe të ekzistencës sonë si popull, pikërisht identitetin kombëtar.

Janë tashmë të njohura vargjet e Vaso Pashës se “Feja e shqiptarit është shqiptaria”, që u bë motoja kryesore e atyre viteve të fillim-shekullit të kaluar. Duket sikur autori kërkon që t’ua zëvendësojë shqiptarëve fenë e tyre që ata e praktikojnë, aq sa e praktikojnë, me një “Fe” të re e kjo është “Shqiptaria”. Mund të duket e pranueshme për shqiptarin e thjeshtë (jo dhe aq fetar dhe aq më pak teolog), që siç e tregon dhe Edith Durham “Shqiptari mbetet gjithnjë shqiptar. Ai është në radhë

të parë shqiptar. Feja vjen në radhë të dytë”¹. Por kjo nuk është aspak në përputhje me parimet e të gjitha feve, ku teologët shqiptarë të këtyre besimeve, siç dhe do e shohim në këtë punim, kanë mbrojtur një ide tjetër, duke menduar se nuk ka mbivendosje identitetesh, por ka pjesë përbërëse të tij.

Këtë mendim e shohim dhe nga studimet e mëvonshme siç është rasti i Amin Maalouf-it që thotë: “Identiteti i dikujt përcaktohet dhe nga shumë elementë të tjerë si: kombësia, përkatësia fetare, një grup etnik a gjuhësor, profesioni, grupi social, bindjet politike, preferenca të ndryshme etj... Të gjitha përkatësitë kanë rëndësinë e tyre, por jo në të njëjtën kohë. Asnjëra në veçanti nuk e përmbush identitetin e dikujt.”²

Të njëjtën ide e hasim dhe te Mid’hat Frashëri: “Feja mund t’i ngjitet mirë një kombësie, pa ia ndryshuar kësaj karakterin etnik. Grekët e konvertuar të Kretës na japin edhe një provë më shumë, megjithëse të myslimanizuar, askush nuk i quan turq”.³

Nisur nga kjo, mendoj se

* Doktorant në Shkencat e Komunikimit dhe Informimit në Universitetin e Tiranës.

1. Edith Durham “*Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët*”. Shtëpia Botuese “8 Nëntori” Tiranë, 1991, f. 45.

2. Amin Maalouf “*Identitete Vrastare*” Botimet Onufri, Bot. i 2-të. Tiranë, 2006. f. 16.

3. Mid’hat Frashëri, *Shqiptarë dhe Sllavë*. Tiranë, shkurt 1998. f. 52.

intelektualët teologë të të gjitha feve, pikërisht ata që mbajtën barrën kryesore në ngritjen në këmbë të popullit në luftë për pavarësi, menduan se feja nuk përbën pengesë për shkëputjen nga Turqia, edhe pse për shumicën e popullsisë myslimane, pushtuesi kishte të njëjtin besim me ta. Është me vend të përmendim figurën e myftiut, Haxhi Vehbi Dibrës, i cili dha “Fetvanë”, vendimin ligjor fetar (teologjik), “për shqiptonjën dy krenare në mes fushës së kuqe”, si dhe punoi për bindjen e popullit se “Pamëvarësia” është në të mirë të popullit tonë.

Kjo figurë do të ishte dhe kryetari i parë i Komunitetit Musliman Shqiptar që u formua në vitin 1923.⁴

Nuk ngelen pas dhe figurat e Fishtës apo Nolit, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në arritjen e kësaj dite, por u ndala te figura e Vehbi Dibrës, pasi bëhej fjalë për shkëputjen nga “vëllezërit e një besimi”, por me kombësi të ndryshme.

Janë pikërisht këta teologë atdhetarë, që me organet e shtypit të bashkësive fetare që ata drejtuan, brumosën te shqiptarët ndjenjën e respektit dhe bindjes ndaj institucioneve shqiptare dhe atdhedashurinë, e cila, në masën

4. Enciklopedi “100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame Shekulli XIX-XX”. Botues “Komuniteti Mysliman i Shqipërisë”, f. 256-260.

e saj të duhur, nuk bie aspak në kundërshtim me frymën e asnjë feje.

2. Metodologjia

Për të parë se si i kanë pasqyruar përvjetorët e pavarësisë mediat fetare të kësaj periudhe, cilat kanë qenë llojet e shkrimeve të përdorura për t’ia sjellë sa më pranë lexuesit ngjarjet historike, kam ndjekur këtë metodologji:

Janë marrë në shqyrtim të dhënat parësore nga numrat e nëntorit dhe të dhjetorit, nga viti 1913-1945, të organeve zyrtare të komuniteteve dhe bashkësive fetare tradicionale në vend, duke i renditur nga koha e daljes së tyre në shtyp.

Janë marrë shkrime, që sjellin diçka të re dhe bëjnë kontrast në raport me të tjerat.

Janë shmangur komentet mbi përmbajtjen, duke gjykuar se lexuesi ka këndvështrimin e tij mbi citimin e dhënë.

Citimet nuk janë nxjerrë nga konteksti, por janë përzgjedhur ato që më së miri pasqyrojnë frymën e shkrimit prej ku është nxjerrë ai citim.

Llojet e shkrimeve i kam klasifikuar dhe vendosur në tabela sqaruese për secilin organ shtypi.

Nuk është bërë historia e këtyre organeve të shtypit, apo të autorëve që kanë shkruar në to, pasi kjo do ta tejkalonte qëllimin e këtij hulumtimi.

3. Revista “HYLLI I DRITËS”

Revista “Hylli i Dritës”, organi zyrtar i Françeskanëve, i ka kushtuar një vend të veçantë pasqyrimin të pavarësisë që në numrin e dytë, i cili përkon pikërisht me përvjetorin e parë të ngritjes së flamurit. Ashtu siç e bën të ditur në akt-themelimin e kësaj të përkohshmeje: “se tuj dashtë qi edhe n’kohë t’liriës Fretnit e Sh’Franceskut t’u përkujdesshin për t’marë e t’mirë t’kombit shqyphtar si nder kohë t’kaluem: e tuj dijtë edhe sa randësi t’madhe kan n’gjetetnim t’nji komit Perkohshmjet, me letër çarkore t’15. t’Gushtit t’ktii vjetit (1913) tfaqi dishirin qi Provinca e Shqypniës t’a themelojte nji Perkohshme t’veten...”⁵

Duke qenë se revista ishte në shtyp para 28 Nëntorit, drejtuesit e revistës në numrin e saj të tretë të dhjetorit të po atij viti, i rezervojnë një shkrim editorial me titull “KREMTIMI I KRYEVJETIT T’PARË T’INDEPENDENCJES S’SHQIPNIËS N’SHKODËR”. Në këtë shkrim tregohet gëzimi dhe hareja që ka përfshirë qytetin e Shkodrës në ditën e Flamurit, “si një provë e fortë kundër atyre që thonë se populli shqiptar nuk e do lirinë”⁶ Përvjetori i parë i Flamurit është festuar gjatë gjithë ditës në Shkodër ku i madh e i vogël, mysliman e katolik njëzëri brohorisnin “Rrnoftë

Shqypnija! Rrnoftë flamuri i sajël!”⁷

Po në këtë numër kjo revistë boton vjershën “E28 ENANDORIT T’VJETIT 1913”, ku me një ndjenjë mërzie dhe keqardhjeje të thurur në vargje, pasqyrohet gjendja kaotike që mbizotëronte Shqipërinë e asaj kohe, e cila “për një motmot te rriin aj n’anarkië / e t’bahet prralla e gazi i rruzullimit”⁸.

Duke hulumtuar numrat e nëntorit të kësaj reviste, shohim se festimin madhështor të përvjetorit të parë në Shkodër e hasim edhe në numrin e nëntorit të vitit 1937. Ja një detaj i kremtimit të asaj dite: “Kumbanarja e kishës së Gjuhadorit qe lidhur me minaren e xhamisë së Fushës së Çelës me një tel mbi të cilin valvitej flamuri kombëtar ndërmjet rreshtit të gjatë të kandilave kuq e zi”⁹.

Pas një ndërprerjeje të gjatë “Hylli i Dritës” i rikthehet botimit në vitin 1921. Në numrin e nëntorit të atij viti botohet një shkrim historik për Lidhjen e Prizrenit.¹⁰

Revista ndërpret sërish botimin në vitin 1924, pasi është i njohur qëndrimi i saj antizogist, dhe rifillon botimin në vitin 1930.

Një shkrim analitik “A jemi shqyphtarë a por do të bahemi?”,

7. Po aty.

8. *Hylli i Dritës*, Nr. 3, 1 dhjetor 1913, f. 98.

9. *Hylli i Dritës*, Nr. 11, 1 nëntor 1937, “Flamuri kombëtar në krahinë të Shkodrës”, f. 535.

10. *Hylli i Dritës*, Nr. 7, 1 nëntor 1921, “Lidhja e Prizrenit”, f. 307.

5. Revista “*Hylli i Dritës*” Nr. 1, 1 tetor 1913. “Themelimi i Perkohshmjes”, f. 1.

6. *Hylli i Dritës*, Nr. 3, 1 dhjetor 1913, f. 97.

diskutohen termet shtet, popull e komb ku mbrohet ideja se Shqipëria fare mirë mund të ekzistojë dhe duhet të ekzistojë si shtet i pavarur, edhe pse brenda saj mund të ketë pakica të kombeve të tjera, duke e argumentuar këtë ide dhe me rastin e Anglisë, Gjermanisë apo Spanjës ku në përbërje të tyre ka popuj të kombësive të ndryshme, duke e ndarë kështu nocionin shtet me atë komb.¹¹

Një nga format që kjo revistë përdor për të evokuar pavarësinë është dhe vjersha, siç e quan redaksia. Këtë e shohim në numrin e nëntorit të vitit 1933, ku botohet një vjershë nga P. Vinçenc Prenushi “NANA SHQYPTARE”, ku pasqyrohet në vargje lufta e popullit shqiptar për liri.¹² Në të njëjtin numër kemi dhe dy shkrime të tjera historike njëri “Për historinë e Alfabetit shqip” dhe tjetri “Njëzet e pesë vjetori i Kongresit të Manastirit”.¹³

Njëzetepesë vjetori i pavarësisë si vit jubilar do të ketë një vend të veçantë në faqet e “Hylli i Dritës”. Redaksia duket se e parapërgatit lexuesin e saj që në numrin shtator-tetor të vitit 1937 me një studim me titull “Pse u ngrit Flamuri në Vlorë dhe jo në Durrës”. Aty i bëhet një

përshkrim itinerarit të ndjekur nga Ismail Qemali deri në Vlorë. Autori tregon se çfarë u tha në një mbledhje të zhvilluar me parinë e qytetit ku “Ismail Qemali foli për situatën dhe rrezikun që i kanosej Shqipërisë. Pastaj zuri Myftiu të flasë gjësendi, por nuk u foli dot, pastaj u ngrit Dhespoti i Durrësit Jakovi dhe tha me zë të fortë: Zotërinj. Unë që kur kam lindur, që kur kam ardhur ndër ment e gjer më sot, vetëm një flamur kam njohur, kam dashur dhe kam nderuar, dhe ky është flamuri i Osmanllisë! Nenë këtë flamur dua të vdes. Mjerisht kjo fjalë e tërhoqi tërë mbledhjen për vete dhe filluan të propozonin që të njihnin vetëm flamurin e Osmanllisë. Atëherë Ismail Qemali e humbi pontin në Durrës por jo shpresën”.¹⁴

Më pas në numrin e nëntorit janë një seri shkrimesh të karakterit historik, poetik dhe informativ. Revista hapet me një përkushtim: “Dëshmorëve, Veteranëve, Fatosave që me gjak, djersë e burrn, me pupël, besë e trimni, vllaznuen zemrat shqiptare kputën prangat e robnis qindravjeçare, tuj shpejtue agimin e Hyllit të liris”.¹⁵

Më pas jepet një vjershë për Flamurin Kombëtar e një autori me

11. *Hylli i Dritës*, Nr. 12, 1 dhjetor 1930, f. 650-656.

12. *Hylli i Dritës*, Nr. 11, 1 nëntor 1933, f. 508.

13. *Hylli i Dritës*, Nr. 11, 1 nëntor 1933, f. 514-524.

14. *Hylli i Dritës*, Nr. 9-10, shtator-tetor 1937, Dr. Nikolaq P. Zografi “Pse u ngrit Flamuri në Vlorë dhe jo në Durrës”, f. 441-444.

15. *Hylli i Dritës*, Nr. 11, 1 nëntor 1937, “Kushtim”, f. 501.

pseudonimin Costandinus. Ja një strofë prej saj: “A thua dielli ndonjë herë shndriti / më me uzdajë për kombin tonë / sa atë herë kur për së pari valviti / kuq e zi Flamurin në Vlorë”.¹⁶

Në një studim mbi historikun e flamurit kombëtar në qytetin e Shkodrës, hasim në një sërë faktesh se si flamuri kuq e zi ishte tashmë i përhapur nëpër bajraqet e veriut. Ja çfarë shkruhet në të: “Ka të gjitha gjasat që flamuri që u ngrit në Vlorë më 28 Nëntor 1912 të ketë qenë pikërisht ai që vetë Ismail Qemali mori nga Lec Shkjezi në Kotorr pak përpara. Nuk e dua - i pat thënë Plaku - as tepër të madh, as tepër të vogël. E Leci, që kishte flamuj me shumë përmasa, i dha një flamur të thjeshtë 2 m të gjatë”.¹⁷

I shprehur në vargje, gëzimi që ka shqiptari për këtë ditë tingëllon shumë prekës dhe për ne pas kaq e kaq vitesh. “Ma e lumja ditë, shejmire e me oguër/ Për te me u gzue dhe gjarpni për nën guër / Paj edhe t’deknit n’vorre, / Se jo ma fmija, qi kcejnë n’për oborre.”¹⁸

Ndërsa në numrin e dhjetorit kjo revistë pasqyron një festë

16. *Hylli i Dritës*, Nr. 11, 1 nëntor 1937, “Kuq e zi, epopeja e flamurit Shqiptar”, f. 501.

17. *Hylli i Dritës*, Nr. 11, 1 Nëntor 1937, P. Donat Kurti. “Flamuri kombëtar në krahinë të Shkodrës”, f. 515-537.

18. *Hylli i Dritës*, Nr. 11, 1 Nëntor 1937, “Vorreve të Flamurit, 28 Nanduer 1912-1937”, f. 537.

madhështore që u organizua me rastin e 25-vjetorit të pavarësisë, në Komunën e Kastratit.¹⁹

Në vitin 1939, kur Shqipëria gjendej nën pushtimin e Italisë, në numrin e saj të prillit 1939, del qartë qëndrimi që kjo revistë do të mbajë ndaj pushtuesit fashist italian: “Dita 7 Prill shenjon fillesën e një epoke të re e fatbardhë për popullin shqyphtar... Shqypnin e flamurit të Vlonës e mbyti një Esat Toptan; Shqypnin e Luigj Gurakuqit e Bajram Currit e mbyti Ahmet Zogu i Matës, por ksaj Shqypnije oksidentale, Shqypnis së gjith shqiptarëve qi do të mkambet me pagjë, me drejtësi e me rregull të njëj Benito Mussolinit, s’ka me pas çka me i ba as një Esad e as një Ahmet i kësaj bote”.²⁰

“Hylli i Dritës” i kushton një shkrim 28 nëntorit të vitit 1925, kur Ahmet Zogu e rimori dhe një herë pushtetin pas dështimit të “Revolucionit të Qershorit”. Në shkrimin “Nji 28 Nanduer gjaku (1926) tregohet: “Ky (festim i përvitshëm i pavarësisë) nuk ndodhi në vitin 1925 kur qeverinë e vendit e kishte në dorë Ahmet Zogu, i ardhur atëherë në fuqi me ndihmë e armë të huaja. Kjo nuk ndodhi as në nëndorin e vitin 1926 ...”²¹

19. *Hylli i Dritës*, Nr. 12, 1 Dhjetor 1937, “Myllja Sensacionale e 25 vjetorit në Komunën e Kastratit”, f. 588.

20. *Hylli i Dritës*, Nr. 3-7, Mars-Korrik 1939, “Lajme rrokull Shqypnis”, f. 358.

21. *Hylli i Dritës*, Nr. 11-12, Nëntor-Dhjetor 1939, Autori, Pseud. Gjickam “Nji “28

Ky shkrim tregon se edhe pas ribotimit të kësaj reviste nën regjimin e Zogut, 1930-1939, përsëri “urrejtja e vjetër” e drejtuesve të saj ndaj Zogut akoma nuk ishte shuar.

Ponëkëtë numër botohet shkrimi “Dita e Flamurit”, ku tregohen disa veprime diplomatike të italianëve në raport me flamurin shqiptar. I tillë ishte rasti kur më 8 prill, Kolonel Scattini vendos në Shkodër krahas flamurit italian, edhe atë shqiptar, duke thënë: “...kemi ardhur tek ju jo si një popull i panjohur dhe armik. Ne ju konsiderojmë popull mik dhe vëlla... Këta dy flamuj do të valëviten për jetë së bashku në shenjë të kësaj lidhjeje vëllazërore...”²²

Gjithashtu pasqyrohet gjerësisht ceremonia e kremtimit të 28 nëntorit ku Françesko Jakomoni i dorëzon kryeministrit shqiptar, Shefqet Vërlacit, flamurin e ri kombëtar, e që nga ajo ditë, siç ishte dhe më parë, do të njihej ditë feste më emrin ‘Dita e Flamurit’. Më pas, po në këtë shkrim përshkruhet e gjithë ceremonia e organizuar “nën kujdesin” e veçantë të Mëkëmbësit të Italisë. Në këtë shkrim të gjatë dhe analitik, përshkruhen dhe ndryshimet që ka pësuar ndër vite deri në kohën e Italisë ku “iu shtuen shenjat e Lektorit e sipër tij Kunora e Shtëpisë së Savoia”.²³

Nanduer” gjaku (1926)”, fq. 539-542.

22. *Hylli i Dritës*, Nr. 11-12, Nëntor-Dhjetor 1939, P. Marin Sirdani, “Dita e Flamurit”, f. 611-620.

23. Po aty.

Dilemës sonë se si mund të jetë festuar ky përvjetor i pavarësisë ndërkohë që ne kemi qenë të pushtuar nga Italia, na i përgjigjet po në këtë shkrim Dom Lazër Shantoja. Ja një pjesë e fjalimit të tij (i cituar në normën e sotme letrare): “Ja vëllezër shqiptarë situata; kemi humbur për këtë punë pavarësinë tonë kombëtare? Manifestimi i sotëm do të konsiderohet një anakronizëm grotesk si një farsë politike. Po flas më qartë e po ju pyes: thua populli shqiptar është mbledhur sot në sheshin e kryeqytetit e në sheshet e qyteteve e të katundeve të ndryshme të Shqipërisë për të dhënë shembullin më dallkalk kolektiv e zyrtar që ka njohur historia e Shqipërisë? Ju përgjigjem: Jo! Unë do të turpërohesha sot para bashkatdhetarëve të mi, përpara vëllezërve të mi të Italisë, po të doja të luaja rolin e një xhongleri fjalësh. Unë ju them me bindjen më të plotë e më të sinqertë se sot më shumë se kurrë populli shqiptarë ka arsye dhe ka të drejtë ta kremtojë ditën e 28 Nëntorit.”²⁴

“Hylli i Dritës” numrin e nëntorit 1941, e hap me një poezi të Fan Nolit “28 Nanduer”. Në artikullin “Kunora e Flamurit” bëhet një paralelizëm me 28 nëntorin e vitit 1443, kur Skënderbeu e ngriti flamurin në Krujë. Ndërsa duke folur për “Nëntorin e dytë” atë të vitit 1912, u bëhet jehonë, përveç

24. Po aty.

figurës së Ismail Qemalit, edhe figurave të besimit katolik si Luigi Gurakuqit, Zef Harapit, Dedë Gjo’ Lulit, përmendet dhe kontributi i patriotëve Pandeli Sotiri dhe Themistokli Gërmenji.²⁵

Në një shkrim me stil rrëfimtari, i ndërtuar në formën e një tregimi, si përgjigje për pyetjen e bërë nga bija, tregohet rëndësia që ka festa e pavarësisë për çdo popull. Artikulli është i mbushur plot me informacione dhe data historike si evokim i historisë së popullit tonë që nga koha e Skënderbeut.²⁶

Llojet e shkrimeve të përdorura në revistën “Hylli i Dritës”

Nr. i bot. të shqyrtuara	12
Editoriale	2
Vjersha	7
Histori	3
Studime	5
Lajme (Rrotull Shqypnisë)	4

Tabela Nr. 1

4. Revista “ZANI I NALTË”

“Zani i Naltë”, revistë fetare, organ zyrtar i “Komunitetit Musliman Shqiptar”. Botimin e saj të parë e pati në tetor të vitin 1923. Karakteri i saj ishte kryesisht fetar, por në numrin e saj të parë lexojme

se: “Merret edhe me filozofi, moral, literaturë kombëtare, sociologji dhe del një herë në muaj”.²⁷

Festa e flamurit zë vend të rëndësishëm në faqet e kësaj reviste. Flamuri konsiderohet simbol i bashkimit kombëtar “Përpara këtij bashkimi çduket çdo dasi krahinore e religjioze”.²⁸

Në një poezi të drejtorit të përgjithshëm të kësaj reviste, Haki Sharofi, “Flamuri Kombëtar” ndër të tjera autori thur lavde dhe ndaj Mbretit Zogu i Parë: “Shqipëri ngreje ballin kryelartë / Mbretërinë ke kuror / Dhe mburojës, shtyllë hekuri dhe të zjarrtë / E ke Zogun Arbënor!...”²⁹

Në editorialin “28 Nanduer 1932. Ç’kuptim ka festa e Flamurit?” vlerësohet kjo ditë feste dhe gëzimi për mbarë popullin. Pyetjes së shtruar në titull, redaksia i përgjigjet: “Sot kësaj pyetjeje nuk mund t’i japim përgjigje, sepse fuqia mendore nuk punon, mirëpo shpirti, i cili vetë nuk shihet dhe që efektet nuk i fsheh, na e tregon përgjigjen. Ai nëpërmjet syrit derdh dy pika lot. Ky lot na tregon pse bëhet gjithë kjo festë kaq e madhe. Loti i parë tregon se sot u mbushën plot 20 vjet që Kombi Shqiptar fitoi Lirinë e vet.

25. *Hylli i Dritës*, Nr. 11-12, nëntor-dhjetor 1941, F. A “Kunora e Flamurit”, f. 462-463.

26. *Hylli i Dritës*, Nr. 11-12, nëntor-dhjetor 1939, Bardhyli, “Kujtime për Lirinë dhe Vetëqeverimin e Shqipërisë”, f. 484-492.

27. *Zani i Naltë*, Nr. 1, tetor 1923, “Parathënie dhe qëllim”, f. 2.

28. *Zani i Naltë*, Nr. 3, nëntor 1931, “Valo Flamur!”, f. 76.

29. *Zani i Naltë*, Nr. 3, nëntor 1931, Haki Sharofi “Flamuri Kombëtar!”, f. 77.

Ndërsa loti i dytë tregon se ideali i dëshmorëve të Atdheut, që dhanë jetën për liri, është nderuar...”³⁰

Me rastin e 25 vjetorit të pavarësisë, në numrin e saj të nëntorit, revista i kushton gati të gjithë hapësirën e saj përkujtimit të këtij përvjetori jubilar. Në editorialin prej 8 faqesh “Dy fjalë mbi 25 vjetorin”, i bëhet një panoramë historisë sonë, duke u ndalur pastaj në ngjarjet e vrullshme të fillim-shekullit të shkuar. Herë me nota poetike e herë historike, shkrimi i përcjell lexuesit një panoramë të gjallë të asaj dite gëzimi mbarëkombëtare. Shkrimi i kujton lexuesit vargjet e njohura nga poema “Bagëti e Bujqësi”: “Ti Shqipëri me jep nder / më jep emrin shqiptar / zemrën ti ma gatove / plot më dëshirë e me zjarr.” Në shkrim nuk mungojnë dhe nderimet për Mbretin Zog. Autori u drejtohet dëshmorëve të kombit duke u thënë: “Prehuni të qetësuar dhe kaloni çaste gëzimi se Shqipëria u bë dhe shkon drejt Qytetërimit nën drejtimin e Prijësit Gjenial të Saj, Nalt Madhërisë Tij Zogut I-rë, Mbret i Shqiptarëve.”³¹

Po në këtë numër, revista ka një rubrikë të sajën me titull “Veteranët e Klerit Musliman”. Shkrimi ka një qasje unike në trajtimin e problematikës së prezencës së

fesë islame edhe para ardhjes së osmanëve si dhe të pranimin të fesë nga pushtuesi, duke e konsideruar fenë si “një çështje individuale, që çdo person duhet ta zgjedhë sipas dëshirës dhe ndërgjegjes së tij. Feja është një institut, që ka për qëllim me ia përgatitë njeriut jetën pas vdekjes në një mënyrë të lumtur. Për këtë feja nuk ka lidhje me kombësinë. Kjo është arsyeja që shumica e pranoi Fenë Islame, megjithëse iu komunikua nëpërmjet armikut kombëtar... Kjo fe e naltë s’mundi me e afër shqiptarin me turkun, sepse turku nuk ndoqi një politikë fetare islame, por një politikë kombëtare turke. Prandaj shqiptarët pranuan Fenë Islame por qëndruan larg nga influenca kombëtare e turqve”.³²

Nga sa më sipër, ky shkrim i redaksisë na tregon se klerikët muslimanë shqiptarë nuk gjenin pengesë nga parimet e fesë islame për t’iu kundërvënë atij që nuk respekton të drejtat dhe liritë që Zoti ia ka falur, siç është ndër të tjera dhe mësimi i gjuhës amtare.

Më tej në shkrim lexojmë disa prej emrave (43 emra) të këtij kleri, që kontriboi për çështjen kombëtare. Ndër ta lexojmë: Hafiz Vehbi Dibra, firmosësi i aktit të pavarësisë dhe kryetari i parë i Pleqësisë, Hafiz Ali Korça, anëtar i Kongresit të Manastirit, Hafiz Ibrahim Dalliu,

30. *Zani i Naltë*, Nr. 3-4, nëntor-dhjetor 1932, “28 Nanduer 1932. Ç’kuptim ka festa e Flamurit?”, f. 452.

31. *Zani i Naltë*, Nr. 11, nëntor 1937, Neshet Çami “Dy fjalë mbi 25 vjetorin”, f. 321-328.

32. *Zani i Naltë*, Nr. 11, nëntor 1937, “Veteranët e Klerit Musliman”, f. 329-331.

mësues i Normales së Elbasanit.³³

Në shkrimin “28 Nandori Fatbardhsija e Shqipërisë” përmendet sërish akti i pavarësisë: “...del në Vlorë një Plak mjekërbardhë, Ismail Qemali dhe me 28 Nëntor 1912, bashkë me një grup shqiponjash, ngre Flamurin Kuq e Zi, atë që sot na valon mbi krye”. Nuk mungojnë dhe lavdet për Mbretin Zog që konsiderohet nga autori mbrojtës i sovranitetit të Shqipërisë.³⁴

Kjo revistë ndërpritet në muajin prill 1939 për t’ia lënë vendin pasardhëses së saj “Kultura Islame” në shtator 1939.

Llojet e shkrimeve të përdorura në revistën “Zani i Naltë”

Nr. i bot. të shqyrtuara	6
Editoriale	2
Poezi	2
Histori	2
Studime	
Lajme	

Tabela Nr. 2

5. Shtypi ortodoks

Shtypi ortodoks në këtë periudhë prezantohet me organin e saj të

shtypit, Fletore “Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, Organ Shpirtnuer për Orthodoxët e Shqipërisë”. Themelues, pronar, drejtues dhe artikull-shkrues Vissar Xhuvani, teolog. Kjo “Fletore” u shtyp në shtypshkronjën “Gjirokastra” në maj të vitit 1924 me 4 faqe. Emri i saj, siç e sqaron dhe botuesi, është vendosur në nder të heroit tonë kombëtar. Fillimisht u botua një herë në javë, më 7 korrik të po atij viti del 3 herë në muaj. Më 19 tetor 1924 fillon të dalë sërish një herë në javë çdo të diel. Ka një ndërprerje deri më 11 janar 1925, ku ndryshon dhe emrin në “Skënderbeu” nga “Gjergj Kastrioti” që ishte, dhe më 18 janar 1925 drejtohet nga një komision i posaçëm. Më 2 mars 1925, ditën e hënë del dhe numri i saj i fundit (me numër 23) ku lajmërohet se “Për shkaqe teknike, nuk ka për t’u botuar më Fletore “Skënderbeu””.³⁵

Siç shihet dhe nga ky historik i kësaj fletoreje, i marrë nga leximi i të gjithë numrave të saj që gjenden në arkivin e Bibliotekës Kombëtare, periudha e nëntorit ka pasur ndërprerje dhe nuk kam arritur të shoh ndonjë pasqyrim të pavarësisë në këtë fletore.

Organ tjetër i shtypit Orthodhoks ka qenë dhe “ZERI I ORTHODHOKSISË”, revistë

35. Fletore “Gjergj Kastrioti” më pas, Skënderbeu, Organ Shpirtnuer për Orthodoxët e Shqipërisë. 19 tetor 1924 - 2 mars 1925.

33. Për më tepër lexo: “100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame Shekulli XIX-XX”, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, shtator 2012.

34. *Zani i Naltë*, Nr. 12, dhjetor 1938, Hysni Hoxha, “28 Nandori Fatbardhsija e Shqipërisë”, f. 163-165.

fetare, botohet me përkujdesjen e Metropolitit të Korçës z. Jerotheut. Në arkivin e Bibliotekës Kombëtare gjendet vetëm numri 3 i saj i botuar më 1 Janar 1925 në Korçë me Drejtor dhe Kryeredaktor Pandeli Kotoku. Në të lajmërohet se “Botohet përkohësisht dy herë në muaj”. Edhe nga kjo revistë nuk ekziston në Bibliotekën Kombëtare asnjë numër i muajit nëntor, për të parë si pasqyrohet përvjetori i pavarësisë.³⁶

Nuk ka dyshim se dhe Kleri Orthodox Shqiptar nuk ngelet pas nga ndjenja e tij kombëtare. Këtë e tregon më së miri zgjedhja e ditës dhe e datës së organizimit të ceremonisë për ta shpallur Kishën Orthodoxe Autoqefale Shqiptare, “KOASH”. Kjo ndodhi pikërisht “ditën e ngritjes së flamurit kombëtar më 28 Nëntor 1921 në Kishën e Evangjelizmos në Tiranë ku morën vendimin për shpalljen e KOASH”.³⁷

6. Revista “LEKA”

Revista “Leka”, organi zyrtar i “Urdhrit Jezuit”, njoftoi botimin e saj në vitin 1929 me 32 faqe, por numrin e saj të parë e pati në janar të vitit 1930. Vitin e parë u botua çdo dy muaj, ndërsa nga viti i dytë i botimit (1931) doli çdo muaj. U botua në Shkodër në shtypshkronjën “Zoja e Papërlyme”.

36. Revista Fetare “ZËRI I ORTHODHOKSISË”, Nr. 3, 1 janar 1925, botuar në Korçë.

37. Shyqyri Hysi, Histori e Komuniteteve Fetare Shqiptare, Tiranë, 2006, f. 174.

Kjo revistë me materialet e saj ka dhënë një ndihmesë të vyer në ngulitjen e ndërgjegjes kombëtare. Që në numrin e saj të parë, Janar 1930, boton një artikull me titull “Ndjesia instiktive e atdheut” ku tregon se malli për atdheun e djek shpirtin e mërgimtarit”.³⁸

Në rubrikën ‘kulturë’ në numrin e nëntorit të vitit 1930, botohet një studim për problemet e gjuhës shqipe, e cila, siç dhe shkruhet, “Gjuha po na bastardohe”. Këtu u bëhet thirrje intelektualëve të japin kontributin e tyre në mbrojtjen e kësaj pasurie kombëtare.³⁹

Në nëntor të vitit 1931 revista “Leka” në rubrikën EDUKATË boton shkrimin “Dita 28 Nanduer”, duke shkruar se “Kjo ditë është një fotografi e këndshme, një kujtim i pashlyer i ditës 28 Nëntor 1912 në të cilën ai plak i ndershëm, Ismail Qemali bashkë me atdhetarë të tjerë të njohur nga populli, të besimeve të ndryshme, shpallën pavarësinë...”⁴⁰

Po atë vit në numrin e dhjetorit në rubrikën EDUKATË, botohet një shkrim sa edukativ aq dhe historik, duke u përpjekur që me anë të historisë, të zgjojë ndërgjegjen kombëtare te brezi i ri. Ky shkrim “Shka pret prej nesh Atdheu i lir”

38. Leka, Nr. 1, janar 1930, Z. Mark Harapi, “Ndjesia instiktive e atdheut”, f. 3.

39. Leka, Nr. 6, nëntor 1930, “Gjuha po na bastardohe”, f. 161-168.

40. Leka, Nr. 11, nëntor 1931, “Dita 28 Nanduer”, f. 323-329.

na bën një paralelizëm se si ishte Shqipëria gjatë 500 viteve, si është sot dhe si duhet përdorur liria e fituar. Në të lexojmë: “Për ta rigjallëruar e përparuar Kombin nuk mjafton vetëm liria, por duhet vepruar”.⁴¹

Në vitin 1942 revista “Leka” del me një “NUMËR TË VEÇANTË” në vazhdim të numrave kujtimorë të 25-vjetorit të pavarësisë kombëtare” siç dhe e titullon redaksia. Është një numër me shumë materiale me vlera historike, të cilat redaksia i ka mbledhur për vite të tëra nga arkivat personale të protagonistëve të atyre ngjarjeve. Një pjesë e mirë e këtyre dokumenteve botohen për herë të parë pasi, siç njofton redaksia, tashmë jemi në vitin 1942 ku regjimi i Zogut nuk ekzistonte dhe kishte një farë lirie shtypi më të madhe për sa u përket atyre materialeve, që preknin drejtpërdrejt atë figurë. Redaksia njofton se ky është numri i dytë i veçantë me dokumente historike. Numri i parë është botuar me rastin e 25 vjetorit, në vitin 1937, ku janë botuar shkrime që nga Lidhja e Prizrenit, si dhe shkrime të tjera të cilat nuk preknin regjimin në fuqi, e në disa raste janë përdorur dhe pseudonime për autorët.⁴²

Redaksia njofton se “Në këtë

volum do të mbledhim material për vitet nga 1908-1915. Shumë dokumente në gjuhë të huaj menduam më mirë t’i botonim të përkthyer besnikërisht në shqip, siç kemi bërë dhe në vëllimin e vitit 1937, (numri i veçantë i këtij viti nuk gjendet në Bibliotekën Kombëtare, edhe pse është i skeduar). Ndërsa materialet në shqip i kemi botuar ashtu siç ishin duke ruajtur jo vetëm fjalët, por edhe ortografinë dhe pikësimin origjinal edhe pse me gabime, duke menduar se për veç vlerave historike do të kenë dhe vlera gjuhësore”.⁴³

Janë plot 285 dokumente dhe korrespondenca të ndryshme të botuara në 247 faqet e këtij numri të veçantë.

Llojet e shkrimeve të përdoruara në revistën “Leka”

Nr. i bot. të shqyrtuara	5
Editoriale	2
Edukatë/Kulturë	2
Histori	285 dokumente historike
Studime	5
Lajme	

Tabela Nr. 3

7. Revista “KULTURA ISLAME”

Revista Fetaro-Kulturore “Kultura Islame” organi Komunitetit Musliman Shqiptar, e cila zëvendësoi

41. *Leka*, Nr. 12, dhjetor 1931, “Shka pret prej nesh Atdheu i lir”, f. 359.

42. *Leka*, numër i vetëm 1942 Mbas pesë Vjetësh, “NUMËR TË VEÇANTË” në vazhdim të numrave kujtimorë të 25-vjetorit të pavarësisë kombëtare”, f. 3.

43. Po aty, f. 5.

revistën “Zani i Naltë”, numrin e saj të parë e pati në shtator 1939. Kjo revistë ishte mujore, me disa përjashtime dhe vazhdoi deri në muajin shkurt të vitit 1946.

Në rubrikën e saj “Të ndryshme” revista citon si lajm festimin e pavarësisë. “Kjo ditë e pavdekshme e madhështore për Shqipërinë tonë të shenjtë, sivjet u kremtua me një madhështi shembullore. Në Xhaminë e Vjetër u kënduan Himne fetare nga kori i medresesë dhe fjalën e rastit e mbajti myftiu i Tiranës Muharrem Mullahi. Shkrimet që kanë ardhur për rëndësinë e kësaj ditë janë të shumta, por revista ishte vënë në shtyp”.⁴⁴

Në poezinë “Dëshmorët e kombit” poeti u drejtohet dëshmorëve me disa pyetje retorike “A kujtoni se krejt jini harruar / A thoni se të zhdukur juve jini, / a besoni vallë se s’ju kemi kujtuar / A thoni se emrin të humb’ e kini / Jo, jo, o burra, vëllazër të shtrenjtë / Kurr’ s’ju harrojmë, kurrë s’humbisni ...”⁴⁵

Në një shkrim të karakterit historik për ngjarjen e pavarësisë, i bëhet jehonë festimit të kësaj feste “sot të bashkuar me Perandorinë Fashiste, më të fortë se çdo herë, jemi të sigurtë e të bindur se Shqipëria do të gëzojë liri dhe paqe, duke përmbledhur në gjirin e saj edhe tokat ku flitet shqipja e ku banojnë

shqiptarë, për t’u bërë një Shqipëri e madhe, e fortë dhe ideale”.⁴⁶

Në rubrikën të “Ndryshme” jepet njoftimi për festimin e kësaj dite “në një mënyrë të thjeshtë prej popullit të kryeqytetit në xhaminë e vjetër ku merr pjesë dhe Mëkëmbësi i mbretit të Italisë Françesko Jakomoni bashkë me suitën e tij, i cili u prit nga zyrtarët më të lartë Komunitetit Musliman, dhe një shumicë njerëzish, intelektualë, klerikë etj.”⁴⁷

Në kujtimin e festës së pavarësisë revista boton një poezi “28 Nëntori” ku i këndohet bashkimit të trojeve shqiptare “Flamuri Shqiptar kryelartë / Valon n’erë dhe nën ngjyrat e tij / Vllaznit e shpërndam bashkon ma s’fundi ...”⁴⁸

Me një shkrim replikues “Një përpjekje” ndaj atyre që e konsiderojnë revistën “Kultura Islame” me kuptimin pezhorativ “fetare”, lexojmë se “Përpjekja jonë është një përpjekje fetare, pse jo? Por është dhe një Përpjekje Shqiptare”. Në këtë shkrim theksohet kontributi i intelektualëve muslimanë në interes të pavarësisë kombëtare.⁴⁹

Në kujtim të dashurisë për

44. *Kultura Islame*, Viti I. Nr.3 nëntor 1939, f. 124.

45. *Kultura Islame*, Viti I. Nr.4 nëntor 1939, Refik H. Bezhanit “Dëshmorët e kombit”, f. 153.

46. *Kultura Islame*, Viti II. Nr.15 nëntor 1940, Refik H. Bezhanit “Përvjetori i Njëzetetë i Pamvarësisë 28 Nëntor 1912”, f. 75.

47. *Kultura Islame*, Viti II. Nr.15 nëntor 1940, “Të ndryshme”, f. 80.

48. *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 nëntor-dhjetor 1941, J. Kodra Guazzoni, “28 Nëntori”, f. 73.

49. *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 nëntor-dhjetor 1941, Pseudonimi A.S, “Një përpjekje”, f. 83.

Atdheun në këtë numër botohet një shkrim me karakter historik ku tregohet momenti që Profeti Muhamed, pasi e detyruan të largohej nga vendlindja e tij, thotë “Ti je vendi më i dashur në sipërfaqen e tokës dhe më i zgjedhur për mua. Po të mos më kishin përzënë larg teje, unë kurrë nuk do të largohesha nga ti.”⁵⁰

Po në këtë numër botohet poezia “Jeni të gabuar”, vazhdimi i replikës ndaj atyre, që mundohen të fusin përçarje mes myslimanëve dhe besimeve të tjera, duke na kujtuar se shqiptarët u bashkuan të gjithë kundër pushtuesit pa dallim feje, “ishin gjithë shqiptarë, nuk dallonin Fe / Feja për ta ishte Liri e Atdhe”.⁵¹ Kjo ndjenjë urrejtjeje është e re për Shqiptarin “Çajupi nga Jugu, Fishta nga veriu / pse kjo farë e hidhur ndër Ta nuk mbiu? / Si këta dhe shumë, kemi dhe të tjerë / po të kësaj toke, të Shqipërisë së mjerë.”⁵²

Në numrin tetor-nëntor 1943 në rubrikën “Pjesa Letrare” botohet një prozë e shkurtër “Flamuri” ku tregohet rëndësia që ka ky simbol për shtetet e ndryshme. Gjithashtu sqarohet dhe domethënia e flamurit tonë kombëtar “Më mirë me vdek duke derdhur gjak se sa të jetosh me fytyrë të zezë”.⁵³

50. *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 nëntor-dhjetor 1941, “Përhapja e Islamizms”, f. 85.

51. *Kultura Islame*, Viti III. Nr.3-4 nëntor-dhjetor 1941, Pseudonimi Kom. “Jeni të gabuar!”, f. 86.

52. Po aty.

53. *Kultura Islame*, viti V. Nr. 2-3 tetor-nëntor

Llojet e shkrimeve të përdorura në revistën “Kultura Islame”

Nr. i bot. të shqyrtuara	6
Editoriale	1
Poezi	3
Histori	2
Studime	
Lajme	2

Tabela Nr. 4

8- Përfundime

Nga shkrimet e pasqyruara në organet fetare të kësaj periudhe 1913-1944, vërejmë se teologët e të gjitha besimeve kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar në shpalljen e pavarësisë. Ky kontribut, në të mirë të vendit, ka vazhduar për gjatë gjithë periudhës së botimit të këtij shtypi, duke ngulitur, me shkrime të zhanreve të ndryshme, tek lexuesit e tyre ndjesinë kombëtare dhe respektin për institucionet e shtetit. Ky shtyp nëpërmjet botimeve të tij ka ndihmuar që në mes shqiptarëve të mos ekzistojnë ndjenja urrejtjeje apo fobie ndaj anëtarëve të besimeve të ndryshme, vlerë kjo për të cilën krenohemi të gjithë. Të mos harrojmë se ishin pikërisht këta patriotë dhe këto organe shtypi të kësaj periudhe që dhanë kontributin e tyre në ngulitjen e kësaj vlere kombëtare. Uroj që këto parime të ndiqen në vijimësi dhe shpresoj që ky punin t’i shërbejë sadopak këtij qëllimi.

1943, Veli Hafizi, “Flamuri”, f. 50.

Bibliografia

- 1- Edith Durham “Brennga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët”. Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1991.
- 2- Amin Maalouf “Identitete Vrastare” Botimet Onufri, Bot. i 2-të. Tiranë, 2006.
- 3- Mid’hat Frashëri, Shqiptarë dhe Sllavë. Tiranë, shkurt 1998.
- 4- Enciklopedi, “100 Personalitete Shqiptare të Kulturës Islame, Shekulli XIX-XX”. Botues Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2012:9.
- 5- Revista “Hylli i Dritës” 1913-1944.
- 6-Revista “Zani i Naltë” 1923-1939.
- 7- Revista “LEKA” 1930-1944.
- 8- Fletore “Gjergj Kastrioti” më pas, Skënderbeu, Organ Shpirtnuer për Orthodoxët e Shqipnisë, 19 tetor 1924 - 2 mars 1925.
- 9- Revista Fetare “ZËRI I ORTHODHOKSISË”, Nr. 3, 1 janar 1925. Botuar në Korçë.
- 10- Shyqyri Hysi, Histori e Komuniteteve Fetare Shqiptare, Tiranë, 2006.
- 11- Revista “Kultura Islame”, shtator 1939-1945.
- 12- Della Rocca, Roberto Morozzo. Pa vit botimi. Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944, Elena Gjika, Tiranë.
- 13- Prof. Dr. Hamit Boriçi, Dr. Mark Marku, “Histori e Shtypit Shqiptar, Nga fillimet deri në ditët tona”, Sh.B.L.U, Tiranë, 2010.
- 14- http://www.parlament.al/web/Kuvendi_i_Shqiperise_1_1.php.

Pikëpamjet e Abdyl bej Frashërit dhe Dr. Ibrahim Temos për reformimin e sistemit arsimor osman dhe shkollat e huaja në vilajetet shqiptare

Dr. Hasan BELLO

**Qendra e Studimeve Albanologjike
Instituti i Historisë – Tiranë**

Abstrakt

Një fjalim të zjarritë lidhur me problemin e reformave të reja mbi arsimin, më 14 janar 1878, mbajti me cilësinë e deputetit të Janinës edhe Abdyl bej Frashëri. Ai e filloi diskutimin e tij duke shtruar pyetjen: “Cili është vallë shkaku i prapambetjes dhe i moszhvillimit të Perandorisë Osmane, i mbarë viseve që ajo zotëron në Europë, në Azi dhe në Afrikë? Sipas disa hamendësive tre janë shkaqet kryesore: shkaku i parë është injoranca, shkaku i dytë despotizmi dhe shkaku i tretë është paafësia e funksionarëve që ndodhen në krye të punëve, të cilët merren ose me argëtime ose me kotësira, por aspak me përparimin e shtetit dhe të kombit”.

Në fjalën e hapjes së Parlamentit të parë osman, Sulltan Abdylhamidi II (1876-1909) premtoi se, në kuadër të reformave që do të realizonte, do të hapte një shkollë për përgatitjen e kuadrove të lartë dhe se brenda një viti do të sillte në Parlament një rregullore të re mbi arsimin.¹ Ndërsa në Kushtetutën e

parë osmane, e cila hyri në fuqi në vitin 1876, lidhur me arsimin kishte dy nene (15 dhe 16).² Kjo tregonte seriozitetin dhe vëmendjen që burrat e shtetit osman, tani e tutje, do t'i kushtonin problemeve të arsimit. Në elitën drejtuese të Perandorisë Osmane përhapja e institucioneve

380; Uğur Ünal, “Sultan II. Abdülhamidin İlk Osmanlı Meclisini Açış Konuşması (20 Mart 1877)”, *Gazi Eğitim Fakültesi Dergisi*, 29, Ankara, 2009, s. 22.

2. E. Ziya Karal, *Osmanlı Tarihi ...*, s. 379-380.

1. Enver Ziya Karal, *Osmanlı Tarihi (Birinci Meşrutiyet ve İstibdad Devirleri 1876-1907)*, c. VIII, Türk Tarih Kurumu, Ankara 1995, s.

arsimore shihej edhe si një mjet, i cili do të përmirësonte gjendjen ekonomike të shtetit osman. Por, mbi të gjitha, ata e kishin kuptuar se zbatimi i reformave dhe modernizimi i Perandorisë kërkonte kuadro të specializuar. Kjo u vu re edhe në diskutimet që u zhvilluan në Parlament lidhur me legjislacionin e vilajeteve dhe bashkive. Zbatimi i këtyre ligjeve, sipas shumicës së deputetëve, ishte i kushtëzuar nga nëpunësit e shkolluar dhe nga populli që dinte shkrim e këndim. Këto diskutime nxorrën në pah gjendjen e mjeruar që ekzistonte në mbarë Perandorinë. Kështu, deputeti i Ajdënit, Ahmet Efendiu, ngriti shqetësimin se në zonën që ai përfaqësonte, me përjashtim të imamëve, nuk kishte njerëz që dinin të lexonin.

Një fjalim po aq të zjarrtë lidhur me këtë problem, më 14 janar 1878, mbajti me cilësinë e deputetit të Janinës edhe Abdyl bej Frashëri. Ai e filloi diskutimin e tij duke shtruar pyetjen: “Cili është vallë shkaku i prapambetjes dhe i moszhvillimit të Perandorisë Osmane, i mbarë viseve që ajo zotëron në Europë, në Azi dhe në Afrikë? Sipas disa hamendësive tre janë shkaqet kryesore: shkaku i parë është injoranca, shkaku i dytë despotizmi dhe shkaku i tretë është paaftësia e funksionarëve që ndodhen në krye të punëve, të cilët merren ose me argëtime ose me kotësira, por aspak me përparimin e

shtetit dhe të kombit”³.

Abdyl bej Frashëri mbajti një qëndrim kritik ndaj mos zbatimit me konsekuencë të reformave të Tanzimatit lidhur me përmirësimin e arsimit. Sipas tij, bazat e një shteti dhe e një populli ishin arsimi, ligjet e drejta dhe zbatuesit e tyre. Por, këto tre elemente në Perandorinë Osmane kishin mangësi. Që shteti osman të qytetërohej, ishte detyrë parësore që një orë e më parë të përqendrohej në zgjidhjen e tre shkaqeve të mësipërme. Çdo begati dhe lulëzim që kishte lidhje me qytetërimin, sipas Abdyl beut, ishte arritur me anë të arsimit. Pa arsim asnjë popull nuk kishte përparuar, por kishte rënë poshtë nga dita në ditë derisa ishte ballafaquar me gjithfarë fatkeqsisht. “Që na mungon arsimi, - vijonte më tej ai, - dhe në fakt na mungon shumë, besoj se të gjith jemi në gjendje ta vërtetojmë. Në këtë fushë, jo vetëm nuk është bërë sa duhet, por nuk është bërë asnjë grimë përpjekje...Përveç disa medreseve të zakonshme, çfarë shkollash të tjera kemi në popull? Disa kohë më parë u hap një universitet, por ende pa filluar mirë edhe ai u mbyll. Pastaj u hap Liceu i Gallatasarajt, por edhe kësaj shkolle ende nuk ia kemi parë frutat. Po në provincë si është gjendja? Përveç disa qyteteve që kanë shkolla plotore, ku mësimet zhvillohen pa plan dhe pa program, në qytetet e

3. Hakkı Tarık Us, *Meclis-i Mebusan 1293-1877*, C.II, Istanbul, 1954, s. 144-148.

tjera dhe sidomos në fshatra nuk ka jo vetëm plotore, por as fillore, madje as foshnjore. Edhe pse nuk e njoh Anadollin mendoj se atje nuk ka ndonjë dallim nga Rumelia ose, për shembull, nga Shqipëria, ku nuk ka shkolla në asnjë fshat...Nëse banorit fatkeq të këtyre viseve do t'i kërkohet një dokument me shkrim, ai nuk është në gjendje, për shkak të mos arsimimit, të paraqesë asgjë tjetër përveç letërnjoftimit. Të kemi mëshirë...Si do të qytetërohemi me këtë padituri? Si do të përparojmë? Kur do të zgjohemi nga ky gjumë i rëndë shekullor? Pastaj, përveç dy shkollave për femra që janë hapur tani vonë në Stamboll, në provinca nuk ka asnjë shkollë për to. Çfarë të bëjmë? Mos duhet t'i përzemë femrat nga rendi shoqëror? Ne duhet të interesohemi edhe për edukimin e tyre. Nuk duhet të harrojmë se edukata e burrave është në varësi të edukatës së vajzave. Në qoftëse nëna është e paditur, ju e kuptoni se në ç'shikallë të ulët do të mbetet fëmija pa edukatë, pa moral, pa karakter.”⁴ Për të dalë nga kjo situatë emergjente dhe për të përmirësuar dhe zgjeruar sistemin arsimor Abdyl beu propozoi që të merreshin këto masa:

në medresetë dhe shkollat ekzistuese të ndryshohej metodologjia e mësimdhënies dhe kategorizimi i tyre;

në çdo fshat të hapeshin shkolla

4. *Po aty.*

fillore dhe ruzhdie për djem dhe për vajza;

në çdo qendër vilajeti të hapej nga një shkollë e mesme (idadie);

në Stamboll të themelohej një universitet ku nën shembullin e vendeve europiane të kishte nga një degë për çdo shkencë;

për t'i shërbyer akoma më mirë nevojave të arsimit të themelohej një Akademi.

Ai e mbylli fjalën duke kërkuar që këto masa emergjente për arsimin të mos lireshin për vitin tjetër, por një orë e më parë të silleshin në parlament për t'u miratuar. Gjatë kohës që Abdyl beu mbante diskutimin, disa deputetë që nuk e kuptonin siç duhej këtë problem, në shenjë refuzimi, kishin braktisur sallën, ndërsa shumica e të pranishmëve e duartrokiti fort në shenjë miratimi. Sadi efendiu, deputeti i Halepit (Siri), vuri në dukje se fjalimi i Abdyl beut duhej rregulluar dhe plotësuar në disa vende, sidomos në lidhje me viset e Anadollit, për të cilat sipas tij, Abdyl beu nuk kishte thënë asnjë fjalë. “Ndoshta nuk më dëgjuat me kujdes, - ndërhyri Abdyl, - nuk fola për Anadollin mbasi nuk e njoh aq mirë, kurse Rumelinë, e sidomos Shqipërinë, e njoh fare mirë. Ajo është më poshtë se errësira”. Ndërsa kryetari i Parlamentit, Ahmet Vefik Pasha, për të zbutuar situatën, meqenëse në sallë ishin të pranishëm edhe përgjegjësit e vërtetë të kësaj gjendjeje, theksoi se shpirti i një

kombi ishte arsimi dhe komentoi se qëllimi i Abdyl beut ishte nxjerrja në pah e mangësive të sistemit arsimor dhe jo mohimi tërësor i tij. Ai i kërkoi Abdyl beut që diskutimin, i cili, sipas tij, kishte pamjen e një parashtrere, t'ia dorëzonte komisionit të posaçëm të çështjeve arsimore. “Ddakord, - iu përgjigj Abdyl beu dhe pastaj shtoi: - Do të jetë mirë sikur atë ta shqyrtojnë njerëz të aftë. Besoj se midis anëtarëve të komisionit ka njerëz të tillë. Pakujdesia nganjëherë është më e keqe se padituria, prandaj ne nuk përparojmë. Se nga anon më tepër burimi i së keqes sonë, nga paafërsia apo nga padituria, kjo nuk dihet. Megjithatë, nga çdo anë që të peshojë, për ne njësoj është”.⁵ Kësaj çështjeje Abdyl beu iu rikthye edhe një herë në diskutimin që mbajti mbas dhjetë ditësh. Kështu, më 24 janar 1878, kur iu desh të mbronte parashtrësën që kishte mbajtur një ditë më parë, deputeti shqiptar Mehmed Ali Vrioni, lidhur me organizimin e vilajeteve, zërave kundërshtues iu drejtua me këto fjalë: “Do t’u jap një përgjigje diskutantëve që kundërshtuan Mehmed Aliun. Ata nuk pranojnë se ne jemi të paditur. Ne, pohojnë ata, jemi me qytetërim të përkryer, ne jemi një popull që kemi dalë nga kombi arab. Natyrisht, - vazhdoi ai, - ne jemi të qytetëruar dhe ashtu siç e morëm ne qytetërimin nga grekët e lashtë,

ashtu edhe europianët e morën qytetërimin nga ne, me ndryshimin se ata e morën në një mënyrë të tillë sa nuk na lanë neve asgjë. Ne kemi mësuar histori dhe e dimë se si ishte gjendja e kaluar e perandorisë dhe në ç’skallë është sot. Dje foli Haxhi Ahmed efendiu për mungesën e shkollave tek ne dhe për gjendjen e keqe të medreseve. Këto fjalë nuk i pranuan ato katër a pesë deputetë që po kundërshtojnë edhe sot Mehmed Aliun. Por fjalët që ai tha dje mbi arsimin dhe ato që thashë edhe unë disa ditë më parë, po i përsëris: te ne nuk ka asnjë shkollë që të jetë me të vërtetë shkollë”. Kjo deklaratë ngjalli reagime të forta në Parlament dhe bëri që disa deputetë të brohorisnin në formë kundërshtimi se shkolla kishte kudo. “Unë, - deklaroi Abdyl beu, - përkundrazi, po dëshmoj se nuk ka. Edhe në Shqipëri edhe në Arabi nuk ka shkolla. Dikur, 600 vjet, madje edhe 1000 më parë, në Damask dhe në Bagdad, kishte shkolla ku mësoheshin shkencat, kurse tani nuk ka mbetur asgjë, sepse po të kishte shkolla për të qenë, nxënësit që dalin nga medresetë tona, do të ishin në një nivel tjetër. Të themi të drejtën, te ne nuk bëhet asnjë punë për të qenë. Çdo gjë që bëjmë ne, e bëjmë për provë. Prandaj, nuk shohim asnjë rezultat prej tyre. Ne duhet të heqim dorë nga kjo praktikë. Ne vetë nuk jemi në gjendje të realizojmë gjësendi. Në qoftë se duhen bërë reforma, duhet

5. H.Tarik Us, *Meclis-i Mebusan...*, s. 145-146; E. Ziya Karal, *Osmanlı Tarihi ...*, s. 382.

që ato sende që europianët i morën nga Azia dhe i përkryen, ne tani t'i marrim prej tyre dhe t'i zbatojmë në vendin tonë".⁶ Ky fjalim brilant dhe realist i Abdyl beut në heshtje gjeti miratimin e shumicës së deputetëve.

Por përpjekjet e këtij personaliteti për përmirësimin e sistemit arsimor në vilajetet shqiptare vijuan të ishin në qendër të veprimtarisë së tij politike. Kështu, më 13 tetor 1880, në memorandumin që i drejtoi Sulltan Abdyhamidit II mbi çështjen shqiptare, trajtoheshin tre problematika kryesore:

a) pikëpamjet e tij mbi politikën e vendeve europiane ndaj Perandorisë Osmane dhe Shqipërisë;

b) disa propozime lidhur me riorganizimin administrativ të vilajeteve shqiptare dhe bashkimin e tyre në një të vetëm dhe;

c) disa sugjerime mbi çështjet e arsimit dhe gjuhës shqipe të popullsisë shqiptare.⁷

Në këtë memorandum Abdyl bej Frashëri ngrinte shqetësimin mbi rrezikun e madh që u kanosej shqiptarëve nga përhapja e shkollave të huaja, sidomos të atyre që ishin hapur nga shtetet ballkanike, të cilat përdornin gjuhën greke, sllave e latine dhe që shumë shpejt ndërmjet

popullit shqiptar do të shkaktonin përçarje kombëtare, krahinore dhe fetare. Shkaku kryesor i kësaj shtate, sipas tij, ishte mungesa e shkollave shqipe dhe mungesa e shkollave në përgjithësi të popullsisë myslimane. Si rezultat, një pjesë e mirë e kësaj popullsie, duke mos përfituar sa duhej nga shkollat ekzistuese, kishte mbetur injorante. Ndërsa pjesa tjetër, ashtu si popullsia e krishterë, për nevojat e saj sociale apo tregtare ishte e detyruar të mësonte greqisht, sllavisht, italisht apo ndonjë gjuhë tjetër. Situata ishte e tillë sa që në Janinë popullsia, duke mos përdorur gjuhën shqipe nga dita në ditë, po e braktiste atë dhe po përdorte çdo ditë e më shumë gjuhën greke, ndërsa në Manastir, Kosovë dhe Shkodër numri i atyre që përdornin gjuhën sllave e italiane po vinte duke u rritur. Kështu, serbët, grekët dhe bullgarët bashkë me përhapjen e gjuhëve të tyre ishin duke përparuar drejt territoreve shqiptare. Si zgjidhje të kësaj shtate, Abdyl beu propozonte përdorimin dhe mësimin e gjuhës shqipe nëpër shkollat shqiptare. Vetëm në këtë mënyrë qoftë myslimanët qoftë të krishterët shqiptarë krahas gjuhës së tyre do të mësonin edhe gjuhën osmane, që ishte gjuha zyrtare e perandorisë. Ai bënte thirrje që sistemi arsimor të mos lihej në duart e të huajve; arsimimit nga shkollat e mësuesit e huaj t'i jepej fund dhe që Shqipëria të shpëtohej

6. H. Tanık Us, *Meclis-i Mebusan...*, s. 210-211.

7. Selda Kılıç, "Bir Osmanlı Aydınının Arnavutluk'a Dair Görüş ve Düşünceleri", *OTAM* (Ankara Üniversitesi, Osmanlı Tarihi Araştırma ve Uygulama Merkezi Dergisi), sayı: 19, 2006, s. 263.

nga kjo gjendje. Prapambetja e popullsisë myslimane për shkak të mos arsimimit, krahasuar kjo me popullsinë e krishterë, do të shoqërohej me një prapambetje edhe në fushën e tregtisë dhe industrisë, çka sipas tij do të prishte ekuilibrat dhe brenda pak vitesh do të bëhej shkak për trazira.⁸

Një personalitet tjetër me origjinë shqiptare, që ka lënë gjurmë në historinë politike dhe në mendimin pedagogjik osman është edhe Dr. Ibrahim Temo. Ai lindi më 21 mars të vitit 1865 në qytetin e Strugës, në lagjen “Murat Çelebi”.⁹ Pasi mori arsimin fillor në qytetin e lindjes, në vitin 1884 ai shkoi në Stamboll ku u regjistrua për të vazhduar studimet në Fakultetin Ushtarak të Mjekësisë (*Askeri Tıbbiye-i Şahane*). Gjatë viteve të studimit ai ra në kontakt me figura të njohura të kohës, me disa prej të cilëve, bashkëstudentë me të, në prill të 1889-tës themeluan organizatën politike “İttihad ve Terakki” (“Bashkim dhe Përparim”).¹⁰

8. *Po aty*, s. 265-266.

9. Kristaq Prifti, *Doktor Ibrahim Temo - Jeta dhe Vepra 1865-1945*, Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës, 1996, f. 13.

10. Për më shumë lidhur me rolin e Dr. Ibrahim Temos në lëvizjen xhonturke shih: Sina Akşın, *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*, Ankara: IMGE kitabevi, 2014; Ahmet Bedevi Kuran, *Osmanlı İmparatorluğunda İnkılâp Hareketleri Millî Mücadele*, İstanbul: Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları, 2012; M. Şükrü Hanioglu, *Bir siyasi örgüt olarak*

Kjo organizatë, shumë shpejt u kthye në një lëvizje opozitare, e cila, e frymëzuar nga parimet e Revolucionit Borgjez Francez (1789), synonte mbledhjen e Parlamentit dhe kthimin e Perandorisë Osmane në monarki kushtetuese. Për arsye politike, i ndjekur nga sulltani dhe qeveria osmane, pjesën dërrmuese të jetës ai e kaloi në Rumani. Megjithatë, gjatë gjithë kohës Dr. I. Temo luajti një rol aktiv. Ai ruajti lidhje me figura të njohura të lëvizjes xhonturke në emigracion, e shkroi artikuj në gazeta e revista të njohura të kohës shqiptare e të huaja, hartoi memorandume drejtuar sulltanit, qeverisë osmane dhe personaliteteve më të njohura të Europës, në të cilat ngriti probleme të ndryshme mbi reformat që duheshin realizuar në Perandorinë Osmane. Një vend të rëndësishëm në kujtimet¹¹ artikujt, memorandumet dhe epistolarin¹² e Dr. I. Temos zë edhe çështja shqiptare. Për vetë peshën dhe vendin që zë kjo figurë në historinë e Perandorisë Osmane dhe Rilindjen Kombëtare Shqiptare, shqyrtimi

Osmanlı İttihad ve Terakki Cemiyeti ve Jön Türklük (1889-1902), İstanbul: İletişim yayınları, 1987.

11. *Ibrahim Temo'nun İttihad ve Terakki Anıları*, İstanbul: Arba yayınları, 2000.

12. Epistolari dhe dokumentacioni personal i Dr. Ibrahim Temos që nga viti 1960 ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit. Ai iu dhurua shtetit shqiptar nga familja dhe bashkëshortja e tij Nafije Temo, sipas porosisë së bashkëshortit.

i pikëpamjeve që ai ka dhënë mbi reformimin e sistemit arsimor osman dhe shkollat e huaja në trojet shqiptare është një obligim shkencor.

Në një memorandum që Dr. I. Temo dhe atdhetarët e kolonisë shqiptare të Bukureshtit i dërguan qeverisë osmane në korrik të 1896, protestohej ashpër kundër propagandës së Greqisë, Serbisë, Bullgarisë dhe Malit të Zi, të cilat, duke shtuar vazhdimisht shkollat dhe kishat e tyre në viset shqiptare synonin të asimilonin popullsinë vendase. Kisha dhe shkolla, që në Shqipërinë e Poshtme (në Toskëri) funksiononin në greqisht, kurse në Maqedoninë e Sipërme dhe në Gegëri në sllavisht, - shkruhej në memorandum, - u shërbenin interesave të huaja politike, Greqisë dhe shteteve sllave, që synonin të errësonin shpirtin e shqiptarëve dhe t'i bënin ata për vete, t'i asimilonin e t'i shkombtarizonin. Për të penguar këtë politikë antikombëtare, shqiptarët e Bukureshtit i kishin parashtruar Patriarkanës protesta të njëpasnjëshme, ku i kërkonin që kisha të mos përdorej si mjet për helenizimin e shqiptarëve ortodoksë, që nuk kishin asnjë lidhje me grekët as nga gjaku as nga kombësia. Për t'i dhënë fund dhunës dhe arbitraritetit politik në Shqipëri dhe veprimtarisë antishqiptare të shteteve ballkanike, e cila sipas patriotëve shqiptarë lejohej edhe nga vetë sulltani, ata kërkonin që:

a) qeveria osmane të lironte të gjithë shqiptarët e burgosur dhe të internuar për arsye politike;

b) të njëjhej kombësia shqiptare dhe përkatësia fetare të mos përzihej me atë kombëtare dhe;

c) me qëllim për të penguar propagandat e huaja kishtaroshkollore dhe për të mos u dhënë mundësi shteteve fqinje t'i përdorin kishat dhe shkollat si vegla të tyre politike, ishte e nevojshme që në viset me popullsi shqiptare, shërbimi fetar të bëhej në shqip. Gjithashtu, kërkohej që në këto vende të hapeshin shkolla kombëtare, ku mësimi të zhvillohej në gjuhën shqipe.¹³

Një nga bashkëhartuesit e Memorandumit të mësipërm, Dr. I. Temo, në thirrjen "Bashkatdhetarë shqiptarë" të hartuar në vitin 1897, pasi përshkruante gjendjen e mjeruar të popullsisë shqiptare në Perandorinë Osmane, si shkaktar kryesor për situatën e krijuar ai akuzonte regjimin e Abdylhamidit II, valinjtë dhe funksionarët osmanë. Sipas tij, projektet për reforma që ata i kishin dërguar qeverisë osmane, kishin shkuar kot dhe nuk kishin marrë asnjë përgjigje. Padishahut, - shkruante ai, - as që i shkonte ndërmend të plotësonte

13. *Arkivi Qendror i Shtetit* (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F) 19, Dosja (më tej: D) 18, fl. 1. Memorandum i Ibrahim Temos dhe i patriotëve të Kolonisë Shqiptare të Bukureshtit drejtuar sulltanit, korrik 1896.

dëshirat e shqiptarëve për zhvillimin e arsimit dhe të ekonomisë së vendit. Ndërkohë që vazhdonte t'u bënte lëshime serbëve, malazezëve, bullgarëve dhe grekëve, të cilët, duke patur mbështetjen e Rusisë po ndërhynin hapur në Vilajetin e Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës, duke punuar për të helmuar ndërgjegjen e shqiptarëve dhe për t'i përçarë ata. Ky ishte edhe "shpërblimi" për shërbimet që shqiptarët i kishin bërë Perandorisë Osmane, duke derdhur gjakun në shkretëtirat e Arabisë dhe Afrikës.¹⁴

Dr. I. Temo ishte nga të parët intelektualë shqiptarë që ngriti zërin dhe vuri në dukje rrezikun që i kanosej vendit nga shkollat e huaja. Në një artikull që botoi në revistën "Albania" të Faik Konicës me titull "La Bulgarisation de l'Abanien" ("Bullgarizimi i Shqipërisë"), ai fliste hapur mbi zgjerimin e ndërhyrjes së Bullgarisë dhe të shteteve të tjera ballkanike. Sipas tij, këto shtete, në saj të lëshimeve që u kishte bërë Porta e Lartë kishin krijuar kishat dhe shkollat e tyre në një pjesë të madhe të Shqipërisë. Më tej, ai e vinte theksin në rrezikun e madh që përbënin këto shkolla në drejtim të shkombëtarizimit dhe të sllavizimit të territoreve dhe popullsisë shqiptare. Përpjekjet e këtyre shteteve për të rikrijuar "Bullgarinë e madhe" apo perandoritë e tjera mesjetare greke

14. *AQSH*, Fondi 19, dos. 21, fl. 36. Pamfleti "Bashkatdhetarë shqiptarë", 1897.

e serbe, ai i quante qesharake dhe pjellë të një fantazie të shfrenuar. Megjithatë, Dr. I. Temo nuk harronte të paralajmëronte qarqet shoviniste ballkanike se veprimtaria e tyre propagandistike në fushën e arsimit do të çonte, pa e kuptuar edhe ata vetë, në shpërthimin e ndjenjave nacionale shqiptare, në një aksion të dhunshëm dhe në një revansh të tmerrshëm kundër tyre.¹⁵

Përpjekjet e bëra nga Sulltan Abdylhamidi II për ta rikthyer në Stamboll, ai i shfrytëzoi për t'i parashtruar kërkesa në favor të çështjes shqiptare. Në shtator të vitit 1899, Dr. I. Temo i dorëzoi funksionarit të lartë osman gjeneral Ahmet Xhelaledin Pashës një Promemorie prej 8 faqesh. Kjo Promemorie përmbante kërkesa me karakter arsimor dhe kulturor, të cilat do ta ndihmonin popullin shqiptar për të afirmuar identitetin e tij kombëtar dhe për të parandaluar politikën asimiluese të shteteve fqinje.¹⁶ Sipas Dr. I. Temos, shqiptarët myslimanë, që përbënin edhe shumicën e popullsisë, ishin të bashkuar me këto kërkesa me vëllezërit e tyre të krishterë dhe po mbronin kombësinë, moralin dhe nderin e tyre kundrejt rrezikut të sllavizimit, greqizimit dhe latinizimit. Ai kritikonte funksionarët osmanë,

15. Ibrahim Temo, "La Bulgarisation de l'Abanien", *Albania*, nr. 4, 15-31.7.1898, f. 63-64.

16. K. Prifti, *Doktor Ibrahim Temo...*, f. 162.

nga qeveritarët më të lartë e deri te drejtorët e arsimit në vilajete, për shkak se ata i shikonin me indiferentizëm propagandat e huaja dhe nuk shqetësoheshin aspak ndaj rrezikut të shkombëtarizimit që u kanosej shqiptarëve. Mungesa e shkollave shqipe nga njëra anë dhe përhapja e shkollave e kishave sllave e greke në Vijaletin e Kosovës, Manastirit dhe Janinës nga ana tjetër, kishin krijuar sipas Dr. I. Temos një gjendje të rëndë për popullsinë shqiptare. Për ta ilustruar këtë situatë, ai sillte si shembull pozitën e një njeriu, të cilit i kishin vendosur shkëlmin në bark dhe po i zinin frymën. Dr. I. Temo i bënte thirrje Sulltan Abdylhamidit II dhe qeverisë së Stambollit se dobësimi i lidhjeve midis shqiptarëve dhe Perandorisë Osmane kishte ndodhur pikërisht për shkak të kësaj politike. Prandaj, në qoftë se qeveria osmane do të hapte në çdo anë të Shqipërisë shkolla shqipe, jo vetëm që do t'u pritej rruga propagandave të huaja, por do të forcoheshin njëherazi edhe lidhjet e shqiptarëve me Perandorinë Osmane. Ai kundërshtonte me forcë të gjithë ata funksionarë konservatorë osmanë, të cilët, duke njohur rolin e shkollave në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve, kishin frikë se hapja e tyre do të çonte në shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Shqiptarët, sipas Dr. I. Temos, e kishin pasur gjithmonë të zhvilluar ndërgjegjen

kombëtare. Për ta vërtetuar këtë, ai i sugjeronte funksionarëve osmanë që të pyesnin ndonjë shqiptar për kombësinë e tij. Me bindje të plotë, ai shkruante se nga nënpunësi më i lartë e deri te shqiptari më i thjeshtë, qoftë ky mysliman ose i krishterë, do t'u thonte se, "Lavdi Zotit, jam shqiptar", duke u lavdëruar me kombësinë e tij. Dr. I. Temo i bënte thirrje sulltanit se për të forcuar lidhjen e shqiptarëve me Perandorinë Osmane, Stambolli duhet të zbatonte një politikë tolerante dhe më të drejtë ndaj shqiptarëve, sidomos në drejtim të hapjes së shkollave dhe lëvrimin të gjuhës shqipe. Kjo do të ndihmonte në forcimin e unitetit jo vetëm mes shqiptarëve myslimanë dhe Perandorisë Osmane, por edhe me shqiptarët ortodoksë. Si shembull ai sillte qëndrimin e tyre në Luftën Greko-Turke (1897), të cilët nuk kishin rënë në kurthin e propagandës dhe shoqërive greke që vepronin në Shqipërinë e Jugut, por përkundrazi bashkërisht me forcat osmane u ishin kundërvënë ushtrisë pushtuese greke kur ajo kishte sulmuar Vilajetin e Janinës.

Në Promemorian e Dr. I. Temos paraqitet edhe një projekt-reformash që Perandoria Osmane duhet të zbatonte në vilajetet shqiptare. Me interes për studimin tonë është sidomos pika tre, ku ai shkruan se të huajt, duke shfrytëzuar doktrinën fetare, i kishin kthyer shkollat dhe kishat në vegla të tyre.

Ata emëronin në to mësues dhe priftërinj grekë në Toskëri dhe bullgarë e serbë në Gegëri. Për t'u dhënë fund ndërhyrjeve të tilla, ai sugjeronte se duheshin plotësuar dy kërkesa të popullit shqiptar: së pari, të krishterëve shqiptarë t'u lejohej që në liturgjinë kishtare të fusnin gjuhën shqipe dhe që Patrikana greke të mos i persekutonte priftërinjtë shqiptarë; së dyti, qeveria osmane të hapte në viset shqiptare shkolla shqipe, ku nxënësit shqiptarë të mësonin edhe gjuhën turke. Dr. I. Temo në këtë memorie deklaronte haptazi se me bashkimin e shkollave shqiptaro-osmane të katër vilajeteve shqiptare do t'u jepej fund propagandave greko-sllave, si dhe pretendimeve të tyre territoriale në Shqipëri e Maqedoni. Për ta paralizuar krejtësisht ndikimin e shteteve ballkanike, ai ishte i mendimit se qeveria osmane duhet të hapte shkolla edhe për kombësitë e tjera joshqiptare. Kjo strategji do të kishte efekt pozitiv dhe do të bënte që kombësitë në fjalë t'i ndërprisnin lidhjet e tyre me Athinën, Beogradin, Sofjen, Bukureshtin dhe Moskën.¹⁷

Në tetor 1902 - prill 1903 Dr. I. Temo, pasi dha dorëheqjen si mjek nga një spital i Rumanisë, shkoi në Paris për të vijuar specializimin në fushën e okulistikës. Atje ai vendosi kontakte me miq dhe bashkëpunëtorë, personalitete të

njohura të lëvizjes xhonturke. Gjatë kësaj kohe, me kërkesë të Dr. I. Temos, u mbajt një mbledhje në shtëpinë e Ahmet Rizait¹⁸ ku morën pjesë drejtuesit kryesorë të kësaj lëvizjeje. Në kujtimet e tij, ai shkruan se në mbledhje kishte parashtruar nevojën e hartimit të një programi, mbi bazën e të cilit duhet të punonin të gjitha degët e partisë "Bashkim dhe Përparim". Ky program do të shërbente si një platformë për qeverisjen e vendit, kur kjo parti të vinte në fuqi. Dr. I. Temo i tërhoqi vëmendjen drejtuesve të lëvizjes se ata nuk duhet të kufizoheshin vetëm me kritika drejtuar regjimit të Sulltan Abdylhamidit II, sepse po të vazhdohej kështu, kur të merrnin frenat e shtetit në dorë, nuk do të ishin në gjendje për ta drejtuar atë. Duke marrë në konsideratë këto propozime, pjesëmarrësit ranë dakord për të përpiluar një program të hollësishëm për të gjitha degët. Dr. I. Temo mori përsipër që të hartonte pjesën mbi politikën arsimore dhe reformat që partia "Bashkim dhe Përparim" do të ndërmernte kur të vinte në pushtet. Ai e vlerësonte arsimimin e popullit si treguesin themelor të qytetërimit të një kombi. Vendi që zinte një shtet në botën e qytetëruar, sipas tij, përcaktohej nga pesha numerike e numrit të banorëve që dinin të shkruanin e lexonin në raport me popullsinë e

17. *AQSH*, Fondi 19, dos. 31, fl. 97-99. Promemorie e Ibrahim Temos paraqitur Ahmet Xhelaledin Pashës, shtator 1899.

18. *Ibrahim Temo`nun Ittihad ve Terakki...*, s. 157.

përgjithshme. Prandaj, reformimin e sistemit arsimor në Perandorinë Osmane ai e quante si diçka të domosdoshme. Programi arsimor që Dr. I. Temo paraqiti në mbledhjen e radhës përbëhej nga këto pika:

Vendosja e arsimit fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë shtetasit e Perandorisë Osmane.

Programet e këtyre shkollave do të përgatiteshin nga shteti dhe do të kontrolloheshin prej tij.

Nxënësit që nuk do të vazhdonin studimet e mesme do të mësonin pas mbarimit të shkollës fillore edhe dy vite të tjera, gjatë të cilave do të merrnin njohuri për profesione të ndryshme që nevojiteshin për jetën.

Në katundet ose lagjet ku përveç turqve kishte edhe popullsi të kombësive të tjera, kur mbledheshin më tepër se 40 nxënës, do të organizoheshin çdo pasdite dy orë mësimi kushtuar gjuhës amtare. Mësuesit e tyre do të paguheshin nga komunitetet përkatëse ose nga shteti osman.

Të mos lejohej hapja e shkollave të huaja dhe krerët e komuniteteve fetare të mos ndërhyjnë në çështjet e arsimit. Ata kishin të drejtë që t'i rekomandonin Ministrisë së Arsimit vetëm programet e lëndëve fetare.

Alfabeti arab ishte i papërshtatshëm për natyrën e gjuhës turke. Prandaj, rekomandohej që në shkolla të futej alfabeti latin, i cili do të lehtësonte mësimin e gjuhës osmane dhe kulturën turke do ta

bënte të njohur në Europë.¹⁹

Për shkak të kërkesës së fundit, e cila duhet theksuar se ishte një kërkesë e guximshme për kohën, ai filloi të thirrej nga bashkëpunëtorët xhonturq me nofkën “Latinisti”.²⁰

Në të vërtetë programi i hartuar nga Dr. I. Temo në pjesën më të madhe të tij ishte aplikuar nga vetë administrata e Sulltan Abdylhamidit II,²¹ çka tregon se ai për shkak të viteve që kishte kaluar në emigracion, ishte shkëputur disi nga realiteti. Gjatë polemikës që zhvilloi me Ahmet Rizain, kur paraqiti programin për organizimin e sistemit arsimor në Perandorinë Osmane, ai e vuri theksin te nevoja e mbrojtjes së fëmijëve të krishterë, që ishin po aq atdhetarë sa ata myslimanë, nga rreziku i shkombëtarizimit. Ndalimin e shkollave të huaja dhe futjen e mësimin të gjuhës amtare për fëmijët e kombësive joturke, ai e konsideronte si një masë që do t'i priste rrugën procesit të asimilimit të të rinjve të krishterë shqiptarë. Ky program i Dr. I. Temos lidhur me organizimin e arsimit nuk u miratua, për shkak se asnjë koleg i partisë “Bashkim

19. *Po aty*, s. 158-159.

20. *Po aty*, s. 159.

21. Për këtë shih: Bayram Kodaman, *Abdülhamid devri eğitim sistemi*, Ankara: **Türk Tarih Kurumu, 1991**; Yahya Akyüz, *Türk Eğitim Tarihi (Başlangıçtan 2001'e)*, İstanbul: **ALFA, 2001**, s. 206-240; Hasan Ali Koçer, *Türkiye de Modern Eğitimin Doğuşu ve Gelişimi: 1773-1923*. İstanbul: M.E.B. Yayınları, 1991.

dhe Përparim” nuk e kishte hartuar pjesën e vet.²² Gjithsesi, tashmë ai ka hyrë në analet e historisë së arsimit dhe mendimit pedagogjik osman si programi arsimor i partisë “Bashkim dhe Përparim”, i hartuar nga Dr. I. Temo.

Në një Promemorie tjetër të shkruar në vitin 1904 dhe që zyrtarisht Perandorisë Osmane i është dërguar në emër të një Komiteti të kombësive të ndryshme,²³ Dr. I. Temo si autorë i saj parashtron si zgjidhje më të përshtatshme për çështjen kombëtare shqiptare dy alternativa:

a) ose vilajetet me popullsi shqiptare të bashkoheshin në një vilajet më vete, duke u veçuar nga territoret e tjera dhe mbi këtë bazë të zbatoheshin edhe reformat;

b) ose të pengoheshin ndërhyrjet e Fuqive të Mëdha në tërësi dhe nga qeveria osmane të zbatoheshin reforma të përgjithshme për të gjithë Turqinë Europiane.

Krahas këtyre alternativave propozoheshin edhe disa masa me karakter administrativ, ku me interes për objektin tonë të studimit është pika katër, sipas së cilës nga qeveria osmane kërkohej që shkollat e huaja të hiqeshin nga duart e klerit dhe të vendoseshin nën kontrollin e shtetit, sepse ato ishin bërë burim

përçarje midis popujve të ndryshëm të Perandorisë. Kjo masë sugjerohej edhe për grekët e bullgarët, të cilët financonin dhe kishin nën kontroll një pjesë të madhe të këtyre shkollave.²⁴ Të njëjtin problem ai e shtroi edhe në një letër që i dërgoi ministrit të Brendshëm, Ebu Mukbil Kemal beut, e cila faktikisht kishte trajtën e një promemorie dhe që indirekt i drejtohej vetë sulltanit. Në letër ai shkruante se Madhëria e tij ishte në dijeni se në gjykimin e Europës, Perandoria Osmane kishte mbetur prapa dhe për të mos prishur harmoninë e qytetërimit evropian, turqit duheshin dëbuar sa më parë nga Europa. Këto projekte drejtoheshin kundër turqve si myslimanë dhe ishin mbeturinë e kohës së kryqëzatore. Por edhe periudha e zbatimit të këtyre mendimeve, sipas tij, nuk do të ishte e largët. Në këtë parashtrësë ai ndalet edhe në politikën e Bullgarisë ndaj Turqisë Europiane. Bullgaria, sipas Dr. I. Temos, po tregohej shumë aktive dhe rrezikonte më shumë se çdo shtet ballkanik popujt e saj. Bullgarët ishin duke punuar me anë të shkollave dhe të kishave, që vetë qeveria osmane i kishte lejuar zyrtarisht, për të përgatitur truallin për pushtimin e vilajeteve shqiptare dhe maqedonase. Ata ishin duke pritur shkatërrimin përfundimtar të Perandorisë Osmane, me qëllim

22. Ibrahim Temo `nun Ittibad ve Terakki..., s. 160.

23. K. Prifti, *Doktor Ibrahim Temo...*, f. 193-194.

24. *AQSH*, F. 19, D. 18, fl. 91-93. Promemorie e hartuar nga Ibrahim Temo drejtuar Portës së Lartë, 1904.

për të realizuar projektet e tyre. Por, sipas tij, që tani ende pa ndodhur kjo, ata po përpiqeshin që me “butësi” të shkëpusnin diçka.²⁵

Në një shkrim të titulluar “Mbi intrigat e fqinjëve në Shqipëri dhe në Maqedoni”, i cili sipas studiuesit Kristaq Prifti i takon fundit të vitit 1904, Dr. I. Temo denoncon botërisht përpjekjet që qarqet politike të Athinës, Beogradit dhe Sofjes ishin duke bërë për të shkombëtarizuar popullsinë shqiptare e veçanërisht brezin e ri, me anë të shkollave dhe kishës. Ai e trajtonte veprimtarinë e tyre si një prelud të copëtimit të Shqipërisë dhe njëkohësisht bënte thirrje se nëse shqiptarët nuk ngriheshin qysh tani, fqinjët ballkanikë do të rrëmbenin pjesët më të mira të atdheut. Dr. I. Temo i ftonte shqiptarët që të shfrytëzonin situatën dhe të përfitonin nga ashpërsimi i kontradiktave midis Fuqive të Mëdha për shkak të çështjes së Lindjes dhe Luftës Ruso-Japoneze të 1904-1905-sës.²⁶

Pas Revolucionit Xhonturk të vitit 1908, ashtu si tek të gjithë shqiptarët edhe te Dr. I. Temo u ngjallën shpresa të mëdha për të ardhmen e Perandorisë e të popullit shqiptar. Pikëpamja e partisë “Bashkim dhe Përparim” (“İttihat

ve Terakki”), lidhur me çështjen e përdorimit të gjuhës ishte: në shkollat fillore shtetërore mësimi përveçse në turqisht do të zhvillohej edhe në gjuhën që flitej nëpër vilajete; në shkollat e ndërmjetme zhvillimi i mësimin në gjuhën turke ishte i detyrueshëm, ndërsa gjuha lokale do të lihej me zgjedhje; hapja e shkollave private do të ishte e lirë, me kusht që ato të ishin nën kontrollin e shtetit.²⁷ Ndërsa në Kushtetutë këto të drejta sanksionoheshin në nenin 15 ku thuhej: “Mësimet janë të lira. Çdo qytetar osman ka të drejtë, brenda kufijve të ligjit, të hapë shkolla publike apo private”. Ndërsa sipas nenit 16: “Të gjitha shkollat janë nën kontrollin e shtetit”; “Turqishtja është gjuhë shtetërore; nëpunësi i shtetit është i detyruar të dijë turqisht” (neni 18). Kjo politikë që në fillim hasi në kundërshtimin e plotë të popujve myslimanë (arabët, shqiptarët, kurdët, etj.) dhe jomyslimanë (grekët, armenët, bullgarët, rumunët, etj.). Ajo u perceptua dhe u konsiderua si një politikë nacionaliste, e cila synonte haptazi turqizimin e kombësive joturke.²⁸ Situata u acarua sidomos

27. Julius Richter, *A History of Protestant missions in the near East*, Edinburgh: Oliphant, Anderson & Ferrier, 1910, p. 180; Tark Zafer Tunaya, *Türkçe'de Siyasal Partiler*, c. I, İstanbul: İletişim Yayınları, 1998, s. 34-35; E.Ziya Karal, *Osmanlı Tarihi...*, s. 129.

28. İlay İleri, “Batı Gözüyle Meşrutiyet Döneminde Osmanlı Hükümetlerinin Dil ve Eğitim Politikalarına Karşı Tepkiler”,

25. *AQSH*, F. 19, D. 31, fl. 75-79. Promemorje e hartuar nga Ibrahim Temo drejtuar ministrit të Brendshëm të Perandorisë Osmane, 1904.

26. K. Prifti, *Doktor Ibrahim Temo...*, f. 199.

pas vendosjes së detyrueshme të gjuhës osmane në shkollat e ciklit të ndërmjetëm. Ky akt, nga etnitë e ndryshme u perceptua si faza e parë e procesit të turqizimit dhe shkaktoi një valë të madhe zemërimi.²⁹

Pavarësisht shenjave jo të mira që kishin filluar të shfaqeshin, në kuadër të ndryshimeve që ishin duke ndodhur pas Revolucionit, Dr. I. Temo hartoi një Projektligj mbi reformimin e sistemit arsimor osman, të cilin do t'ia paraqiste për miratim Parlamentit. Dorëshkrimi i këtij Projektligji nuk ka datë, por ne i përmbahemi mendimit të studiuesit Kristaq Prifti, i cili shkruan se ai mund të jetë hartuar në verën e vitit 1909, pas ngjarjeve kundërrevolucionare të prillit të atij viti.³⁰ Në hyrje të tij, ai shkruan me nota vlerësuese për sistemin arsimor austro-hungarez dhe duke marrë parasysh që edhe Perandoria Osmane ishte një shtet multietnik ashtu si Austro-Hungaria, e paraqiste atë si shembull që mund të ndiqej edhe për organizimin e sistemit arsimor osman.³¹ Projektligji i hartuar nga Dr. I. Temo përmbante këto pika:

OTAM (Ankara Üniversitesi, Osmanlı Tarihi Araştırma ve Uygulama Merkezi Dergisi), sayı: 18, 2005, s. 214.

29. Mustafa Ergün, *II. Meşrutîyet Devrinde Eğitim Hareketleri, 1908–1914*, Ankara: Ocak Yayınları, 1996, s. 483-484.

30. K. Prifti, *Doktor Ibrahim Temo...*, f. 254.

31. *AQSH*, F. 19, D. 24, fl. 23-28. Projektligj mbi reformimin e sistemit arsimor osman i hartuar nga Ibrahim Temo, 1909; K. Prifti, *Doktor Ibrahim Temo...*, f. 254.

Arsimi fillor të ishte i detyrueshëm dhe i përgjithshëm, pa përjashtime dhe dallime kombëtare.

Mësimi në shkollat fillore të zhvillohej në bazë të programeve të hartuara nga Ministria e Arsimit.

Mësimet të bëheshin në gjuhën amtare, ndërsa gjuha osmane që ishte gjuhë zyrtare, të zhvillohej në një masë prej 7 orësh në javë.

Lëndë të tilla si historia, gjeografia, etj., të zhvilloheshin gjithashtu në bazë të programeve të miratuara nga Ministria e Arsimit, por gjithnjë në gjuhën që do të dëshironin nxënësit.

Shkolla e përgjithshme fillore, pavarësisht se kujt kombësie i përkiste, do të ishte nën kontrollin dhe inspektimin e Ministrisë së Arsimit.

Shpenzimet për shkollat fillore do të përballoheshin nga buxheti i shtetit.

Në qoftë se në fshatrat ose komunat ku kishte më shumë se 40 fëmijë hapeshin shkolla fillore, qoftë edhe në ndërtesa të gjetura nga vetë banorët, Ministria e Arsimit ishte e detyruar të dërgonte mësues për gjuhën osmane dhe për gjuhën lokale të vendit dhe t'i paguante ata nga buxheti i shtetit.

Të gjitha shkollat që do të pranonin programet dhe kontrollin e Ministrisë së Arsimit do të njiheshin si shkolla zyrtare, shtetërore.³²

32. *Po aty*.

Me këtë Projektligj, Dr. I. Temo, mendonte se do të arriheshin dy objektiva kryesorë: përparimi me hapa të shpejtë i Perandorisë Osmane dhe zhdukja e mosmarrëmeshjeve ndërmjet popujve të ndryshëm të saj. Futja e gjuhës amtare në shkollat osmane, sipas tij, ishte një

kusht i domosdoshëm për zbutjen e konfliktit ndërnacional në vend, ndërsa po të veprohej ndryshe shteti osman do të futej në kaos dhe do ta përfshinte një fatkeqësi e përgjithshme.³³

33. *Po aty.*

Mësimi i gjuhës shqipe gjatë Rilindjes Kombëtare e deri në fillimin e viteve '20 të shekullit të kaluar (pjesa e I-rë)

Prof. dr. Njazi Kazazi

Departamenti i Gjuhësisë
Universiteti i Shkodrës
“Luigj Gurakuqi”

Abstrakt

Proceset e ndryshme historike që ndodhën në Mesjetë lanë gjurmë të thella në zhvillimin e kulturës dhe të arsimit shqiptar. Shqipëria ishte e pushtuar dhe kundrejt synimeve asimiluese të të huajve, zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe u bë mjaft i vështirë. Në kushte të tilla, si gjuhë shkrimi në territoret shqiptare ishin latinishtja në veri dhe greqishtja në jug. Në shekullin XV gjuhë zyrtare u bë ajo turko-arabe, po krabas saj përdorej edhe gjuha latino-italiane. Megjithëse këto gjuhë depërtonin njëra pas tjetrës, ato nuk arritën të marrin statusin e gjuhës së folur nga populli, kështu që përdorimi i tyre u kufizua vetëm në administratën e pushtuesit, në shërbesat fetare dhe në shkollat e tyre. Në këtë kohë në vend njiheshin si institucione arsimore vetëm shkollat e huaja. Shqipja me sa duket filloi të mësohej më vonë, por përpjekjet për ta zhvilluar atë me alfabet original mund të kenë filluar që në shekullin XVII.

1. Vështtrim për mësimin e gjuhës shqipe para Rilindjes Kombëtare

Shqiptarët, ky popull i lashtë, kanë një nga historitë më të veçanta e më të larmishme, ndoshta ndër gjithë popujt e Evropës. Shekuj

me radhë shqiptarët u gjendën nën trysninë e luftërave të ndryshme, po kjo nuk i pengoi të krijonin një traditë të pasur në të gjitha aspektet e jetës dhe, veçanërisht, në kulturë dhe arsim. Në periudha të caktuara kohore shqiptarët qenë të pushtuar politikisht, por shpirti i tyre nuk

u pushtua kurrë; prej tij buruan këngët dhe vjershat më të bukura që i kushtoheshin atdheut e që andej rridhte dëshira e madhe e shqiptarëve për të mësuar gjuhën amtare dhe për të shkruar vepra të bukura në këtë gjuhë. Kështu përpjekjet për të realizuar këtë dëshirë nuk reshtën asnjëherë. Në të gjitha kohërat, në të gjitha stinët, në të gjitha skajet e Shqipërisë dhe me të gjitha mjetet, shqiptarët u përpoqën t'i jepnin gjuhës shqipe vendin e merituar.

Proceset e ndryshme historike që ndodhën në Mesjetë lanë gjurmë të thella në zhvillimin e kulturës dhe të arsimit shqiptar. Shqipëria ishte e pushtuar dhe kundrejt synimeve asimiluese të të huajve, zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe u bë mjaft i vështirë. Në kushte të tilla, si gjuhë shkrimi në territoret shqiptare ishin latinishtja në veri dhe greqishtja në jug. Në shekullin XV gjuhë zyrtare u bë ajo turko-arabe, po krahas saj përdorej edhe gjuha latino-italiane. Megjithëse këto gjuhë depërtonin njëra pas tjetrës, ato nuk arritën të marrin statusin e gjuhës së folur nga populli, kështu që përdorimi i tyre u kufizua vetëm në administratën e pushtuesit, në shërbesat fetare dhe në shkollat e tyre. Në këtë kohë në vend njiheshin si institucione arsimore vetëm shkollat e huaja. Shqipja me sa duket filloi të mësohej më vonë, por përpjekjet për ta zhvilluar atë me alfabet origjinal mund të kenë filluar që në shekullin XVII.

* * *

Gjatë periudhës së Mesjetës, kur shkollat ishin të rralla dhe jo të gjithë fëmijët mund t'i ndiqnin ato, njerëzit krijuan vetë sisteme, rrugë dhe forma pune, mjete didaktike dhe edukative për të mësuar dhe edukuar të vegjlit e tyre. Gjëgjëzat, fjalët e urta, përrallat etj., që përfaqësojnë një sintezë të mendimit pedagogjik shqiptar të kohës, zgjerorin horizontin e njohurive, vinin në punë imagjinatën, përgatisnin breznitë e reja për jetën, kështu që, për rrjedhojë, këto mjete, veç të tjerave, merrnin funksionin edukativ shkollor.

Me shumë rëndësi në zhvillimin e kulturës shqiptare ishte zhvillimi i letërsisë didaktike-pedagogjike. Shkrimi i shqipes me alfabet të huaj është dokumentuar që në Mesjetë. Letërsia shqipe e kësaj kohe në plan të parë kishte përmbajtjen fetare, po në të nuk mungonin të dhëna për gjuhën, si dhe për virtytet morale të popullit. Në këtë letërsi mishëroheshin përpjekjet për t'i bërë ballë kulturës së pushtuesit që kërkonte t'u imponohej shqiptarëve. Me këtë synim krijuan një numër i madh autorësh duke filluar nga humanistët shqiptarë në shek. XV, duke vazhduar më tej në shek. XVI-XVII me Buzukun, Budin, Bardhin e Bogdanin, si dhe mjaft autorë të tjerë në shek. XVIII. Kjo letërsi përshkohet gjithashtu edhe nga një frymë didaktike e pedagogjike.

Në këtë grup autorësh një vend

nderi zë Gjon Buzuku me veprën e tij “Meshari”, e cila përmban edhe disa fragmente me karakter laik. Rëndësia e kësaj vepre qëndron në faktin se ajo përbën të parin dokument (libër të plotë) të shqipes së shkruar në Mesjetë. Mendohet që kjo vepër të jetë shtypur diku në trevën e Shkodrës. Këtë mendim shpreh edhe Norbert Jokli, duke përcaktuar si vendbotimin e tij Shqipërinë Veriore, veçanërisht Shkodrën, sepse një murg, Shtjefën Shkodrani, shkroi në serbisht një “Triod” të Pashkëve, një pjesë të të cilit e botoi së bashku me Kamilo Xanetin (Camillo Zanetti) në këtë qytet më 24 dhjetor 1563, ku ndoshta 8 vjet më parë doli edhe libri i Buzukut.¹

Vepra e Lekë Matrangës “Mësimi i krishterë” ka rëndësi sepse “...është i pari dokument arsimor pedagogjik i një autori shqiptar, që është përpjekur për të organizuar mësimin fetar në gjuhën shqipe.”² Qëllimi kryesor i kësaj vepre ishte që edhe arbëreshët e Italisë të mësonin shqip dhe ta përdorin atë edhe në shërbesat fetare.

Të njëjtin qëllim me Matrangën kishin edhe Budi e Bogdani, më të cilët mendimi pedagogjik shqiptar shënon një shkallë më të lartë. Te “Doktrina e Krishterë” (1618), e cila është ndërtuar në formë dialogu, shprehet qartë dëshira e autorit për

gjuhën shqipe. Në një fragment kur xhakoni i thotë latinisht lutjet, prifti i kthehet dhe e pyet: “*Këto fjalë psi s’i thua mbë gjuhë tanë, ashtu si mun i ndigjojsb ma mirë...*”³

Vepra e Bogdanit “Çeta e Profetëve” është përdorur edhe si tekst mësimor. Nga ana strukturore ajo është e ndarë në disa pjesë të tilla që mund të konsiderohen edhe si njësi mësimore të veçanta për mësimin e gjuhës së shkruar shqipe.

Rilindësit tanë e kanë konsideruar si “*abetare të parë*” (kupto: tekstin e parë për mësimin e gjuhës shqipe të shkruar) veprën e Pjetër Budit, që u botua në Romë më 1621. Kalendari i Shoqërisë “Dija” në Vjenë, më 1908, f. 3-shkruan se “*Më 1621, kur doli në dritë libri shqip “Speculum confessionis”, e të ndyerit Emz. Budi, u lind edhe i pari abetar shqip*”.

Në shekullin XVIII, me përhapjen e Iluminizmit dhe të lëvizjeve të popujve për liri, erdhën edhe kërkesa të reja, mjaft të përparuara për kohën që lidheshin me shkrimin e shqipes dhe me zhvillimin e arsimit. Në këtë periudhë në Shqipëri ekzistonin disa shkolla të huaja si greke, latine etj., të cilat drejtoheshin nga kleri. Dëshmitë për shkolla edhe më të hershme i gjejmë në regjistrat kadastralë, si p.sh.: në regjistrin e Vendedukut për Shkodrën (vitet 1416-1417),

1. Kolë Ashta, “Leksiku historik i gjuhës shqipe”, I. Shkodër, 1996, f. 129.

2. ISP, “Historia e arsimit shqiptar”, Tiranë, 1990, f. 31.

3. Artan Haxhi - Tefë Topalli, “Histori e gjuhës së shkruar shqipe”. Shkodër, 1999, f. 115.

shkruhet se qyteti (Shkodra) kishte një shkollë dhe një tjetër gjendej në katundin e Podgorës.⁴

Ndërkohë u vunë re përpjekjet për arsim të disa elementëve atdhetarë me prirje iluministe. Kjo dukej sidomos në Shkollat e Voskopojës, Janinës etj., si dhe në veprimtarinë e pedagogëve të shquar si Grigor Voskopojari, Teodor Kavalioti, Kostë Beratasi, Teodor Haxhifilipi, të cilët lëvizjen arsimore e vunë mbi baza teorike. T. Kavalioti nga Voskopoja pati meritën e veçantë sepse ishte i pari që gjuhën shqipe e inkadroi në praktikën shkollore dhe në tekstet e tij mësimore. *“Vepra e tij ‘Protopiria’ (‘Mësimet e para’), botuar në Venedik, më 1770, është edhe manuali i parë shkollor fillestar i botuar, që njohim”*.⁵ Edhe në një dorëshkrim të Kostë Beratasit gjejmë të shkruar tekste në gjuhën shqipe, paralelisht me greqishten letrare dhe atë popullore, ndonëse kjo bëhej në dobi të greqishtes.

Ishin po këta autorë që shkruan me alfabet të huaj, ata që bënë përpjekje për shmangien e tij dhe për ta shkruar shqipën me alfabetë të veçanta. Ata frymëzoheshin në këto përpjekje nga bindja se nuk mund të kishte një shkollë kombëtare në qoftë se nuk zhvillohej një kulturë shqiptare e shkruar mbi bazën e

gjuhës amtare. Për të konkretizuar këtë bindje filluan të hartohen disa alfabetë origjinale në shqip. I pari që e mori dhe e konkretizoi këtë nismë ishte Anonimi i Elbasanit (shek. XVII), i cili u pasua nga Teodor Haxhifilipi etj. Këto alfabetë, për vetë kushtet në të cilat u hartuan morën një rëndësi të veçantë, sepse çdo germë shqipe, çdo fjalë shqipe ishte në emër të idealit të zhvillimit të shkollës kombëtare.

Që nga pushtimi osman e për një kohë të gjatë pothuajse në të gjitha shkollat mësimi bëhej në gjuhë të huaj, po gjithsesi nën ndikimin e faktorit shqiptar. Në Mesjetë arsimi dhe kultura ishin të lidhura në mënyrë të pandashme me fenë. Ndër shkollat greqishte më të zhvilluara që frekuentoheshin nga nxënësit shqiptarë kanë qenë shkollat e Janinës, të cilat kishin dhe arsimin e mesëm me tri klasë.

Në mesin e shek. XII, veç kulturës greke, në Shqipëri depërtoi edhe ajo latine si rrjedhojë e ndikimit të katolicizmit. Kjo kulturë preku fillimisht qytetet e bregdetit në të cilat flitej shqip dhe më pas krahinat e Shqipërisë së Veriut si dhe Ulqinin. Edhe në qytete e fshatra më të thella kishte shkolla në të cilat mësohej shkrim e këndim në latinisht. Këto vazhduan deri në shekullin XVII në Shkodër, Lezhë, Prizren dhe Shkup.

Më 1502, shqiptarët e shpërngulur në Venedik hapën një shkollë për fëmijët e tyre që u

4. Luigi Franja, *“H-ja nistore në shkrime të vjetra”*, “Hylli i Dritës”, Vjeti XXIII, 1994, Nr. 1-2, f. 125.

5. ISP, “Historia e arsimit shqiptar”. Tiranë, 1990, f. 34.

quajt *“Scuola degli albanesi”*, ku dhanë mësim edhe humanistë shqiptarë, si: Marin Biçikemi e Leonik Tomeu. Mësimi është zhvilluar në gjuhën shqipe, por janë mësuar edhe gjuha latine dhe greke. Shkolla ishte qendër e bashkatdhetarisë shqiptare, zbukuruar dhe pajisur me vepra arti me tema shqiptare nga piktori dhe skulptori shqiptar Viktor Kërpaçi (1455-1566) nga Korça.⁶ Në shek. XVI zunë fill edhe përpjekjet e arbëreshëve të Italisë për mësimin e shkrimit të shqipes. Më 1734, hapi dyert e tij Kolegji i Palermos në Sicili, ndërsa në vitin 1782 Kolegji i Shën Benedeto Ulanos në Kalabri. Mëgjithëse këto ishin në fillimet e tyre, kolegje fetare, shumica e nxënësve ishin arbëreshë dhe tregonin një dashuri dhe kujdes të veçantë për gjuhën amtare.

Në shek. XVI, pas një rezistence të gjatë, turqit omanë vendosën sundimin e tyre në Shqipëri dhe si rrjedhin filloi dhe konvertimi i shqiptarëve në fenë islame. Në këto kushte nuk mund të mos fillonte përhapja e shkollave turke (mejtepeve). Në shek. XVIII numri i këtyre shkollave u rrit shumë dhe filluan të fillojnë të funksionojnë edhe medresetë, si insitucione të arsimit të mesëm. Ndër dëshmitë e para të historisë së arsimit në këto treva është libri i udhëtarit turk Evlia

6. Kabineti pedagogjik: “Historiku i arsimit në Shkodër”, Vëllimi I, Shkodër, 1980, f. 4 (dorëshkrim) dhe “Historia e arsimit shqiptar”, Tiranë, 1990, f. 14.

Çelebi (1611- 1684) që në vëllimet 6-8 të veprës së tij shumëvëllimëshe “Seyahatnamë” (përkthyer në shqip prej Salih Vuçiternit nën titullin “Shqipëria para dy shekujsh”, Tiranë, 1930) flet, veç të tjerave, edhe për gjendjen arsimore në Shqipëri. Ndër të tjera, ai shprehet se banorët e Shkodrës janë krejtësisht shqiptarë, komb tjetër s’ka... e flasin krejt shqip. Gjithashtu ai thekson se: *“...ka dhjetë xhami dhe pranë çdo xhamie nga një medrese...”*. Mendimi ynë është se nuk bëhet fjalë për medrese në kuptimin e plotë të kasaj fjale, si shkolla të mesme, por për shkolla të ulëta, fillore, ku përveç besimit mësohej shkrim e këndim dhe aritmetikë.

Në këtë periudhë ekzistonin tri grupe shkollash:

*“mejtepet (shkollat fillore),
shkollat ruzhdije (qytetëse) tri
klasëshe,
idadije (gjimnazi civil), mektebi
asqerije (shkolla ushtarake), darul
mualiminë (shkolla për përgatitjen e
mësuesve).”⁷*

Në këto shkolla, ndonëse me programe turke, të gjithë nxënësit dhe pjesa më e madhe e mësuesve ishin shqiptarë dhe as nuk mund të mendohet se qëllimi kryesor dhe i vetëm i tyre ishte përhapja dhe mësimi i besimit.

7. Njazi Kazazi, “Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër (nga fillimet e tij deri në vitet ’20 të shek. XX)”, Monografi, Universiteti i Shkodrës “L. Gurakuqi”, ISA. Shkodër, 2014, f. 32.

Përpjekjet e feudalëve shqiptarë në Veri dhe në Jug për të krijuar shtete të centralizuara, jashtë varësisë turke, kërkonin edhe zhvillimin e arsimit mbi shkollën qytetëse, sepse vetëm kështu mund të përballonin drejtimin e shtetit në të gjitha fushat. Këtu zënë fill edhe përpjekjet e Mehmet Pashë Plakut, i cili themeloi të parën medrese në Lagjen Qafë. Kjo mendrese bënte pjesë në *“Kompleksin arsimor-kulturor”* të Bushatlinjve, që zuri fill rreth viteve 1770-1780, në të cilin bënë pjesë edhe biblioteka dhe konvikti (internati). Me ardhjen në fuqi të Karamahmud Pashës, u hap nga ai edhe një medrese tjetër në Pazar (Pazarin e Shkodrës).⁸ Medresetë e hapura nga Bushatlinjtë, në kohën e lulëzimit të tyre, qenë vepra shqiptare se mësimi bëhej shqip, mbaheshin me fonde shqiptare, nxënësit dhe mësuesit ishin tërësisht shqiptarë. Në historinë e arsimit ky fakt nuk është i parëndësishëm.

* * *

Futja dhe përdorimi i gjuhës shqipe të shkruar u bë nevojë e domosdoshme për kohën. Populli nuk kuptonte as greqisht, as latinisht e as osmanisht. Kështu filluan të konkretizoheshin përpjekjet për arsimim në gjuhë amtare. Të qenësishëm këtë fakt e bëjnë gjurmët që ndeshen më 1632 në

dy shkolla të Lezhës, më 1638 në shkollën e Pllanës, më 1639 në shkollën e Blinishtit, e cila mori përmasat e një gjimnazi, pasi që në fillim kishte 50 nxënës dhe më 1690 një shkollë tjetër funksiononte në Velë të Mirditës.⁹ Alfabeti latin i përshtatej më së miri gjuhës shqipe (ndonëse nuk i plotësonte të gjitha kërkesat e përmbajtjes tingullore të shqipes) dhe kjo ishte një mundësi më shumë për zhvillimin e arsimit shqip në të gjitha qendrat, përfshirë edhe Shkodrën. Kështu më 1745 funksionoi një shkollë me 30 nxënës dhe mësues laikë, më 1775 në Sheldi u hap një shkollë tjetër nën drejtimin e një kleriku vendës. Edhe në qytetin e Shkodrës, më 1789, Filip Shkodrani hapi një shkollë fillore.

Mendojmë se duhet shënuar se zhvillimet e arsimit në gjuhën shqipe në trevën e Shkodrës bëheshin edhe me interesimin e drejtpërdrejtë të Perandorisë dualiste (Austro-Hungareze), e cila në marrëveshje me Portën e Lartë, nëpërmjet traktateve të Karloviçit (1699), të Pazaroviçit (1718) dhe të Beogradit (1739), kishte fituar të drejtën e *“protektoratit të kultit”* në Shqipëri.¹⁰

Edhe në Kosovë dhe Rrafshin e Dukagjinit u bënë hapa të dukshëm në këtë aspekt. Që në shek. XVI në këtë trevë u aplikua mësimi dhe shkrimi i shqipes me alfabet latin.

8. Shefik Osmani, *“Kompleksi arsimor-kulturor i Pashallëkut të Shkodrës”*, në *“Drita”*, 3 tetor 1982.

9. Jup Kastrati, *“Disa të dhëna mbi historikun e arsimit në Shkodër”*, në *“Arsimi popullor”*, 1964, Nr. 2, f. 134.

10. Mikel Prennushi, art. i cit. f. 67.

Në Janievë të Kosovës që në shek. XVII ekzistonte një shkollë ku mësohej shqip në shtëpinë e Andrea Bogdanit, madje informacionet flasin për një shkollë më të hershme në Lesnicë të Shkupit, më 1584 dhe një tjetër në Strumbull të Gjilanit, të cilat më shumë se sa shkolla ishin kolegje fetare.

Kjo punë vazhdoi deri në shek. XVIII. Në Gjakovë mësimi i shqipes vërtetohet që më 1782 dhe si tekst mësimor u përdor katekizmi që kishte bërë Gjon Nikollë Kazazi. Në këto shkolla përveç “Doktrinës së Krishterë” që kishte sjellë në shqip Budi, mund të përdorehin edhe materialet e botuara nga Kuvendi i Arbërit (1703). *“Në kolegjet përveç teologjisë, mësohej filozofia dhe studiobeshin klasikët. Mësimet në këtë shkolla zhvilloheshin edhe në gjuhën e vendit (lingua vernacula). Për këto arsye këto i donte populli sepse veç të tjerave ai dëgjonte dhe shkruate aty gjuhën amtare”.*¹¹

Në kushtet e një përhapjeje të tillë të shkollave lindi nevoja e teksteve mësimore. Priftërinjtë-mësues shqiptarë bënë përçapje në këtë drejtim, duke bërë disa tekste në shqip të cilat gjithsesi ishin në nivelin e teksteve fetare. U përdorën si tekste mësimore nga nxënësit: vepra e Budit, “Çeta e profetëve” nga Bogdani, “Fjalor latinisht-shqip” i Bardhit, “Gramatika latinisht-shqip” e Andre Bogdanit, “Gramatika

e shqipes në italisht” (1914) e Da Leçes, si dhe mjaft tekste të tjera.

Edhe në Jug të vendit hapja e shkollave mori përmasa të mëdha, por këtu shqipja mësohej me alfabetin grek. Mësimi i shqipes këtu u bë më i nevojshëm për të lehtësuar mësimin e greqishtes. Më 1627, prifti Neofil Rodino hapi një shkollë në bregdetin e Himarës; më 1660 U. Kostandini rihapi shkollën e Dhërmiut; më 1663 një shkollë tjetër u hap në Plasë nga Jan Krisafida dhe më 1703 në Elbasan hapet një shkollë greke ku dha mësim Dhaskal Todri. Po shqiptarët nuk ishin të kënaqur me shkolla të këtij niveli. Kështu më 1737, Spiro Strati mori nismën për të hapur një shkollë në Delvinë të cilën e identifikoi me emrin “*Institut diturie*” për nxënës. Jo vetëm kaq, po më 1749 hapet një e ashtuquajtur “*Akademi e Delvinës*”, në të cilën mësohej greqisht e latinisht. “*Bregdetasit i donin këto shkolla sepse nëpërmjet tyre populli gjente mënyrën që jo vetëm merrte dituri, por edhe bënte përpjekje për të ushtruar gjuhën e vet e për të përtërirë kulturën kombëtare*”.¹²

Një ngjarje me rëndësi në historinë e arsimit shqiptar është hapja e një shkolle në gjysmën e dytë të shek. XVII, në Voskopojë. Më 1750 kjo shkollë mori emrin “Akademia e Re”, sepse programi i saj ishte në nivel akademik. Edhe këtu gjuha shqipe zuri vend me pretekstin për të lehtësuar mësimin

11. ISP, “Historia e arsimit shqiptar”. Tiranë, 1990, f. 44.

12. Po aty, f. 46.

e greqishtes, po poshtë kësaj vlonte dëshira e atdhetarëve që fëmijët e tyre të mësonin gjuhën shqipe në shkolla.

2. Mësimi i gjuhës amtare gjatë Rilindjes Kombëtare në shkollat shqipe

Siç dihet, Rilindja Kombëtare qe një lëvizje e madhe atdhetare, mendore, kulturore, arsimore etj., që përshkoi të gjitha fushat e jetës shqiptare, qe një periudhë që karakterizohet nga rilindja e kombit dhe futja e tij në rrugën e përparimit si kombet e tjera të Evropës. Ajo përfshiu të gjitha sferat e jetës shpirtërore, morale, ushtarake, materiale etj., që gjeti edhe një pasqyrim të fuqishëm në fushën e arsimit kombëtar dhe të mësimin të gjuhës shqipe. Kombi shqiptar ende vuante pasojat e administrimit osman, i cili nuk lejonte hapjen e shkollave në gjuhën amtare. Kështu rilindësit, duke analizuar të gjitha rrugëzgjidhjet e kësaj situatë, arritën në përfundimin se aspirata e tyre për një Shqipëri të lirë e të pavarur, mund të bëhej realitet vetëm nëpërmjet dy rrugëve të cilat ishin në funksion të njëra-tjetrës:

së pari, nëpërmjet luftës së armatosur;

së dyti, nëpërmjet lëvrimin të gjuhës shqipe në shkollë, gjë e cila do të çonte padyshim në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, nën idenë se "...drit' e diturisë përpara do na

shpjerë...", që ishte sintezë e ideve iluministe të rilindësve tanë.

Edhe pas dekretit të Gjylhanesë, i cili në fushën e arsimit parashikonte që sistemi arsimor të organizohej në shkolla shtetërore, trevat shqiptare nuk përfituan asgjë, madje as nga reformat e tjera të këtij dekreti. Si rrjedhojë, në atë kohë, mundësia për t'u arsimuar varej nga përkatësia fetare. Shkollat dhe mësimi i gjuhës shqipe ishin objekt i goditjeve të vazhdueshme nga ana e pushtuesit.

Me kalimin e kohës "... u rrit nevoja për një arsim laik, shqip nga gjuha, kombëtar nga fryma dhe praktik për jetën"¹³

Nga disa të dhëna rezulton se në gjysmën e parë të shek. XIX, në Shkodër kanë funksionuar disa qendra arsimore nën drejtimin e mësuesve vendës, si: Gegë Kodheli, Gjon Shkrumi, Zef Kamsi etj. Kodheli hapi më 1830 një shkollë të cilën e frekuentonin 50 nxënës. Këto qendra arsimore ishin të shpërndara në lagje të ndryshme të qytetit, mbaheshin me ndihma nga qytetarët, mësimet bëheshin në gjuhën shqipe dhe nuk kishin ndonjë sistem didaktik për t'u dalluar. Rreth mesit të këtij shekulli kleri katolik solli mësues të huaj, që kishin nivel më të lartë. Një ndër këto shkolla është edhe ajo e Gjergj Benusit, i cili mbajti një shkollë shqipe në shtëpinë e tij për 12 vjet. Punën e tij e vazhdoi

13. ISP, "Historia e arsimit shqiptar", Tiranë, 1990, f. 63.

edhe i biri, Gaspri, didakti i njohur i Rilindjes, autori i shumë teksteve shkollore dhe në veçanti i abetareve shqipe, ndër të vetmit shkodranë që bashkëpunoi me Shoqërinë e Bukureshtit. Edhe në treva të tjera të vendit gjenden dëshmi për mësimin e shkollën shqipe. Fakti që disa të moshuar, madje edhe femra, në fund të shek. XIX, dinin të shkruanin dhe të lexonin në gjuhën amtare, flet qartë për rolin e këtyre shkollave dhe kontributin që dhanë për të mbajtur gjallë gjuhën e shkruar shqipe. Për raste konkrete, me emra, është shkruar që herët në shtypin shkencor, madje që në fillimet e shek. XX.¹⁴

Ndonëse nën presionin e përndjekjeve dhe rrezikut për jetën, shqiptarët dhe gjuha shqipe tashmë ishin kthyer në një binom të pandashëm dhe falë kësaj nuk i trembeshin asgjëje. Rilindësit kishin bindjen se arsimi duhet të zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe dhe me një alfabet të përbashkët. Për këtë qëllim ata vetë hartuan tekste mësimore, veçanërisht abetare shqipe, duke i quajtur këto si të vetmet mjete për mësimin e gjuhës amtare të shkruar.

I pari që bëri udhë në këtë drejtim, ishte Naum Veqilharxhi,

14. Shih për këtë revistën "Dituria", janar 1928; J. Kastrati e L. Franja, art. i cituar. Autori i fundit ka dhënë edhe 7 letra të familjeve Suma e Muzhani të viteve 1829-1846, duke treguar se gjuha shqipe përdorej në letërkëmbimin tregtar dhe privat që në ato vite.

i cili krijoi një alfabet original me 32 tinguj-shkronja, dhe më 1844 botoi tekstin e parë për mësimin e gjuhës së shkruar, me titull **"Fort i shkurtër dhe i përdorçim Ëvetar shqip..."**, prej 8 faqesh. Një vit më vonë e ribotoi atë, duke e plotësuar dhe shtuar vëllimin në 45 faqe, nën titullin **"Farë i ri Ëvetar shqip për djelm nismëtorë..."**. Autori i të parës abetare shqipe i njeh një rol të pazëvendësueshëm arsimimit dhe shkollës në luftë për një Shqipëri të pavarur dhe veç kësaj mendon se i vetmi mjet didaktiko-pedagogjik i kësaj shkolle është gjuha shqipe. Sipas tij, të mësuarit në gjuhë amtare është parësore dhe e domosdoshme, sepse *"... edhe kur të arrijë në mësimet të larta, përsëri në gjuhë të tij merr shpejt përpara, prandaj po të njohë gjuhën e tij mirë, shpejt dhe lehtë mëson çdo (gjuhë) të huaj"*.¹⁵

Në mesin e shek. XIX në të gjitha trevat shqiptare, kishte filluar në njëfarë mënyre mësimi i gjuhës së shkruar në shkollat e kohës. Nga korespondenca e korçarëve me Veqilhaxhin (1845) mësohet se me tekstin e tij të abetares, mësimi i shqipes filloi të përhapej jo vetëm në Korçë, por edhe në Përmet, Berat e gjetkë. Në vitet '50-60 të shek. XIX, fqinjët e Shqipërisë shpejtuan të hapin mjaft shkolla që përbënin një rrezik për kulturën dhe arsimin

15. Instituti i Studimeve Pegagogjike, "Historia e arsimit shqiptar". Tiranë, 1990, f. 66.

shqiptar, por si kundërpërgjigje e kësaj, mjaft elementë intelektualë-atdhetarë, morën nisma për të hapur shkolla shqipe. Panajot Dhima më 1851 ngriti një shkollë për vajza në lagjen Varosh të Gjirokastrës; Anastas Byku më 1861 botoi edhe një libër për mësimin e gjuhës së shkruar shqipe, titulluar “Gramë për shqiptarët”, në të cilin përdorej alfabeti grek për mësimin e shqipes. Ndërkohë që në trevën e Shkodrës në këtë periudhë pati një lulëzim të përhapjes së shkollave shqipe. Më 1859 u hap një shollë për vajza nga Kushe Mica, Tina Nika e Terezë Bërdica. Shkolla e Benusit, Gasprit, me një farë sistemi didaktik, vazhdonte prej vitesh. Më 1959 shënohet ditëlindja e Seminarit Papnuer me 20 nxënës. Më 1861 u hap shkolla Fretnore. Më 1877 filloi punën Kolegji saverian i Jezuitëve dhe më 1879 Motrat Stigmatine çelën një shkollë për vajza.

* * *

Në vitet ‘50 e më pas përpjekjet e shqiptarëve brenda atdheut u bashkuan me veprimtarinë e madhe e të gjithanshme të atdhetarëve në mërgim, të cilët tashmë po organizoheshin në shoqëri atdhetare, arsimore e kulturore, duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për përhapjen e mësimin shqip, për botimin e teksteve shkollore, krahas revistave, gazetave etj. etj. Bashkatdhetarët në mërgim u vunë në shërbim të luftës për liri, të gjuhës

shqipe dhe arsimit kombëtar, me të gjitha mjetet e mundësitë e mbi të gjitha me dëshirën e tyre të zjarrtë.

Në fundin e viteve ‘60, Daut Boriçi, më vonë kryetar i degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Shkodrën, botoi dy abetare me alfabet turko-arab dhe me 7 tinguj-shkronja që i krijoi vetë, për të plotësuar nevojat tingullore të shqipes. Pavarësisht nga alfabeti, ai futi në shkollat e kohës gjuhën shqipe dhe e konsideronte atë si pikënisje për arsimimin e breznive të reja, duke vënë turqishten në plan të dytë.¹⁶

Bashkëkohës me D. Boriçin, Konstandin Kristoforidhi, intelektual i përmasave evropiane, zë një vend të nderuar në radhën e gjatë të rilindësve që dhanë ndihmesën e tyre për mësimin e gjuhës së shkruar shqipe. Kushtrimi i Kristoforidhit se “...po ndëmos u shkroftë gjuha e shqipes edhe sot mbë këtë ditë, nuk do të shkojnë shumë vjet, dhe nuk do të ketë më Shqipëri në faqe të dheut, as nuk do të shënonetë më emri i Shqipërisë në hartat e botës, as nuk do të përmendet më bir shqiptari e bijë shqiptare pas kësaj jete...”

¹⁷ shprehte një rrezik konkret dhe ishte një program lufte e pune për

16. Shefik Osmani - Njazi Kazazi: “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike”. Botim i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe Shtëpisë “Idromeno”. Tiranë, 2000, f. 85-92.

17. Po aty, “Tri abetaret e Konstandin Kristoforidhit, 1867-1872”. Tiranë, 2000, f. 71- 84.

gjithë rilindësit dhe shqiptarët në përgjithësi.

Kristoforidhi, krahas veprave të tij madhore si botimeve në shqip të Dhiatës së Vjetër e të Re, Gramatikës shqipe dhe Fjalorit shqip-greqisht, prozës së bukur “Gjahu i malësorëve” etj. “... në dhjetor 1867 kishte në shtyp abetarten gegërisht, ndërsa abetarja toskërisht ishte gati në fund të janarit 1868”¹⁸ duke dhënë ndihmesë konkrete në këtë fushë.

Abetaret e Kristoforidhit dallohen në vargun e gjatë të abetareve shqipe për nivelin bashkëkohor të strukturës së tekstit dhe metodat e transmetimit dhe të formimit të aftësive dhe shprehive të lexim- shkrimit, për gjuhën e bukur dhe të zgjedhur në varësi të moshës së fëmijëve, për nivelin e lartë artistik të pjesëve dhe modelin e letërsisë didaskalike që dha.

Edhe arbëreshët e Italisë qenë shumë aktivë ndaj këtij problemi kaq të mprehtë e që lidhej me qenien e kombit shqiptar. Për këtë ata ngritën disa qendra mësimore, për të cilat këmi folur më sipër, por rëndësi të veçantë pati themelimi i Katedrës së gjuhës shqipe (1849), me kontributin e jashtëzakonshëm të Jeronim de Radës. Vetë ngritja e Katedrës në këtë kolegji, që sipas Dora D’Istrias, kishte premisa për të marrë statusin e një universiteti, dëshmon se për

arbëreshët jo vetëm duhej të flitej shqipja, por duhej shkruar dhe studiuar në nivel të lartë.

Nuk do të kishte kuptim të flasim për problemet e arsimit në shqip në periudhën e Rilindjes Kombëtare pa vënë në dukje programin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (LSHP) në këtë fushë. Idetë dhe platforma arsimore e kësaj periudhe u bënë pjesë e përbërëse e shumë veprave, artikujve dhe fjalimeve të ideologëve të shquar të Rilindjes Kombëtare. Një pikë kulmore në programin arsimor të LSHP përbën botimi dhe përhapja në mënyrë të rrufeshme e **“Alfabetare e gluhësë shqip”**, ose Alfabetarja e Stambollit, siç quhet shpesh në shtypin pedagogjik, nga Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip e Stambollit.

Në “Alfabetare...” trajtohen disa nga problemet më themelore të kohës që ishin shtruar për zgjidhje. Ky tekst, si rrallë ndonjë tjetër, shkon në përputhje me ngjarjet politike, arsimore, kulturore të LSHP dhe zbatohen në përmbajtjen e saj, në mënyrë të plotë, pikat e programit kombëtar për arsimimin e breznive të reja dhe mësimin e gjuhës shqipe të shkruar nga masat e popullit.

Në vargun e shumë problemeve të rëndësishme që shtroheshin për zgjidhje, çështja e një alfabeti të përbashkët¹⁹ për të gjithë shqiptarët, mbajtja gjallë dhe lëvrimi

18. Xhevat Lloshi, “Veprimtaria arsimore e K. Kristoforidhit”, në “Revista pedagogjike”, 1976, Nr. 1, f. 152.

19. Tomor Osmani, “Udhë e shkronjave shqipe”, Tiranë, 1999, f. 172.

i mëtejshëm i gjuhës shqipe të shkruar, ishin ndër më të mprehtit. Në aspektin e politikës gjuhësore, kulmin e veprimtarisë së saj, LSHP e arriti në qershor-tetor 1879, me diskutimet për alfabetin dhe krijimin e “Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip”. Motoja e kësaj shoqërie u bë “Tempulli i shqiptarëve janë shkollat shqipe dhe gjuha e shenjtë për ta është vetëm gjuha shqipe”. Në nenin e parë të “Kononizmes...” sanksionohej se shkronjat (kupto: librat) që do të shtypë kjo shoqëri do të jenë *“shkronja mësimi”*.

Kërkesat për shkolla dhe arsim në gjuhë amtare, shtoheshin njëherësh, në një plan, me çlirimin nga pushtuesit e huaj dhe me *“mëvehtësinë”* e popullit shqiptar, sepse *“Sot është dita, -shkruante Samiu, q’edhe Shqipëtarë të të xënë të shkruajën’ e të këndojnë gjuhën’ e tyre, që të mundinë të ruajnë kombinë”*.²⁰

Nuk është e rastit që bashkautorët e kësaj abetareje janë katër ndër personalitetet më përfaqësuese të lëvizjes mendore të Rilindjes: Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto e Koto Hoxhi, që përfaqësohen me pjesë të ndryshme, duke krijuar kështu një vepër kolektive. Në kuadrin e gjithë përpjekjeve të Lidhjes dhe Komitetit të Stambollit për hapjen e shkollave shqipe, “Alfabetarja...” nga ana didaktike

plotëson një nevojë të kohës për tekste shkollore për mësonjëtorët e para (kupto: shkollat fillore). Teskti në fjalë (që u botua në 20 000 kopje) nuk mund të quhet thjesht një libër leximi; ai është dokument didaktik arsimor që përfshin abetaren, gramatikën e gjuhës shqipe, aritmetikën, gjeografinë (dheshkronje), historinë e deri edhe edukimin moral, në përputhje me planin mësimor të arsimit fillor, të projektuar nga rilindësit.

Në “Alfabetare...” përfshihet, veç të tjerave, edhe një shkrim i Samiut “Gjuha shqip”, në të cilin, përveç jehonës që i bën mësimin në gjuhën shqipe, e quan atë kusht për qenien e një kombi dhe shpreh drujtjen e tij ndaj asimilimit. E gjithë esenca e konceptit rilindës për çështjen e gjuhës shqipe shprehet dhe merr formë në fjalët e Samiut *“...çdo shqipëtar, i madh e i vogël, të shkruan’ e të këndonjë gjuhën e tij që ka mësuarë me qumështit të s’ëmës, në do të jetë për gjithë jetën ajo që fëmijë e tij, bark pas barku, shqipëtar dhe në ka dëshirin që të rronj’ e të jetë Shqipëria e shqiptarija jetë pas jete e të ndritohet edhe kombi ynë me dituri, më pasje e me rrojtje të mirë.”*²¹ Ishin këto fjalë që u kthyen në slogan për lëvizjen e Rilindjes së kombit, ato që u kujtonin rilindësve dhe mbarë kombit se asnjëherë nuk duhet menduar se kanë bërë mjaft për gjuhën shqipe. Jani Vreto

20. Sami Frashëri, “Gjuha Shqip”, në “Alfabetare e gjuhëse shqip”, Ndë Konstantinupojë, 1879, f. 29.

21. Sami Frashëri, “Gjuha shqip”, në “Alfabetare...”, f. 32.

e shpjegon në tekst me hollësi nga pozita e didaktit, rrugën e mësimin të gjuhës shqipe, përmbajtjen tingullore të saj etj.

“Alfabetarja...” qe një gur themeli në rrugën e gjatë e të pasur të teksteve shkollore shqipe, model dhe pikë referimi për autorët e mëvonshëm.

Për publikimin që i bëri alfabetit të Stambollit i cili i u përdor deri më 1908 dhe për ndihmesën që dha kjo abetare për mësimin e gjuhës shqipe, të shkruar nga dhjetëra brezni, Sami Frashëri do të shkruante me entuziazëm: “...më njëzet vjet shkronjat shqip lëshuan aq rrënjë të shëndosha e zënë aq themele të forta, sa s’mund të shkulen dhe të rrëzohen kurrë...Ky dru (kupto: “Alfabetaren...” shën. Im - Nj. K.) q’u vu njëzet vjet më parë, u lulëzua edhe dha pemë fort t’ambla e të bukura.”²²

Gjatë vitit 1880, Porta e Lartë ndërmori një sërë goditjesh kundër Shoqërisë së shkronjave, duke mos lejuar më as botime librash, as ngritje shkollash shqipe. Vetëm dega e asaj me qendër në Bukuresht i shpëtoi këtyre ndjekjeve dhe më vonë kjo degë do të mbetej ndër shpresat e vetme për realizimin e programit arsimor të LSHP.

Problemi i gjuhës shqipe, tashmë, ishte bërë pjesë përbërëse themelore e programit politik e kulturor, çlirimtar dhe demokratik

të Rilindjes.²³ Gjuha shqipe shihej si një ndër rrugët e bashkimit të popullit pa dallim feje a krahine dhe nëpërmjet tij mund të arrihej te çlirimi kombëtar. Pikërisht këtu konsistonte pjesa më e madhe e krijimeve të kësaj periudhe. Poezitë e P. Vasës, Gj. Fishtës, N. Frashërit, N. Mjedës e ngrinin në pedestal gjuhën shqipe.

2. 1. Përpjekjet për mësimin e gjuhës shqipe në vitet 1880-1908

Edhe pas LSHP përpjekjet për lëvrimin e gjuhës shqipe u thelluan dhe u çuan më tej. Në këtë periudhë në mënyrë të fshehtë funksiononin disa shkolla, si: në Korçë, Dibër, Krujë, Berat, Kolonjë, Gjirokastrë, Çamëri etj. Gjithashtu edhe në vilajetin e Shkodrës mësimi i shqipes së shkruar kishte bërë hapa përpara. Ajo mësohej në Troshan - 1882, në Shkodër - 1887, në Blinisht - 1891, në Pllanë - 1898, ndërkohë që edhe në Milot, Rrëshen, Hajmel, Bushat, Lezhë, Rubik, Kallmet etj., ishin hapur shkolla shqipe. Gjuha amtare në këto shkolla mësohej në mënyrë të fshehtë edhe në shkolla të huaja nga mësues atdhetarë. Me gjithë këto përpjekje në të gjitha trevat shqiptare, kishte mjaft shkolla turke, greke dhe bullgare. Megjithatë në fushën e mësimin të shkrim-leximit të shqipes ishte hedhur një hap përpara, përsëri shkolla shqipe nuk

22. Sami Frashëri, “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet?”. ShBLSh, Tiranë, 1980, f. 78.

23. Gjovalin Shkurtaç, “Sociolinguistika”. Tiranë, 1999, f. 59.

mund të quhej shkollë kombëtare. Idetë e rilindësve për çështjen e arsimit në fillimin e viteve '80 nuk ishin realizuar plotësisht. Librat dhe botimet në gjuhën shqipe nuk ishin të mjaftueshme, shkollat shqipe nuk lejoheshin, disa shkolla private kishin nivel të ulët pedagogjik. Në këto kushte u pa se nuk mund të realizohej asgjë në qoftë se nuk punohej në mënyrë shumë të organizuar dhe të gjithë së bashku për të krijuar shkollën kombëtare shqipe.

Korça u bë epiqendra në këtë kohë si zona më e favorshme për vënien në jetë në mënyrë të hapur planin për hapjen e shkollës shqipe. Me një kontribut të jashtëzakonshëm të mbarë shqiptarëve që nga qyteti i Korçës deri në Bukuresht e në Stamboll, me mbërritjen në Korçë të Pandeli Sotirit, më 7 mars 1887, çeli dyert e saj **“Mësonjëtorja shqipe e Korçës”**. Për të mësuar aty erdhën 35 nxënës. Ndonëse kjo mësonjëtorë nuk ishte e para e këtij lloji, ajo mori karakter kombëtar dhe laik dhe pikërisht kjo justifikoi entuziazmin e madh që shkaktoi në popull hapja e saj. Ajo ishte në fillim katër klasëshe dhe me një klasë përgatitore. Në planin mësimor të kësaj shkolle lëndët kryesore ishin: shkrim-këndimi në shqip, gramatika e gjuhës shqipe, historia, gjeografia dhe mësimi i natyrës. Në fillim u bë si gjuhë e huaj turqishtja, por më pas frëngjishtja dhe greqishtja. Numri i nxënësve të saj erdhi gjithnjë duke u

rritur. Ajo shërbeu si model edhe për hapjen e shkollave kombëtare. Hapja e një numri shkollash bëri që të rritej edhe më tepër nevoja për tekste në gjuhën shqipe si dhe të bëhej më e fuqishme lëvizja arsimore në gjuhën amtare.

Një rol të rëndësishëm në hapjen e shkollave luajti edhe shtypi shqiptar në fund të shek. XIX. Në mjaft artikuj, në gazeta dhe revista të kohës, gjuha shqipe dhe mësimi i saj u bënë çështje e ditës.

Në maj të vitit 1889, në Prizren u hap një tjetër shkollë shqipe kombëtare. Në të punoi si mësues Mati Logoreci. Një veçori tjetër e kësaj shkolle është se këtu filluan të mësojnë shkrim e këndim në gjuhë amtare edhe prindërit e nxënësve. Kjo shkollë u mbyll më 1898, por u hap përsëri. Me gjithë përndjekjet e vazhdueshme në tërë trevën e Kosovës vazhduan të hapeshin shkolla, si: në Pejë, Gjakovë, Janievë, Shkup, Ferizaj etj. Krahës Mati Logoreci, Lazër Lumezit u radhit edhe Shtjefën Gjeçovi, që u shqua edhe për veprimtari të larmishme pedagogjike.

23 tetori i vitit 1891 shënon hapjen e një shkolle për vajza në Korçë nga Gjerasim Qiriazhi dhe e motra, Sevasti. Gjuhë mësimi ishte gjuha shqipe dhe vajzat edukoheshin me frymë atdhetare. Një numër i madh shkollash u hapën në zonat e Korçës, Kolonjës, Pogradecit etj. Gjithashtu qyteti i Manastirit ishte

bërë një pikë strategjike për botimin dhe shpërndarjen e abetareve dhe librave shqip të cilat i dërgonin kolonitë shqiptare.

Mungesa e mësuesve të gjuhës shqipe dhe niveli jo i lartë solli si nevojë të kohës përgatitjen e tyre. Për këtë, me inisiativën e shoqërisë “Drita” të Bukureshtit, u arrit të hapej një shkollë pedagogjike në të cilën mësimi zhvillohej shqip dhe rumanisht. Edhe Shoqëria “Dëshirë” e Sofjes pati ndikim të madh në hapjen e mjaft shkollave shqipe në vise të ndryshme të Shqipërisë, veçanërisht për botimin e shumë teksteve shkollore dhe dërgimin e tyre në Shqipëri. Përhapja e shkollave të huaja në gjuhët greke dhe serbe, shtronte në mënyrë të ngutshme hapjen e shkollave në gjuhë amtare.

Komiteti i Kuvendit të Dibrës luftoi për hapjen e shkollave shqipe në të cilat mësimi duhej të zhvillohej në gjuhën amtare, ndërsa Haxhi Zeka do të thirrte një kuvend në të cilin do të flitej edhe për futjen e gjuhës shqipe, në mënyrë të përshkallëzuar, në të gjitha shkollat e vendit, po Lidhja e Pejës nuk arriti të realizonte programin e saj. Si rrjedhim gjuha shqipe mund të mësohej vetëm ilegalisht, nëpër shtëpi etj., kudo ku ishte e mundur. Në këto kushte ndihmesë shumë të madhe kanë dhënë edhe mësuesit shëtitës. Shkolla shqipe të tilla kanë vepruar në gjithë trevat shqiptare.

Më 1901 edhe në Borgo Erico dhe në Zarë u bënë përpjekje për të

hapur shkolla shqipe. Këtu si mësues i parë në kurset e mësimi të shqipes ishte Pashko Bardhi. Gjithashtu këtu punuan si mësues edhe Sh. Gjeçovi, Gjergj Koleci etj.

Në fillimin e shek. XX kishte disa shkolla në të cilat mësohej shqipja. Një shkollë e tillë djemsh (1907- 1908) kishte 35 nxënës dhe dy mësues, Mati Logorecin dhe Ymer Sollakun. Por shqipja po mësohej gjithnjë e më shumë në qytete edhe fshatra. Ndërkohë që Shkodra ishte bërë një vatër mjaft frytdhënëse për përhapjen e librave të mësimi të shqipes. Gazeta “Drita” e Sofjes shkruante në janarin e vitit 1908 se *“Ka disa vjet që shkrim-këndimi i gjuhës shqipe në Shkodër po përparon dhe zëun të marrin vesh shkodranët dobinë e shkrimit e të këndimit në gjuhë të vet se nga italishtja nuk ia kanë dhe nuk ia kanë fare hajrit”*.²⁴

Rol të rëndësishëm luajtën edhe shoqëritë, si: “Bashkimi” e “Agimi”; klubet, si: “Gjuha shqype” etj., që botuan libra shkollorë, abetare, tekste leximi për mosha dhe nivele të ndryshme dhe që dhanë kështu ndihmesë konkrete për mësimin e gjuhës së shkruar.

Shkolla Fretnore e Shkodrës, e themeluar më 1861, vazhdoi me katër klasë fillore deri më 1902. Me ardhjen Gjergj Fishtës si drejtor i saj, u vendos gjuha shqipe si gjuhë mësimi dhe mësimet janë dhënë *“... përberë në themel të ndjenjave shqiptare”*.²⁵

24. ISP, “Historia e arsimit shqiptar”. Tiranë, 1990, f. 111.

25. Ilo Mitkë Qafëzezi, “Dhaskal Gjoka...”,

Ai bën disa ndryshime në planin mësimor, duke shtuar numrin e klasave në gjashtë, si më poshtë:

dispozicion të nxënësve u vunë dy shkolla, një për djem e një për vajza.

Nr.	Lëndët	Kl. I	Kl. II	Kl. III	Kl. IV	Kl. V	Kl. VI
1.	Besim	2	2	2	2	2	2
2.	Lexim e shkrim	6	6	6	5	4	3
3.	Gjuhë mësimi	6	7	5	5	6	5
4.	Aritmetikë e gjeom.	5	4	4	4	4	4
5.	Histori natyre - fizikë	-	-	1	2	2	3
6.	Gjeografi e histori	-	-	1	2	2	2
7.	Vizatim	1	1	1	1	1	1
8.	Këngë e gjimnastikë	2/2	2/2	2/2	2/2	2/2	2/2
Shuma		22	22	23	24	24	24 ¹

Siç shihet nga plani mësimor që kemi arritur të gjejmë në fondin e Muzeut Historik të Shkodrës, gjuha shqipe zinte një vend tepër të madh, që shkonte deri në 50 % të të gjithë orëve të mësimi në javë.

* * *

2. 2. Mësimi i gjuhës shqipe në vitet 1908- 1912

Pas revolucionit të turqve të rinj, lëvizja arsimore për mësimin e gjuhës shqipe shënoi një ngritje të madhe, sidomos në aspektin organizativ. Pothuajse në të gjitha qytetet lindën klube e shoqëri patriotike të cilat kishin përcaktuar statutet dhe programet e tyre. Në këto të fundit një vend të veçantë zë çështja e arsimit në gjuhën shqipe.

Më 1908 një numër i madh shkollash u hapën njëra pas tjetrës: duke filluar që në gusht të atij viti, një shkollë fillore shqipe u hap në Elbasan; në Berat u hapën dy të tjera, gjithashtu edhe në Tiranë e Vlorë, edhe në Gjirokastrë e Korçë në

Mësimi i gjuhës shqipe nuk bëhej vetëm në qytete, por edhe në fshatra, falë shkollave që u hapën edhe në treva të ndryshme të vendit. Madje mësimi i gjuhës shqipe në këto vite nuk bëhej vetëm në shkolla fillore për fëmijët e kësaj moshe, por edhe në shkolla e kurse të mbrëmjes, që destinoheshin për të rriturit. Këto shkolla mbaheshin nga populli, atdhetarët shqiptarë si dhe me ndihmën e kolonive shqiptare të Bukureshtit, Sofjes, Kajros, të SHBA etj.

Shkollat shërbyen jo vetëm për qëllimin kryesor, mësimin e gjuhës shqipe të shkruar nga breznitë e reja dhe të rriturit, por ato u kthyen edhe në qendra në të cilat edukohej dashuria për Atdheun, si ideal i bashkimit të popullit, sepse aty mësonin fëmijë të besimeve fetare të ndryshme.

Hapja e vrullshme e shkollave sillte nevojën e vazhdueshme për botimin e teksteve shkollore. Sado që përpjekjet nuk mungonin, në këtë aspekt, përsëri intelektualët-didaktë

Biblioteka Shqipëtare "Qafëzezi", Korçë, 1936, f. 144.

shqiptarë nuk kishin arritur suksesin e duhur sepse u mungonte një alfabet i përbashkët. Një mungesë e tillë kishte pasoja në zhvillimin e arsimit, gjuhës, letërsisë e kulturës kombëtare. Për këtë arsye, me nismën e Klubit të Manastrit, u thirr një kongres, i njohur në historinë kombëtare me emrin Kongresi i Manastirit. Ky kongres i filloi punimet më 14 nëntor 1908. Në të morën pjesë 50 delegatë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe jashtë saj. Vendimi që u mor për çështjen e alfabetit ishte i tillë: do të pranoheshin dy alfabete, ai i Stambollit që ishte në veprim, dhe alfabeti i hartuar nga komisioni i posaçëm për këtë problem. Kongresi i Manastirit shërbeu si nxitje për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe në shumë krahina të vendit dhe luajti një rol me rëndësi për t'i prerë rrugën çdo ndikimi të huaj në këtë fushë. *“Kongresi edhe pse nuk e zgjidhi përfundimisht këtë çështje, i hapi rrugën një alfabeti të vetëm që përmblidhte cilësitë më të mira të alfabeleve të mëparshme. Roli i tij që i madh dhe populli shqiptar zgjodhi vetë si më të përshtatshëm për natyrën e gjuhës shqipe alfabetin që kemi sot, i lehtë në përdorim, i thjeshtë në të shkruar dhe praktik në botime.”*²⁶

Por Kongresi hartoi edhe një platformë prej 18 pikash, ku kërkohej njohja zyrtare e gjuhës shqipe, zgjerimi i arsimit kombëtar,

në shkollat e kohës (turke dhe greke) si gjuhë mësimi të ishte shqipja, të themelohej një universitet shqiptar, si dhe mjaft kërkesa të tjera.

Duke qenë se lëvizja arsimore po ngjiste shkallë të rëndësishme në historinë e saj, u shtrua për zgjidhje problemi i përgatitjes së mësuesve për shkollat kombëtare shqipe. Pikërisht për këtë Kongresi i Elbasanit i vitit 1909 mori vendimin për hapjen e një shkolle të mesme pedagogjike (normale) në vjeshtën e atij viti. Synimi kryesor i saj ishte përgatitja e mësuesve për shkollat fillore shqipe. Programi me të cilin punoi kjo shkollë ishte i një niveli me shkollat evropiane të kohës të këtij profili. Kjo shënoi një arritje të madhe të lëvizjes arsimore shqiptare sepse prej saj dolën brezat e parë të mësuesve që morën në dorë arsimin shqiptar në vitet e Pavarësisë Kombëtare e më pas.

* * *

Ishte koha kur për të hedhur themelet e arsimit popullor shqiptar, intelektualëve-atdhetarë-didaktë u duhet jo vetëm të hapnin shkolla, por edhe të organizonin përmbajtjen e shkollës, të hartonin kurrikulat e reja shkollore, në përputhje me synimet e afërta dhe të largëta kombëtare. Rol të dorës së parë në këtë drejtim të rëndësishëm, luajtën ata pedagogë me arsim të kryer në shkollat e Perëndimit.

26. Tomor Osmani, “Udha e shkronjave shqipe”- Histori e alfabetit. Shkodër, 1999, f. 499.

Bibliografi

- Ashta, Kolë: “Leksiku historik i gjuhës shqipe” - I, Shkodër, 1996, f. 129.
- Beltoja, Gaspër: “Programi i gjuhës shqipe për kl. I-II”, Shtypshkronja e “Arësimit”. Shkodër, 1919.
- Haxhi, Artan - Topalli, Tefë: “Histori e gjuhës së shkruar shqipe”, Shkodër, 1999, f. 115.
- Instituti i Studimeve Pedagogjike: “Historia e arsimit shqiptar”, Tiranë, 1990.
- Franja, Luigi: “*H-ja nistore në shkrime të vjetra*”, “Hylli i Dritës”, Vjeti XXIII, 1994, Nr. 1-2.
- Frashëri, Sami: “Gjuha Shqip”, në “Alfabetare e gluhëse shqip”, Ndë Konstantinupojë, 1879.
- Frashëri, Sami: “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet?”. ShBLSh . Tiranë, 1980.
- Gazeta “Liri e Shqipërisë”, 11.06.1913.
- Hoti, Vehbi: “Luigj Gurakuqi për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar” (Monografi). Biblioteka “Shkodra”, Shtëpia botuese “Camaj-Pipa”, Botim i USH “Luigj Gurakuqi”, Tiranë, dhjetor 2002, f. 339.
- Hoti, Vehbi: “*Gasper Beltoja dhe vepra e tij arsimore e pedagogjike*”, në “Buletin shkencor” i USH, Seria e shkencave didaktike, Viti XXXI i botimit, Nr. 1 (49), 1997-2001, f. 119-125
- Kabineti pedagogjik: “Historiku i arsimit në Shkodër”, Vëllimi I. Shkodër, 1980. (Dorëshkrim).
- Kashari, Qazim: “*Zhvillimi i arsimit kombëtar në fillimet e Pavarësisë*”, -“Revista pedagogjike”, Nr. 3 / 1996.
- Kastrati, Jup: “*Disa të dhëna mbi historikun e arsimit në Shkodër*”, në “Arsimi popullor”, 1964, Nr. 2.
- Kazazi, Lindita - Kazazi, Njazi “Abetaret shqipe dhe Pavarësia Kombëtare, vështirë rreth abetareve dygjuhëshe shqip-italisht”, Botim i USH “L. Gurakuqi”, FSHSH, ISA, “PAVARËSIA E SHQIPËRISË DHE ALBANOLOGJIA” Konferencë Shkencore Ndërkombëtare, Studime shqiptare - 21, Shkodër, 2015, f. 347-350.
- Kazazi, Njazi: “Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër” (nga fillimet e tij deri në vitet ’20 të shek. XX). Monografi. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Instituti i Studimeve Albanologjike. Shkodër, 2014.
- Lloshi, Xhevat: “*Vëprimtaria arsimore e K. Kristoforidhit*”, në “Revista pedagogjike”, 1976, Nr. 1.
- Muzeu Popullor Shkodër, Dosja 1/15, Dok. 742.
- Osmani, Shefik: “*Kompleksi arsimor-kulturor i Pashallekut të Shkodrës*”, në “Drita”, 3 tetor 1982.
- Osmani, Shefik: “*Dy linja paralele në botimet e didaktit Gaspër Beltoja*”, - “Revista pedagogjike”, 1997/2.
- Osmani, Shefik - Kazazi, Njazi: “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre

historiko-pedagogjike”. Botim i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe i Shtëpisë “Idromeno”. Tiranë, 2000. Faqe 366.

Osmani, Tomor: “Udha e shkronjave shqipe”- Histori e alfabetit. Fondacioni Soros. Shtëpia botuese “Idromeno”. Shkodër, 1999. Faqe 576.

Prennushi, Mikel: *“Vështrim historik mbi gjendjen dhe zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe dhe të huaj në Shkodrën e shek. XIX”*, në “Studime historike”, Nr. 3 / 1974.

Qafëzezi, Ilo Mitkë: “Dhaskal Gjoka...”. Korçë, 1936.

Revista “Dituria”, janar 1928.

Shkurtaç, Gjovalin: “Sociolinguistika”. Tiranë, 1999.

* * *

Hyrje

1. Vështrim për mësimin e gjuhës shqipe para Rilindjes Kombëtare.
2. Mësimi i gjuhës amtare gjatë Rilindjes Kombëtare në shkollat shqipe.
 2. 1. Përpjekjet për mësimin e gjuhës shqipe në vitet 1880-1908.
 2. 2. Mësimi i gjuhës shqipe në vitet 1908-1912.

Pavarësia në shkrimet letrare të ulemave shqiptarë

Prof. dr. Hysen Matoshi
Instituti Albanologjik i Prishtinës

Abstrakt

Në historinë tonë fare pak mund të mësohej për Haxhi Vehbi Dibrën, kryetarin e Plegësisë në Qeverinë e parë të Vlorës, të zgjedhur në kuvendin historik të Pavarësisë e Shqipërisë. Historiografia jonë më shumë është marrë me faktin se kush e qëndisi flamurin shqiptar se sa me kryetarin e Plegësisë së saj, zëvendësuesin e Ismail Qemalit dhe njërën ndër figurat më bashkuuese të këtij Kuvendi, vendimet e të cilit do të dëshmohej si kthesë e madhe në historinë e re të shqiptarëve. Përveçse nuk do të vlerësohej në përmasën e duhur kontributi historik i këtij imami e atdhetari të rrallë, në periudhën e komunizmit do të bëheshin përpjekje që, nëpërmjet retushimeve falsifikuese të fotografive, të zhbëheshin edhe faktet dokumentare të Kuvendit të Pavarësisë. Në margjina të historiografisë shqiptare do të mbetej, ta zëmë, edhe Hoxhë Kadri Prishtina, themelues dhe kryesues i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, pastaj Mulla Idriz Gjilani, i cili u vu në krye të forcave kombëtare për të mbrojtur kufijtë e Kosovës nga ripushtimi serb në përmbyllje të Luftës së Dytë Botërore etj. Ulematë e kalibrit të këtyre kombi i vuri në ballë të zhvillimeve më të rëndësishme, por një historiografi e mbrapshtë, shkajshëm e ideologjizuar, për dekada i nxori nga faqet e historisë sonë vetëm për faktin se, konceptualisht nuk i shkonte për shtat që, figura të shquara të proveniencës fetare islame të kishin rëndësinë, të cilën e kanë pasur historikisht.

Njëra ndër të metat kryesore të shqyrtimeve lidhur me identitetin tonë është edhe kundrimi i pjesshëm i tij. Ndonëse një kategori tejet komplekse, e

përbërë nga komponentë të shumë dhe me ndikim të shumëfishtë, identiteti i individit dhe grupit të caktuar jo rrallë është trajtuar pjesshëm e njëanshëm. Shembull tipik i deformimit të këtyre është

trajtimi që i është bërë identitetit tonë kombëtar në periudhën e komunizmit. Ideologjia sunduese e kësaj kohe e konceptonte identitetin kombëtar, si kundërshti të plotë me identitetin fetar. Logjika e këtillë përjashtuese nuk e akceptonte dot mundësinë e të qenit të një individi atdhetar dhe fetar njëkohësisht. Personalitetet që, përveç dashurisë për atdheun, kombin, vlerat e identitetit të tij, shfaqnin haptas dashurinë për Krijuesin tonë, Allahun e Madhërueshëm, anatemoreshin dhe ekskomunikoheshin në të gjitha drejtimet. Qasja e këtillë e dëmshme u shtri edhe në vlerësimin e kontributeve të figurave të shquara të historisë e të kulturës sonë, ndonëse ndihmesa e tyre dhënë ngritjes së kombit ishte vendimtare për proceset historike.

Një qasje e këtillë përjashtuese ka bërë që ngjarjet më të rëndësishme të historisë sonë, duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit XIX, e deri në zhvillimet e fundshekullit të kaluar, të cilat e ndryshuan rrjedhën historike shqiptare, të mbesin pa shumë protagonistë të tyre eminentë. Dhe nuk kishte asnjë arsye të mirëqenë për të anashkaluar personalitete kyçe të këtyre zhvillimeve historike, të cilat në rastin më të mirë minimizoheshin, ndërsa nuk janë të rralla rastet kur edhe ekskomunikoheshin krejtësisht. E gjithë kjo plotëinë e ngjarjes historike, jo një herë e ka shndërruar

në një torzo ideologjike. Absurdi i këtillë, ta zëmë, ka bërë që Lidhja Shqiptare e Prizrenit të trajtohej në historiografinë tonë, pa e pranuar gjithanshëm e në përmasa reale rolin e Myderriz Ymer Prizrenit, ndonëse ishte kryetar i komitetit kombëtar të këtij Kuvendi - kthesë në historinë unifikuese të shqiptarëve. U frynë tej mase disa figura dytësore, pa ndonjë peshë intelektuale e morale, me të vetmin qëllim që të eklipsohej sa më shumë rëndësia historike e kryetarit të kuvendit, që i ofroi rreth një projekti të përbashkët shqiptarët e katër vilajeteve. Edhe kur ndodh që të vlerësohet roli i ulemave shqiptarë, sikurse ishte, ta zëmë, vizionari Haxhi Zeka, themelues i Lidhjes së Pejës (1902), si vijuese e idealeve të përealizuara të Lidhjes së Prizrenit, nga biografia e gati pahetueshëm lihen anash të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me përkatësinë e tij fetare dhe me përkushtimin e tij të rrallë në këtë drejtim.

Në historinë tonë fare pak mund të mësohej për Haxhi Vehbi Dibrën, kryetarin e Pleqësisë në Qeverinë e parë të Vlorës, të zgjedhur në kuvendin historik të Pavarësisë e Shqipërisë. Historiografia jonë më shumë është marrë me faktin se kush e qëndisi flamurin shqiptar se sa me kryetarin e Pleqësisë së saj, zëvendësuesin e Ismail Qemalit dhe njërën ndër figurat më bashkuese të këtij Kuvendi, vendimet e të cilit do të dëshmoreshin si kthesë e madhe

në historinë e re të shqiptarëve. Përveçse nuk do të vlerësohej në përmasën e duhur kontributi historik i këtij imami e atdhetari të rrallë, në periudhën e komunizmit do të bëheshin përpjekje që, nëpërmjet retushimeve falsifikuese të fotografive, të zhbëheshin edhe faktet dokumentare të Kuvendit të Pavarësisë. Në margjina të historiografisë shqiptare do të mbetej, ta zëmë, edhe Hoxhë Kadri Prishtina, themelues dhe kryesues i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, pastaj Mulla Idriz Gjilani, i cili u vu në krye të forcave kombëtare për të mbrojtur kufijtë e Kosovës nga ripushtimi serb në përmbyllje të Luftës së Dytë Botërore etj. Ulematë e kalibrit të këtillë kombi i vuri në ballë të zhvillimeve më të rëndësishme, por një historiografi e mbrapshtë, skajshëm e ideologjizuar, për dekada i nxori nga faqet e historisë sonë vetëm për faktin se, konceptualisht nuk i shkonte për shtat që, figura të shquara të proveniencës fetare islame të kishin rëndësinë, të cilën e kanë pasur historikisht.

Vetëdija e tyre kombëtare, krahas asaj fetare, gatishmëria për të sakrifikuar në ngjarjet që përcaktonin fatin e kombit shqiptar dhe vizioni për të ndërtuar një të ardhme më të mirë, i shquajnë prijësit dhe dijetarët tanë fetarë, si personalitete pa të cilët nuk mund të shkruhet e vërteta historike e kombit shqiptar. Në fakt binomi fe-atdhe, përveçse

fryt i vetëdijes së intelektualëve për ta konceptuar tërësinë identitare, është edhe reagim i natyrshëm ndaj përmasave tmerruese të rrezikimit të qenies kombëtare e fetare të shqiptarëve.

Konteksti në të cilin u ndodhën shqiptarët, pas defaktorizimit të përgjithshëm politik e ushtarak dhe largimit të Perandorisë Osmane nga këto hapësira, është një dëshmi e padiskutueshme për perceptimin e tyre nga fqinjët, si pengesë në rrugën e ekspansionit sllavo-grek. Vitet 1912 dhe 1913 për shqiptarët e Kosovës dhe përgjithësisht të viseve etnike përbëjnë periudhën e fushatës së paparë mbi qenien e tyre etnike dhe fetare. Lufta që nisën serbët dhe malazezët, përveçse ishte drejtuar kundër hapësirës etnike shqiptare, në masë të madhe atakoi deri në çrrënjosje edhe identitetin fetar të shqiptarëve, madje pa dallim, si të myslimanëve, ashtu edhe të të krishterëve katolikë. Me fjalë të tjera, zvogëlimi i hapësirës etnike do të thoshte zhbërje fizike për shqiptarët, ndërsa atakimi i pashembullt i dimensionit fetar, nëpërmjet konvertimit të dhunshëm, do të thoshte zhbërje shpirtërore e tyre. Ndaj, është e kuptueshme pse në shkrimet diskursive e letrare të kohës e gjejmë dendur këtë binom, në krye të herës, si reagim për ta mbrojtur qenien e rrezikuar fizike dhe shpirtërore të kombit. Teksa dysia fe-atdhe, aq e

pranishme edhe në veprën letrare të At Gjergj Fishtës, është trajtuar gjithanshëm nga studiues të veprës e të jetës së tij, pikëpamja e ngjashme e bashkëkohësit të tij Hafiz Ali Korça pothuajse është lënë në harresë, megjithëse vargjet vijuese janë një qortim i rreptë për fanatizmin, i cili nuk ka të bëjë me esencën e besimit:

Nuk e di me ç'mendje venë
Kush s'ka fe a do atdhenë?
Duhet të mentohen pakë
Fe – atdhe janë binjakë.¹

E njëjta pikëpamje e Hafiz Aliut, veçse në një version tjetër, del edhe në katër vargjet vijuese, duke potencuar faktin se kush nuk do t'ia dijë për njërin nga këta komponentë identitarë nuk do ta mbrojë dot as tjetrin:

Dini e vatani dy binjakë janë
Që të dy një rrënjë dhe një
burim kanë.

Ç'derd ka për atdhenë kush ka
flakur fenë.

Për dit vagabondi e ndërron
kiblenë.²

Natyrisht kjo pikëpamje e Hafiz Ali Korçës është në përputhje me porosinë e të dërguarit të Allahut, Muhamedit (a.s.), sipas

1. Hafiz Ali Korça, Historia e shenjtë dhe të katër halifetë, Vepra 4, Logos A, 2008, f. 23.

2. Hafiz Ali Korça, Publicistikë dhe shkrime të tjera, Vepra 12, Logos A, 2008, f. 13.

të cilit dashuria për atdheun është pjesë e besimit. Për më tepër, në konceptimin e këtij binomi të pandarë, autori e trajton atdheun si mbrojtës të fesë, si kusht në kuadër të të cilit gjëllin (gjallon) feja:

Atdheu kuti është feja xhevahiri
Rron në kutit brënda e ruhet
floriri.

Për të mbrojtur nderin na duhet
kutija

Po s'pate kutinë shkon feja,
inxhija.³

Në kontekst të shqyrtimit të shkrimeve letrare të Hafiz Ali Korçës, lidhur me atdheun, pavarësinë e tij, bëjnë pjesë edhe preokupimet, që shpreh lidhur me tokat etnike shqiptare, që mbetën jashtë kufijve të Shqipërisë londineze, që nuk e gëzuan pavarësinë e shpallur në Vlorë më 28 nëntor 1912. Elegjia e tij nuk është thjesht vetëm vajtim për Kosovën, ndonëse merr shkas nga një ngjarje e dhimbshme, nga një masakër serbe e bërë në ditën e Kurban Bajramit në Drenicë më 1924; më tej, kjo elegji nuk është as vetëm vajtim për Çamërinë, ngase, në një kontekst më të gjerë, del vajtim për Shqipërinë që mbeti pa krahët e saj, pa pjesët më të bukura e më të domosdoshme për një jetë me dinjitet të kombit tonë. Krijimet letrare, që trajtojnë fatet e atdheut të copëtuar, identitetit të përçarë mbi baza të ndryshme

3. Hafiz Ali Korça, po aty.

shquhen edhe për një shprehje të fuqishme emocionale. Mund të thuhet se përmbajtja në këtë rast e ka kushtëzuar edhe ligjërimin poetik, pastaj edhe mjetet shprehëse ndër të cilat figurat e përsëritjes dhe pyetjet retorike zënë një vend qendror.

Ka një numër të madh dijetarësh e krijesish shqiptarë të besimit islam, të cilët i kushtojnë vëmendje aktit heroik të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Madje, mund të thuhet se edhe organet e shtypit islam të periudhës parakomuniste e vlerësonin lart këtë ngjarje madhore në historinë tonë. Revistat që dolën në këtë periudhë historike, sikundër janë *Zani i Naltë*, *Kultura islame* dhe *Njeriu*, në mënyra të ndryshme, e shënojnë përvjetorin e pavarësisë. Ndonëse Shqipëria ndodhej nën pushtimin fashist, më 1942 revista *Njeriu*, për nder të 30-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, i kushton kësaj ngjarjeje një numër tematik, në të cilin mbizotërojnë shkrimet letrare. Natyrisht, aty i gjejmë shumicën e autorëve, të cilët kanë shkruar tekste me pretendimin për himnin kombëtar, për flamurin kombëtar, për vetë aktin madhor të Vlorës, sikurse janë Asdreni, Gjergj Fishta, Faik Konica, Lasgush Poradeci, Kristo Floqi, Ibrahim Hasnaji, Mustafa Grebllëshi etj. Me një kontribut poetik në këtë numër tematik shfaqet edhe Baba Ali Tomori. Dedikimi i tij i titulluar *Flamurit të Shqipërisë*, ndjek një

procedim artistik interesant. Autori e shëtit flamurin kombëtar nëpër kronologjinë kombëtare, që nga gjeneza jonë historike, e deri në kohën më të re. Ndonëse, si tërësi ky krijim letrar nuk shquhet për nivele të larta artistike e të krahasueshme me autorët e shquar të letërsisë shqipe, disa pjesë të tij dalin të realizuara mjaft mirë. Po sjellim këtu vetëm disa vargje për të dëshmuar se si prushi atdhetar i Baba Ali Tomorit, herë-herë, mbështetej edhe me gjetje interesante të mjeshtërisë letrare:

Pra, në ç’jetë more frymë? Cila
ré të kishte ngritur?

Ah, në cilën hapësirë, ti Flamur
jeshe valvitur?

Cili Diell të pat parë? Cilët yje
shok ke pasur

Cila botë kish jetuar, një me ty,
Flamur i dashur?⁴

Autori i tretë që kemi zgjedhur të trajtojmë në këtë kumtesë është Haki Sharofi, përkatësisht poezia e tij “Një malsori”, në të cilën shpërfaqet dimensionin i sakrificës për të mbrojtur tokën shqiptare nga i huaji, pra pavarësinë dhe lirinë e saj. Përmasa legjendare e veprimit, që bëri një malësor i vetëm përballë ushtrisë armike, e ka preokupuar zemrën, mendjen dhe talentin krijues letrar të Haki Sharofit. Në

4. Njeriu, revistë e përmuejshme shpirtnore kulturore, nr. 5 – Kushtue Flamurit, 1942, f. 10.

këtë poezi, si rrallëkund tjetër, ndërlidhen koncepti tradicional etnik shqiptar për madhështinë e luftëtarëve dalzotës të Atdheut me konceptin islam për dëshmorët. Pa dyshim, kjo poezi ka elemente për afrimi të ndjeshëm edhe me poezinë popullore, ndonëse në të spikat edhe mjeshtëria e autorit, që buron nga bota e tij e pasur ideore e emocionale, nga zotësia për ta konceptuar këtë akt heroik me fjalë të zakonshme, por me një ligjërim që perceptohet në mënyrë krejtësisht të veçantë:

Cili je ti, o Shqiptar,
Or i dashur i Perëndisë!
Qi e vrave 'i komandar,
Në midis të 'i ushtrisë?⁵

Në këtë kontekst trajtimi nuk ka qenë e mundur që të përfshihen

5. Cituar sipas veprës Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët (simpozium ndërkombëtar), botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 1995, f. 416.

edhe autorë të tjerë të rëndësishëm, sikurse janë, bie fjala, Hafiz Ibrahim Dalliu, Ibrahim Hasnaji, Murat Labënishti, Ferit Vokopola etj., të cilët për një kohë të gjatë, si dijetarë dhe krijues letrarë, kanë kontribuar për përparimin kombëtar e fetar të shqiptarëve. Krahës materies që e trajtojnë më me përparësi, asaj fetare, nuk janë të pakta shkrimet, qofshin letrare, qofshin publicistike, në të cilat ata këshillojnë bashkëkombësit se si të veprojnë për të mirën e përgjithshme kombëtare e shoqërore. Natyrisht, si njohës të moralit islam dhe të traditës së lashtë zakonore shqiptare, dijetarët dhe autorët shqiptarë shpesh do t'i gërshetojnë elementet pozitive për të mbajtur sa më lart frymën kombëtare në kohët e zhvillimeve vendimtare.

Shumë nga kontributet e asokohshme mund të shërbejnë edhe në ditët e sotme, sepse trajtimi i tyre është i përtëjkohshëm, ndërsa vlera e tyre artistike në rrafshin tonë kombëtar mbetet e gjithmonshme.

Çfarë do të thoshte Hipokrati?

Ilir Akshija, M.D., M.Sc.,

Spitali Universitar “Nënë Tereza”, Departamenti i Statistikave, Tiranë

Erion Akshija, M.D në Farmaci

Farmacist në farmacinë Lloyds, Bolonja, Itali

Abstrakt

Vlerat janë të lidhura me aktorët. Kodet etike si mbartës të vlerave e gjejnë aplikimin e tyre në segmente të caktuara të shoqërisë dhe Betimi i Hipokratit ka të njëjtin fat. Ne e kemi rikonsideruar betimin e vjetër të lidhur me aktorët që premtojnë ta respektojnë dhe ambientin shoqëror që i rrethon. Shqipëria në këtë aspekt është sa e veçantë po aq edhe e ngjashme me vendet e tjera. Një shikim i shpejtë i mënyrës se si i menaxhojmë kodet etike është reflektim i realitetit tonë. Qëllimi i këtij diskutimi është analizimi i betimit në kushtet e realitetit tonë si pjesë e të përgjithshmes, në perspektivën e një mjeku në lidhje me pacientët, kolegët dhe garantuesit. Ndoshta nuk duam të ruajmë formën e vjetër, por duam të ruajmë shprehjen ekzotike të formës së vjetër, ta përdorim atë në koherencë me botën moderne, të respektojmë ndjeshmëritë religjioze dhe të jemi specifik për vendin tonë. Rishikimi i vlerave në një shoqëri që ndryshon shumë shpejt kërkon diskutim të vazhdueshëm, përndryshe do ta kompromentonim pozicionin tonë që nuk mund të quhej as arkaik dhe as modern, duke mbetur në një gjendje të papërcaktuar. Disa vlera janë universale dhe të tjera i përkasin vetëm një grupi. Ky diversitet duhet vlerësuar si pasuri që duhet vendosur në shërbim të të gjithëve. Kërkesa për t'u përballur me realitetin e vlerave së paku kërkon përditësimin me shfaqjen e tyre në shoqëri.

Fjalë kyçe: Betimi i Hipokratit, Betimi i mjekut, etikë, vlera.

Betimi mbetet i rëndësishëm

Në formën e tij origjinale *Betimi i Hipokratit* ka lindur si një zotim, i cili, siç tregojnë të dhënat historike, u kthye në një betim në formë të shkruar rreth dy shekuj më vonë.¹ Hipokrati do të ishte shumë i lumtur po ta dinte që konsideratat e tij etike do të kishin rëndësi kaq të madhe sidomos në mjekësinë moderne. Pas një kërkimi të thjeshtë në PubMed gjetëm 1192 artikuj që kishin lidhje me “*Betimi i Hipokratit*” dhe 212 gjetje ku fraza gjendej e plotë në titullin e artikullit. Gjithsesi betimi në shumicën e rasteve është transformuar dhe adaptuar veçanërisht pas mizorive të Luftës së Dytë Botërore. Duke trupëzuar një koleksion të admirueshëm objektivash mbetet një garantues i vlefshëm i sjelljes ndaj pacientëve.² Gjithashtu shërben edhe si një mekanizëm krahasimor ndërmjet asaj se çfarë një mjek beson dhe si sillet në të vërtetë. Por deontologjia mjekësore shpesh konsiderohet sot si e panevojshme dhe e parëndësishme.³ Për sa kohë etika

ekziston, edhe trajta e saj formale e shkruar duhet të ekzistojë gjithashtu, qoftë në formën e një betimi apo të një standardi tjetër të sistematizuar. Kufijtë e ligjit janë të qartë, ndërkohë që ato të etikës mbeten të mugët, duke lejuar gjithmonë mundësinë e mospajtimeve. Mediat në veçanti e shikojnë këtë fakt si një mundësi të aktivitetit të tyre dhe mbulojnë shumë programe me këtë topikë.⁴ Mesa duket nuk mund t’i iket këtij diskutimi dhe etika nuk është premtim, por pjesë e profesionit të mjekut. Edukimi formal i mjekut dhe parimet etike ecin përkrah dhe japin rezultate sinergjike, duke u shprehur si talent dhe dije dhe duke mbetur e kufizuar tek ata që mund ta përballojnë.⁵

Struktura e betimit

Krejt ndryshe nga objektivi i një ofruesi të shërbimeve mjekësore, i cili e vendos pacientin në qendër të aktiviteve të tij, një betim mjekësor vendos në mënyrë të padiskutueshme mjekun në qendër. Koncepti i mjekut si përcaktues i *kërkesës për shërbime mjekësore* ka lindur së bashku me profesionin e

1. Yapijakis, C. (2009). “Hippocrates of Kos, the father of clinical medicine, and Asclepiades of Bithynia, the father of molecular medicine. Review.” *In Vivo* **23**(4): 507-514.

2. York, G. K. (1998). “Is Hippocrates obsolete?” *J R Soc Med* **91**(3): 164-165.

3. Grammaticos, P. C. (2014). “Medical deontology, meetings, journals, candidacy

for higher posts and how to better enjoy life.” *Hell J NuclMed* **17**(2): 85-86.

4. Steger, F. (2011). “Yesterday’s ethics in contemporary medicine - is it still of concern?” *Prague Med Rep* **112**(3): 159-167.

5. O’Neil, E., Jr. (2006). “Awakening Hippocrates: a call for health providers to serve where most needed.” *MedGenMed* **8**(4): 44.

mjekut si pamundësi e pacientit për diagnostikimin e vetes. Pacienti shkon te mjeku me një ose disa simptoma dhe është ky i fundit që i përkthen në diagnozë, duke marrë përsipër edhe vlerësimin e ndërhyrjeve të mëtejshme. Si posedues i një force të tillë mjekut i kërkohet të jetë subjekt i ligjit, i cili gjithsesi e ka të pamundur ta kontrollojë tërësisht si profesionalizmin ashtu edhe korrektësinë e tij. Kjo specifikë e përqendrimit kaq të madh të mundësisë vendimmarrëse mbi një komponent të rëndësishëm si shëndeti dhe pamundësisë për ta vlerësuar vazhdimisht ka sjellë edhe zgjedhjen e betimeve si garantues. Çdo betim “drejtohet ndaj..., dhe garantohet nga...” duke e kthyer atë në një strukturë triangulare.

Betimi origjinal i Hipokratit mund të fragmentohet si në vazhdim;

Ambjenti profesional - Unë (mjeku), mësuesi (nxënësi e mi dhe fëmijët e mësuesit tim),

i sëmuri (grua apo burrë, skllav apo i lirë),

Zotat (Apollo, Aesculapius, Hygeia (Shëndeti), Panacea (Shërim për çdo sëmundje).

Përfshirja e të dy gjinive në strukturën e betimit është një premtim ndaj humanizmit në një kohë diskriminimi të vërtetë gjinor. Mjeku është i trajnuar profesionalisht të menaxhojë sëmundjen, por në të vërtetë nuk trajton sëmundjen; trajton babain, nënën, motrën, bijën,

djalë apo gruan e dikujt.⁶ Megjithëse ky përafrim duket ai i duhuri, ndryshon në kohë. Shembulli në vazhdim tregon se si ky perceptim ka ndryshuar nga, mos e quaj pacientin ‘guri në tëmth tek shtrati 3’, sepse duhet ta respektojmë dhe të jemi humanist, në, quajë pacientin ‘guri në tëmth tek shtrati 3’ me qëllim mospërmendjen e emrit për ruajtjen e privatësisë, e tregon më së miri pretendimin e mësipërm.⁷ Për sa i përket pacientit, hapi i parë për të krijuar besim ndaj shëruesit, janë paraqitja dhe shëndeti i vetë shëruesit.⁸ Pas kësaj, çfarë mbetet të thuash për vlerat etike të shëruesit?!

Ndarja e të njëjtave vlerave etike ndërmjet mjekut dhe pacientit është pothuaj e pamundur, por së paku nevojitet që pacientët të besojnë se mjeku i tyre është i lidhur pas disa parimeve etike. Nganjëherë, edhe përmendja e gjinisë së mjekut apo pacientit nuk specifikohet me qëllim shmangjen e qëndrimeve që shkaktohen nga mosngjashmëritë.⁹ Struktura e marrëdhënieve me kolegët dhe pacientët ka ndryshuar

6. Pinsky, W. W. (2012). “Bioethics in practice-a quarterly column about medical ethics: do you remember the hippocratic oath?” *OchsnerJ* 12(4): 298-299.

7. Aswani, V. (2008). “Doctors, writing, and HIPAA.” *FamMed* 40(9): 623-625.

8. Reiser, S. J. (2003). “What modern physicians can learn from Hippocrates.” *Cancer* 98(8): 1555-1558.

9. Perez, S. G., et al. (2006). “Doctor-patient sexual relationships in medical oaths.” *J Med Ethics* 32(12): 702-705.

dhe është e kuptueshme. Tashmë nuk diskutohet më për diferenca ndërmjet të lirëve dhe robërve apo burrave dhe grave, megjithëse ruaj të drejtën për të pasur dyshime. Pikërisht kjo është përpunuar në strukturën e betimeve moderne. Gjithashtu diferencat gjinore ndërmjet kolegëve janë të tejkaluara. Deklarata e Gjenevës (e rishikuar 1993) shprehet: 'kolegët e mi do të jenë vëllezërit e mi', ndërsa Deklarata e Gjenevës (e rishikuar 2006) shprehet: 'kolegët e mi do të jenë motrat dhe vëllezërit e mi'. Këto ndryshime, me ndonjë diferencë të parëndësishme, tashmë mund të konsiderohen universale dhe nuk ka presion për t'i rikonsideruar.

E vetmja pjesë ku mund të gjejmë mjaft diversitet është *garantuesi* i betimit. Doktor i betohet *in bona fide* një pale të tretë dhe i premton që do të jetë konsequent me standardet etike të paracaktuara. Në këtë marrëdhënie tredimensionale garantuesi mund të jetë i përcaktuar në mënyrë eksplicite apo implicate, por gjithmonë e gjejmë garantuesin. Duhet të mos harrojmë që shumica e mjekëve e kujtojnë momentin e betimit si një moment historik të zhvillimit të tyre profesional.¹⁰ Në këtë perspektivë *garantuesi* duhet të vlerësohet.

10. Landry, M. and C. Miller (2010). "Presenteeism: are we hurting the patients we are trying to help?" *J Gen Intern Med* 25(11): 1142-1143.

Garantuesi

Nëse është i rëndësishëm nuk mund të lihet pa u konsideruar. Komponenti i tretë i betimit është *garantuesi*, ose entiteti që e mbron pacientin në aspektin etik dhe nëpërmjet të cilit mjeku monitoron veten. Një studimi i vitit 1989 në shkollat mjekësore të Shteteve të Bashkuara tregon se 98 % e tyre shërbeheshin me një betim mjekësor: pjesa më e madhe kishin adaptuar Betimin e Hipokratit të modifikuar (67 nga 119 të intervistuarit) dhe fakti që u konsiderua interesant ishte se katër prej tyre përdornin lutjen e Maimonides.¹¹ Mesa duket betimi është i përdorshëm gjithandej dhe e angazhon mjekun me detyrimin e respektimit të vlerave etike të caktuara.¹² Garantuesi i këtyre betimeve, sipas historisë dhe vendeve dhe po ashtu preferencave individuale merr paraqitje të ndryshme. Në parim zgjidhen si kuadër vlerash etike ato më të lartat dhe më të pastrat, të cilat derivojnë nga Zoti, nga një grup hyjnish apo ndonjë pozitë filozofike dhe etike siç është rasti i humanizmit. Se sa i rëndësishëm është *garantuesi* për secilin nga individët që bëjnë një betim është e pamundur të vlerësohet. Gjithashtu, këto entitete

11. Crawshaw, R. (1994). "The Hippocratic oath. Is alive and well in North America." *Bmj* 309(6959): 952.

12. Fabre, J. (1997). "Hip, hip, Hippocrates: extracts from the Hippocratic doctor." *Bmj* 315(7123): 1669-1670.

janë të pakrahasueshme me njëri-tjetrin, dhe çdo individ beson tek ai i përzgjedhuri nga ana e tij

Duke u përdorur nga 24 % në vitin 1928 në afërsisht 100 % të fakulteteve mjekësore në ditët e sotme, gjithmonë duke iu referuar Shteteve të Bashkuara, betimi në vete nuk tregon rritje apo ulje të atashimit me vlerat etike.¹³ Hipoteza më e keqe do të ishte që rritja e përdorimit të betimeve të ishte rezultat i rënies së standardeve etike dhe betimi formal është kthyer në domosdoshmëri. Historia njerëzore i njeh shumë mirë shfaqjet e sistemeve morale të reja apo të ripërtëritura në kohë kur korrupsioni mbizotëron, me kërkesën për rivendosjen e drejtësisë në emër të sistemeve të ndryshme vlerash. Ka mjaft mundësi që kjo nuk është e vërtetë në rastin tonë, por tendencat e këtyre fenomeneve nuk mund të mohohen. Megjithatë, bazat idealiste të mjekësisë mbeten të panegociushme. Pa altruizëm dhe dashuri mjekësia do të kthehej në një biznes të shëmtuar.¹⁴

Garantuesi është pjesë e besimeve personale. Kompania e vjetër e Zotave Grekë është

jodomethënëse për monoteistët, dhe humanistët i qëndrojnë besimeve të tyre. Varësisht nga koha dhe ambienti kultural vlerat Hipokratike janë të pandashme fetarisht dhe filozofikisht.¹⁵ Një studim tregon se mjekët që shprehen se besimi i tyre fetar është ‘gjëja më e rëndësishme’ apo ‘shumë me rëndësi’ në jetët e tyre janë më të shumtë se ata që ‘nuk kanë fe’.¹⁶ Kjo është evidencë e diversitetit dhe mund ta shohim si një pazëll në popullatën e mjekëve, që kur shikohet si e plotësuar tregon tërësinë e zgjedhjeve etike, ndonjëherë edhe të mbivendosura te njëra-tjetra. Se si besojnë apo se sa besojnë është e pamundur të matet.

Por ta vendosim veten në pozitë të një pacienti, i cili kërkon ndihmë nga mjeku dhe i cili kërkon ndihmë duke shpresuar te vlerat njerëzore të mjekut. Ai/a shpreson që mjeku të jetë i mëshirshëm dhe i zoti, dhe që ka gjithmonë parasysh kur vepron *garantuesin* e marrëdhënies ndërmjet tyre.

Shembuj të diferencave në betimet e mjekëve reflektohen edhe në përfitimet mjekësore që merr pacienti. Hipokrati fillimisht, duke prezantuar konceptin e “*physis*”, e ndryshoi mjekësinë në një disiplinë racionale.¹⁷ Ndërsa te besimet

13. Orr, R. D., et al. (1997). “Use of the Hippocratic Oath: a review of twentieth century practice and a content analysis of oaths administered in medical schools in the U.S. and Canada in 1993.” *J Clin Ethics* 8(4): 377-388.

14. Fabre, J. (1998). “Modern medicine and the Hippocratic doctors of ancient Greece.” *J R SocMed* 91(3): 161-163.

15. Kumar, A. (2010). “Hippocratic oath, 21st century.” *Indian J Surg* 72(2): 171-175.

16. Hart, G. (1965). “Asclepius, God of medicine.” *J Canad. Med. Ass. J.* 92(1): 232-236.

17. Kleisariis, C. F., et al. (2014). “Health

monoteiste kërkohet trajtimi i personit të pafat që ka nevojë për shërim si në trupin, po ashtu edhe në shpirtin e tij. Kur betimi bëhet “në emër të Krijuesit të qiejve dhe tokës...” shërbimi konsiderohet se merr mbështetjen e kësaj force madhore.¹⁸ Ky diversitet nuk kufizohet vetëm në sferën filozofike, por edhe në terma praktikë. Sot, kujdesi shëndetësor nuk është një biznes që i takon vetëm mjekut, po të marrim në konsideratë për një moment dy komponentë të kujdesit shëndetësor, financimin dhe shëndetin publik. Mjekët dhe pacientët është e sigurtë që kanë ndjeshmëri të ndryshme ndaj një betimi nga një palë e tretë paguese apo strukturat e shëndetit publik. E para ka për qëllim kosto-efektivitetin e shërbimit shëndetësor dhe e dyta ka për qëllim të mos ia ndajë sytë të mirës së përgjithshme të popullatës, të dyja duke interferuar herë pas here me përafrimin individualist të betimit të mjekut. Në situata të tilla mund të shfaqet konflikti.

Konflikt

Një listë e tërë interesash politike, financiare dhe teknologjike mund të jenë në konflikt me Betimin

e Hipokratit apo betime të tjerë të ngjashëm. Siç e kemi parë tashmë edhe ndërmjet vetë betimeve të ndryshme ekzistojnë diferenca domethënëse, dhe edhe më tepër pritet nga lista e ndërhyrjeve të sipërpërmendura.

Veçanërisht diktaturat janë një shembull i autoritetit politik të shtrembëruar, që e paraqesin veten si zgjedhje demokratike dhe imponojnë ‘vlera etike’ duke maskuar realitetin. Vlerat e vërteta etike kanë diferenca ndërmjet tyre, por në thelb janë universale dhe kanë si qëllim t’i shërbejnë njerëzimit. Shërbimi ndaj njerëzimit është kërkesa kryesore ndaj një kodi etik. Vendosija në shërbim të parimeve të tjera mund të pranohet vetëm nëse parimet thelbësore mbahen parasysh dhe respektohen. Shkelja më ekstreme e këtij rregulli është pretendimi nazist që objektivi i vetëm i punës së mjekut është shërbimi ndaj shtetit.¹⁹ Me këto lloj kërkesash madje bëhet e pamundur referimi i çfarëdo kodi etike. Në të njëjtën situatë gjendet edhe mjeku i Bashkimit Sovjetik që betohet për besnikëri ndaj moralit komunist dhe shtetit sovjetik.²⁰ Këto sisteme politike janë tejkalur dhe mësimet janë nxjerrë prej tyre. Roli i

care practices in ancient Greece: The Hippocratic ideal.” *J Med Ethics Hist Med* 7: 6.

18. Ahmad, Wahaj D., Ahmed El-Kadi, and Bashir Ahmed Zikria. “Oath of a Muslim Physician.” *Journal of the Islamic Medical Association of North America* 20.1 (1988).

19. Addis, G. J. (1997). “The BMJ’s Nuremberg issue. Force of moral duty was greater for conscientious objectors.” *Bmj* 314(7087): 1128.

20. Veatch, Robert M., ed. *Cross-cultural perspectives in medical ethics*. Jones & Bartlett Learning, 2000.

rëndësishëm i betimit mbetet akoma. Megjithatë, çështje moderne i kanë zëvendësuar ato të mëparshmet. Si shembull mund të merret rasti kur të dhënat e pacientit përdoren për zbulimin e dobësive gjatë seancave të pyetjeve në situata lufte ose të ngjashme, duke u kthyer në burim zemërimi për mjekët.²¹

Shoqëria ndikohet edhe prej faktorëve financiarë. Financimi i kujdesit shëndetësor dhe ristrukturimi i shërbimeve mjekësore, siç është rasti i kalimit të kujdesit shëndetësor nga një ofrues i vetëm në konceptin e shumë lojtarëve njëkohësisht, apo mungesave të cilat sjellin pyetje të tilla si: “Si ka mundësi që rikthimi i shëndetit të një individi e bën shoqërinë më të varfër?”, janë diskutime të përditshme në ambientet mjekësore.^{22, 23}

Evolucioni i teknologjisë kërkon monitorim të vazhdueshëm. Do të ishte e patolerueshme që të lihej të zhvillohej në mënyrë të pakontrollueshme. Vetëm recetat elektronike (e-prescribing), një pjesë fare e vogël e sistemeve të informacionit shëndetësor sjellin

edhe detyrimet në menaxhimin e çështjeve etike, shoqëruar me risqet përkatëse.²⁴

Këto janë fusha të reja zhvillimi dhe sjellin me vete edhe përgjegjësi. Nëse mjekët dhe menaxherët e kujdesit shëndetësor zgjedhin të jenë indiferentë, herët a vonë pacientët dhe familjarët e tyre do të kuptojnë. “Nuk do të dorëzohem...” është parulla e një pacienteje që kërkon trajtimin që i takon në terren të mungesave të mjekimeve.²⁵

Mesa duket ne jetojmë në një ambient të komplikuar të tregut të shëndetit. Mjekët janë të detyruar të vlerësojnë vazhdimisht punën e tyre nën presionin e kufizimeve financiare, dhe jo vetëm. Vendimmarrja klinike gjendet nën presionin e shumë forcave dhe në këtë kontekst betimet nuk janë vetëm një model reference për sjelljen e mjekëve, janë gjithashtu një strehimore për mjekun nën presion. Është një mik.

Shqipëria si një shembull

Shembulli më i mundshëm për t’u analizuar në perspektivën e analizës së deritanishme nga ana jonë është Shqipëria. E vendosur simbolikisht në mes të veriut dhe jugut, të majtës dhe të djathtës,

21. Koch, T. (2006). “Weaponising medicine: “Tutitfratelli,” no more.” *J Med Ethics* **32**(5): 249-252.

22. Rothstein, M. A. (2010). “The Hippocratic bargain and health information technology.” *J Law Med Ethics* **38**(1): 7-13.

23. Retsas, S. (2004). “Treatment at random: the ultimate science or the betrayal of Hippocrates?” *J Clin Oncol* **22**(24): 5005-5008; discussion 5009-5011.

24. Gomella, L. G. (2012). “Health care reform: the carrot, the stick and the Hippocratic Oath.” *Can J Urol* **19**(4): 6324.

25. Andrijevic-Matovac, V. (2010). “Have you forgotten Hippocrates too?” *Croat Med J* **51**(3): 274-277.

varfërisë dhe pasurisë dhe shumë ndërmjetësive të tjera, Shqipëria mund të konsiderohet homogjene vetëm për sa i përket kombësisë së popullatës. Mjaft sisteme besimi ekzistojnë dhe përbërja fetare mund të jetë një reflektim.

Tabela 1. Popullsia banuese sipas përkatësisë fetare

Përkatësia fetare	Popullsia banuese	Përqindja e popullsisë banuese
Total	2800138	100.0
Myslimanë	1587608	56.7
Bektashinj	58628	2.1
Katolikë	280921	10.0
Ortodoks	188992	6.7
Ungjillorë	3797	0.1
Të tjerë të krishterë	1919	0.1
Besimtarë të pacilësuar*	153630	5.5
Ateist	69995	2.5
Tjetër	602	0.0
Referojnë të mos përgjigjen	386024	13.8
E pavlefshme /e papërcaktuar	68022	2.4

* *Persona që janë përgjigjur “Nuk i përket asnjë religjioni, por jam besimtar”*²⁶

Diversiteti në besime duhet konsideruar si liri besimi, por e kufizuar në aspektin praktik nga ligji. Por shteti nuk ka autoritetin absolut të ndalojë lirinë e ndërgjegjes dhe të detyrojë qytetarët të bëjnë çfarë ata

26. <http://www.instat.gov.al/en/census/census-2011/census-data.aspx>

mendojnë se është e gabuar.²⁷ Duke rikujtuar diskutimin për *garantuesin* në një betim të mjekut dhe duke shikuar në tabelën 1, do të duhej që për mjekët shqiptarë të kishte më shumë se një betim ose së paku një betim që pjesërisht mund të adaptohej.

Kërkimi dhe njohja praktike e situatës lokalisht bën që të gjejmë dy betime mjekësore në Shqipëri.

E para është ‘deklarata e mjekut’ e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, botimi i vitit 2011, që i referohet Deklaratës së Gjenevës (modifikuar 1993).²⁸ Më së paku

27. Murphy, S. and S. J. Genuis (2013). “Freedom of conscience in health care: distinctions and limits.” *J BioethInq* 10(3): 347-354.

28. Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore; Miratuar nga Këshilli Kombëtar me vendimin Nr. 9 datë: 11/11/2011

për këtë betim mund të thuhet se është i tejkaluar në kohë. Madje kur pranohet në Urdhërin e Mjekut ai/ajo premton se do t'i bindet menjëherë dhe vullnetarisht Kodit. Gjetja tjetër është në faqen e internetit të Fakultetit të Mjekësisë, një institucion që ofron edukim mjekësor për gjithë territorin e Shqipërisë. Këtu, origjinali i Betimit të Hipokratit është përkthyer në shqip duke i ofruar brezit të ri të mjekëve mundësinë e betimit ndaj Apolonit & co..²⁹

Së fundmi

Ai e ka emrin S., është neurokirurg nga Lindja e Mesme. Prej pesë vitesh ka përfunduar studimet dhe punon në një vend të Evropës Perëndimore, kolegët e vlerësojnë dhe pacientët e duan. Por vendimi i znj. E., një grua 85 vjeç e ardhur nga bota e biznesit, për t'i dhënë fund jetës me eutanazi tashmë e kishte tronditur qetësinë e tij. Gruaja pas disa remisioneve të kënaqshme tashmë konsiderohej paciente terminale. Pas shumë orësh bisede

me gruan e vjetër, mjaft kurajoze dhe koshiente për diagnozën, ai kishte arritur në përfundimin që ajo nuk vuante nga ndonjë formë depresioni konkomitant. Eutanazia ishte zgjedhja e saj. Ai kishte pasur një marrëdhënie të ngrohtë me znj. E., e cila shpesh e pyeste për vendin e tij dhe i vinte keq që nuk mund ta vizitonte.

Pacientja i ishte transferuar një mjeku tjetër dhe ai po pëpiqej të rigjente qetësinë. Eutanazia nuk kishte vend në kulturën e tij dhe tek betimi i mjekut që ai kishte bërë para shumë kohësh nuk gjente zgjidhje.

Tregimi i mësipërm nuk është i vërtetë, por fare i mundshëm dhe situata të tilla janë të zakonshme në ambiente mjekësore.

Kodi i etikës në të cilin ai/ajo beson, i formalizuar si betim i shërben mjekut/mjekes si një strehë ku ajo “çfarë beson” përballlet me atë se “çfarë duhet”. Kjo mund të jetë në kundërshti me standardizimin ekstrem të kohës sonë. Rasti më ekstrem është kur mjeku vendoset nën presion gjatë kohës së luftës ku në të njëjtën kohë ai është një profesionist i shëndetësisë dhe një viktimë civile. Kjo nuk është e pazakontë dhe rrëmbimi, tortura dhe persekutimi i mjekëve janë të dokumentuara.³⁰ Madje jo vetëm në kohë lufte, por edhe në kohë të qeta

<http://www.urdhrimjekeve.org.al/images/dokumenta/Kodi%20i%20Etikes%20dhe%20Deontologjise%20Mjekesore%202011.pdf>; <http://www.urdhrimjekeve.org.al/images/dokumenta/Betimi%20i%20Mjekut.pdf>

29. Hippocratic Oath; Faculty of Medicine; <http://www.fakultetimjekesise.edu.al/component/content/article/15-rreth-fakultetit/rreth-fakultetit/26-betimi-i-hipokratit>

30. Selvakone, M. (2009). “Doctors in detention and the Hippocratic Oath.” *Cmaj* 181(10): E243.

në aparencë mjeku mund të ndjehet jo mirë kur standardet etike personale nuk arrihen. Studimet tregojnë për shfaqjen e fenomenit të mbilodhjes kur standardet etike personale nuk pranohen nga organizata ku punojnë.³¹ Duke e shtrirë diskutimin te pacienti, i cili është edhe subjekti i vërtetë i ndërhyrjes mjekësore, ne e dimë shumë mirë që ai preferon disa mjekë nga disa të tjerë. Deri diku pacienti e ka të pamundur të vlerësojë aftësitë profesionale, por sjellja e stafit mjekësor është vazhdimisht në syrin e tij. Përforcimi i këtij aspekti të marrëdhënies mjek-pacient mund të shërbejë në rritjen e kredibilitetit të mjekut dhe përmirësimin e përfundimeve shëndetësore të pacientit.³²

Fillimisht mendojmë që vendimi i parë që duhet ndërmarrë është rivlerësimi i nevojës për një betim dhe vlerës praktike të tij. Ndërmjet

mjekëve ka një variacion shumë të madh të perceptimit të vlerave dhe kjo mund të konsiderohet edhe si pasuri diversiteti. Madje në një rast kemi gjetur betimin e mjekut pensionist.³³ Betimi do të kishte vlerë nëse do të konsideronte vlerat në të cilat beson përбетuesi dhe të pacientit gjithashtu. Disa vlera etike kërkojnë të njihen në kontekstin kultural, lingistik dhe religjioz të tyre.³⁴

Së fundmi, ne mbështesim idenë e më shumë se një betimi të mundshëm për mjekët tanë.

33. Crawshaw, R. (2001). "A physician's oath on retirement: the oath marks an important juncture in a physician's life." *West J Med* 174(1): 7-8.

34. Revill, J. and M. R. Dando (2006). "A Hippocratic Oath for life scientists. A Hippocratic-style oath in the life sciences could help to educate researchers about the dangers of dual-use research." *EMBO Rep* 7 Spec No: S55-60.

31. Gabel, S. (2011). "Ethics and values in clinical practice: whom do they help?" *Mayo ClinProc* 86(5): 421-424.

32. Platt, M. P. (1994). "The Hippocratic oath updated. Could boost credibility of doctors." *Bmj* 309(6959): 953.

Toleranca dhe bashkëjetesa fetare në Shqipëri gjatë viteve 1912-45

(bazuar në praktikën dhe ligjëratat e klerit)

Ahmed Kalaja

Doktorant/Universiteti Europian i Tiranës

Departamenti i Sociologjisë

Abstrakti

Bashkëjetesa fetare është një nga vlerat e veçanta të traditës së popullit shqiptar. Është e njohur botërisht që shqiptarët shquhen për këto vlera, për një bashkëjetesë shembullore mes besimtarëve të besimeve të ndryshëm që janë në Shqipëri, kryesisht Myslimanë dhe të krishterë.

Në këtë studim do mundohemi të trajtojmë thelbin-bazën e këtij fenomeni, rrënjët promovuese të këtyre vlerave, duke e parë nga një këndvështrim të patrajtuar më parë, dhe, duke tentuar t'i japim përgjigje pyetjeve: Nga buron bashkëjetesa fetare në Shqipëri? Cilët janë promovuesit kryesorë të këtij fenomeni? Cili ka qenë dhe është qëndrimi i klerit fetar në Shqipëri. A kanë qenë dhe a janë boxhallarët e priftërinjtë promovues të tolerancës dhe bashkëjetesës fetare në Shqipëri?

Këto janë disa nga pyetjet që marrin përgjigje në këtë studim modest, duke u fokusuar në Ligjëratat e Klerit, se sa bukur dhe me sa delikatesë e kanë trajtuar këtë çështje përpara besimtarëve apo përpara botës.

Në momentet më delikate të historisë sonë kombëtare, krerët e myslimanëve, duke qenë se kanë gëzuar reputacion të padiskutueshëm dhe me shumë ndikim në pjesën më të madhe të popullsisë, jo vetëm që kanë promovuar tolerancën e bashkëjetesës fetare, por i kanë konsideruar besimtarët e besimeve tjera si 'vllazër', duke predikuar këtë bindje të tyre para besimtarëve myslimanë. Këto predikime kanë filluar me Haxhi Vebbi Dibrën, i cili ka qenë i pari Kryetar i Myslimanëve dhe mbarë boxhallarët pa përjashtim deri në ditët tona.

Të paharruara po ashtu janë predikimet e priftërinjëve: At Gjergj Fishta, At Shtjefën Gjeçovi apo Mitropoliti Visarion Xhuvani, për ta mbyllur me perlat e priftit ortodoks Fan S. Noli, i cili mahnit botën me tre fjalimet e tij para liderëve botërorë, para Lidhjes së Kombeve, duke qenë përfaqësues i mbarë shqiptarëve edhe pse besimtarët ortodoksë ishin vetëm 20 % e popullsisë së vendit.

HYRJA

Toleranca dhe bashkëjetesa fetare prej shekujsh mbretëron ndër shqiptarët si një vlerë e traditës së vendit tonë, e cila e ka habitur e po i habit vazhdimisht të huajt, pasi e shohin një rast unikal këtë marrëdhënie bashkëjetese ndërfetare. Kjo traditë nuk është e sotme, ajo nuk është as traditë e 100 vitet të fundit, por një traditë disa shekullore, që mbas vendosjes përfundimisht të sundimit osman në trojet shqiptare fillimi shek. XVI (1500).¹ Për këtë traditë dhe vlerë që posedojnë, e cila është një nga aspektet e veçanta të historisë së vendit, mbarë shqiptarët ndjehen krenarë.

Ky fakt është vërtetuar dhe nga udhëtarë të huaj të cilët kanë vizituar vendin tonë qoftë në momentet më decizive, në momentet që lufta ishte normalitet. Një rast të tillë na e shpreh zonja britanike dhe admiruesja e shqiptarëve miss. Edith Durham (në fillim të shek. XX), e cila thotë se, “Luftërat e dëgjua ndërmjet shqiptarëve janë gjithmonë për grindje ndërmjet bejlerëve kundërshtarë. Të krishterët

në këtë rast luftojnë kundër të krishterëve dhe muslimanët kundër muslimanëve - madje ajo thekson se - Shqiptarët muslimanë e të krishterë, para armikut të përbashkët bashkohen.² Ky fakt u vu në dukje që nga lëvizjet e shqiptarëve për autonomi, ku shumica e nismëtarëve ishin intelektualë fetarë dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre ishin klerikë të besimeve të ndryshme që udhëhoqën shqiptarët drejt autonomisë. Madje në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor të vitit 1912, në Vlorë, firmëtarët kryesorë dhe me peshë ishin klerikë të të gjithë besimeve. Por bashkëjetesa mes pjesëtarëve të besimeve të ndryshme arriti kulmin në Kuvendin e Vlorës, kur u vendos që Qeveria Përkohshme të ketë në kabinetin e saj, pjesëtarë të katër besimeve fetare, pavarësisht përqindjes së besimtarëve që kishte një komunitet fetar. Akoma më e shumtë do të dukej bashkëjetesa fetare mes shqiptarëve në janar të vitit 1920, në Kongresin e Lushnjës. Rolin e drejtuesve të shtetit e kishte një Këshill i Lartë i Regjencës i përbërë nga katër persona përfaqësues të secilit besim.

Në këtë material do të trajtohen praktika konkrete me vepra të klerikëve më me zë në vend, e kryefetarëve, ligjëratarat e tyre drejtuar besimtarëve, apo dhe fjalimet në raste të ceremonive të veçanta.

2. Edith Durham, *Brenga e Ballkanit*, Tiranë, 1991.

1. Kjo për faktin se gjatë mesjetës luftërat fetare me karakter sundues të ‘mbretërve fetarë’ kanë qenë pjesë e pandarë e mbarë historisë së njerëzimit, duke mos përjashtuar këtu dhe vendin tonë deri në vendosjen e sundimit osman dhe kalimit të shumicës së popullsisë në fenë islame.

Feja, kombësia dhe nacionalizmi

Besimi fetar lind bashkë me njeriun, për këtë tashmë nuk ka dyshim. Prandaj dhe që nga lashtësia njerëzit ishin të grupuar mes tyre në fise, të cilët përgjithësisht kishin një përkatësi fetare, kishin një besim. Gjatë antikitetit, dhe veçanërisht gjatë mesjetës, feja u bë lider i padiskutueshëm i njerëzve jo vetëm nga ana shpirtërore, por dhe materiale, politike, ekonomike e sociale. Një fakt i tillë do të kundërshtohet fuqishëm në mbarimin e mesjetës dhe në fillimet e kohës moderne. Humanistët dhe rilindësit e traditave greko-romake, do të vinin në diskutim 'autoritetin' e padiskutueshëm të Kishës (në përfundim). Rilindësit fjalët e 'shenjtës të Biblës' do t'i kalonin domosdoshmërisht nga arsyeja, për t'i vënë në diskutim, për t'i arsyetuar para se t'i zbatojnë. Për ta nuk ishte e vërtetë 'çfarë ishte zbritur nga Zoti', por 'çka arsyeja-logjika njerëzore arrinte ta kuptonte', në të kundërtën s'kishte vlerë. Ata nisën të shenjtëronin jetën, lirinë e fjalës, lirinë e pronës. Vërtetë këta ishin të 'shenjtës' edhe më parë, por shenjtëria e tyre ishte përcaktuar nga Zoti dhe jo nga arsyeja. Kjo 'luftë' u zhvillua në Europë, pasi në botën islame, gjatë të njëjtës periudhë nuk mund të ekzistonte një fenomen i tillë, ngaqë në Islam, domosdoshmërisht lideri politik është njëkohësisht dhe përgjegjës për fenë, dhe në fenë

islame nuk mund të konceptohet që feja të jetë e ndarë nga pjesa tjetër e jetës, pra nga sfera sociale, ekonomike apo dhe politike.

Për t'i bashkuar njerëzit rreth një ideali që të zëvendësonte pozitën e fesë, ata gjetën një pikë tjetër të përbashkët, kombësinë apo nacionalitetin. Me termin 'komb' apo 'kombësi' do të kuptojmë një bashkësi të qëndrueshme njerëzish që është formuar historikisht gjatë shthurjes së marrëdhënieve fisnore në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit e të kulturës, e cila ka ardhur duke u zhvilluar dhe duke u forcuar.³ Ky fenomen, që në Europë njihet me emërtimin 'nacionalizëm=kombësi', i ka fillimet në Francë gjatë fundit të shekullit XVII dhe që u përhap në mbarë Europën gjatë shekujve në vazhdim. Identifikimi i popujve me 'nacionalitetin-kombësinë' e tyre, u bë një fenomen i theksuar gjatë shekujve XIX-XX, por nacionalizmi nga kombësia ka një ndryshim të vogël, por shumë thelbësor. Nëse 'kombësinë' e shpjegojmë pak më lart se çfarë është dhe si ta kuptojmë, me 'nacionalizëm' do të kuptojmë: Ideologjinë apo pikëpamjen sipas së cilës një komb quhet më epror ndaj kombeve të tjerë.⁴ Këto dy terma

3. Grup autorësh; *Fjalor i shqipes së sotme*, botimi i parë nga AKADEMIA E SHKENCAVE, Tiranë, 1984; TOENA, Tiranë, 2002, f. 594

4. Grup autorësh; *Fjalor i shqipes së sotme*, botimi i parë nga AKADEMIA E SHKENCAVE, Tiranë, 1984; TOENA,

pothuajse të njëjtë bashkohen në disa pika të përbashkëta, por kanë ndarje thelbësore në qëllimin e përdorimit të secilit.

Veç 'bashkimit' në disa pika të përbashkëta pozitive që solli lindja e këtij termi-fenomeni të ri, nacionalizmi solli një të keqe më të madhe, ndarjen me 'fqinjët', ndarjen me 'të tjerët', të cilët nuk kishin të njëjtën origjinë, gjuhë, kulturë, traditë apo zakone të përbashkëta me 'ne', pra me 'bashkënationalistët'. Kështu që ky fenomen nga një nismë fillestare pozitive, me kalimin e kohës u bë nismë e problemeve të shekujve të mëvonshëm në mbarë Europën.

Kohë më parë në mbarë botën nuk shikohej 'nacionaliteti-kombi' si pikë bashkimi mes një grupi të caktuar njerëzish, por shikoheshin aspekte të tjera të jetës si: sistemi qeverisës, interesa të ndryshme, të cilat lidheshin përgjithësisht me fenë apo besimin që kishte secili popull. Ndërsa pas periudhës së Humanizmit dhe Rilindjes, ky term u bë pikë e përbashkët për popujt në mbarë Europën, ku shpesh përdorej për mirë gjithashtu dhe për keq.

Nacionalizmi, me konotacionin negativ të fjalës, më së shumti se gjithkund u ndje në Ballkan. Pikërisht me 'nacionalizmin', por tashmë duke i shtuar dhe 'fenë' nga pas, si faktor përforcues, u arrit që të motivoheshin shumë popuj për t'u ngritur dhe

Tiranë, 2002, f. 824

për të mos u pajtuar me sistemin e Perandorive të Mëdha, veçanërisht me Perandorinë Osmane. Duke bashkuar këta dy elementë, popujt nisën ndarjen mes 'të gjithëve' që ishin nën ombrellën e Perandorisë, dhe njëkohësisht motivoheshin që të bashkoheshin rreth 'nacionalizmit dhe fesë' që kishin, të ndryshëm nga 'nacionaliteti dhe feja' e Perandorisë. Në veçanti ky fenomen u nxit në Ballkan, për mospajtimin me sundimin osman, duke sjellë për disa popuj përfitime të mëdha deri në pavarësinë e tyre si: grekët, sllavët, bullgarët, rumunët etj., dhe për disa popuj tjerë, të cilët nuk kishin këta dy komponentë të përbashkët, solli probleme të mëdha deri në 'rrezikun e shuarjes' së tyre. Konkretisht kjo ndodhi me shqiptarët, të cilët bashkoheshin me 'nacionalitetin', por nuk mund të bashkoheshin me një fe, me një besim të përbashkët, pasi ishin multi-fetarë dhe nuk mund ta ndryshonin këtë realitet.

Në këtë mënyrë, nacionalizmi solli një destabilitet shumëdimensional në mbarë Ballkanin, si pasojë e së cilës kishin fillesat dy luftëra të mëdha botërore. Për pasojë kjo gjë e bëri Ballkanin një shesh betejash dhe luftërash kundrejt vetë vetes së tyre, me pikënisje 'nacionalitetin' të ndërthurur me besimin. Që nga viti 1830, kur nga Perandoria Osmane u shkëputën shteti grek e më pas ai serb, duke fituar Pavarësinë, deri në vitin 1912, kur u shpall i pavarur dhe

shteti i fundit në Ballkan, pra shteti shqiptar. Më pas po në Ballkan nisi Lufta e Parë Botërore, po ashtu dhe Lufta e Dytë. Kështuqë Ballkani nga vitit i largët 1821 deri në vitin 1999, vetëm se ka zier nga luftëra të shumta politike, ekonomike, sociale, të cilat motivoheshin nga udhëheqësit nacionalisht dhe fetarisht.

Ne do të ndalemi më shumë te pika e fundit e këtyre 'betejave' për pavarësi. Nuk u konsideruan të mjaftueshme luftërat me motive 'nacional-fetare' që u bënë kundër Perandorisë Osmane, e cila kishte një besim tjetër nga besimi tradicional që kishin popujt e Ballkanit, por 'luftërat' fetare vazhduan dhe brenda shteteve nacionale. Këto beteja të reja ishin kryesisht kundër myslimanëve të cilën ishin pjesë e shteteve nacionale të sapoformuara, pasi nga aty ishte larguar sundimi shekullor osman. Kështu që në shenjë hakmarrjeje, vetëm për faktin se këta njerëz mbartnin besimin e 'pushtuesit osman', ata u diskriminuan, u keqtrajtuuan, madje u dëbuan nga trojet e tyre⁵, në disa

raste ndaj tyre u përdor jo vetëm lufta, por edhe genocidi.⁶

Kleri fetar dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë

Shpallja e Pavarësisë së vendit është nisma më e madhe intelektualëve patriotë, atdhetarë e fetarë, gjithashtu një nga veprat konkrete të klerikëve drejt tolerancës dhe bashkëjetesës fetare të vendosur si kriter i domosdoshëm për ekzistencën e këtij kombi. Ne do të përmendim vetëm disa nga qytetet në të cilat kleri ishte nismëtar dhe firmëtar i aktit të Pavarësisë së qytetit. Ata ishin prezentë dhe ngritësit e flamurit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Po e nismim me qytetin e Elbasanit, i cili më 25 nëntor të vitit 1912 i parapriu Pavarësisë së qyteteve të tjera drejt ngritjes së flamurit kuq e zi me shqiponjë. Këtë veprim ata do t'ia përcjellin Vlorës në orët e para të datës 26, rreth orës 2 të natës, me një telegram ku ndër të tjera njoftojnë se: "Gjithë populli ynë, myslimanë e të krishterë, me një za kanë pranuar indipendencën e Shqipërisë..."⁷

5. Përmendim këtu pothuajse situata të ngjashme me myslimanët në Bullgari, në Malin e Zi, por akoma më keq ishte situata e tyre në Greqi apo në Serbi, ky fenomen njihet botërisht, por që është konsideruar si problem 'nacional', pasi myslimanët në këto vende u quajtën si 'turq' në përgjithësi, apo 'shqiptarë' si në rastin e çamërisë, e kështu u ligjërua lufta ndaj tyre. Në disa raste u bënë shkëmbime të popullsisë e në disa raste tjera myslimanët u shpërngulën vetë

në Perandorinë Osmane apo në Turqinë e re të formuar pas Luftës së Parë Botërore. Për më shumë shih: Alexandër POPOVIÇ "Islamizimi i Ballkanit", Dituria, Tiranë 2006.

6. Këtu përmendim në veçanti gjenocidin ndaj popullsisë çame, po ashtu dhe ndaj disa qyteteve shqiptare në ish-Jugosllavi.

7. *Telegram i Elbasanit 25/26 nëntor 1912*, FEVZIU, Blendi; *100 vjet-një ekskursion në politikën e shtetit shqiptar nga 1912-2012*; UET-

Ndër firmëtarët e aktit të Pavarësisë së Elbasanit përmendim: “Haxhi Hafiz Sulejman Kungulli, zv. i Mitrop. Papa (prift) Dhimitër Dhimitraku, Aqif Pashë Biçakçiu, Shefqet bej Vërlaci, Abdullah bej Tiranë, kryetari i Bashkisë Alush Saraçi, Sheih Mahmut Guma, Sheih Xhafer Pasmaqja, Papa Beniamin Deliana, Serafin Jorgaqi, Beniamin Nosi, Taq Buda, imami Hysein efendi Dorazi etj.”⁸

Në Tiranë e në Durrës ndodhi e njëjta gjë, ku intelektualë e atdhetarë me në krye klerikët më në zë të qytetit, më 26 nëntor 1912 shpallën Pavarësinë. Ndër firmëtarët e Pavarësisë në qytetin e Durrësit ishin: Myderriz Abdylqerim Kurti, myderriz Hysein Mulla-Alushi, myderriz Ali Kuli, myderriz Hafëz Jusuf Gjoni, Ismail Benja, Mahmut Benja, Hysein Dakoli, Hasan Tartari, Ismail Usta Sula, Rexhep Abdurrahman Berberi, Hysein Peni, Filip Sereqi kryeplaku i katolikëve, Aqif Çelkupa, Aleks Duka, Kristaq Rama, Sotir Veveçka, Hamza Tahir Himi, Muhamet Qepaxhiu, Ymer Lutfi Mallkuçi, Musa Milaqi etj.”⁹ Ndërsa disa nga firmëtarët e Pavarësisë së Tiranës ishin: Fuad bej

Toptani, myderriz Sulejmani_____, myderriz Hyseini_____, Xhelal bej Toptani, myderriz Ismail Ndroqi, Refik bej Toptani, Abdullah Gjinali, sheih Ahmet Pazari, Isuf Aqif Banka, Selim Petrela, Ali Shyqyri_____, Nikollë Nishku, Papa Nikollë Papajani...etj”.¹⁰

E njëjta gjë ndodhi në Kavajë, Peqin e Lushnjë, ku Pavarësia u shpall një ditë më pas, më 27 nëntor 1912. Në Kavajë firmëtarët e Pavarësisë ishin: Qazim Fortuzi, Sheih Hamid Kraja, Mustë Cara, Andrea Ekonomi, Haxhi Isuf Kazazi, Pal Xhumari, Besim Sinella, Haxhi Xhoi, Zenel Biturku, Kostandin Qosja, Sali Kullolli, Hasan Nexha etj.¹¹

Në Peqin firmëtarët e Pavarësisë ishin: Kadri beu i Demir Pashës, Myftiu Abdylbaki Biça, Sheih Tahsin Gjinishi, myderriz Sulejman Kuçi, Kryetar i Bashkisë Ahmet Kaziu, Arslan Ballhysa.¹² Elementi i krishterë nuk është pjesë e firmëtarëve në Peqin, pasi në këtë qytet nuk kishte të krishterë. Ndërsa në Lushnjë firmëtarët ishin: Myftiu sheih Ibrahim Karbunara, myderriz Sulejman Arapi, Kadri bej Karbunara, Emin bej Vokopola, Halid efendi Gramshi, Shaqir bej

PRESS, Tiranë, 2012, f. 21

8. KOTHERJA, Hyqmet; *Pavarësia e Elbasanit 1912*; Dy Lindje Dy Perëndime, Tiranë, 2012, f. 7-9, gjithashtu dhe në NOSI, Lef; Dok. Nr. 2, *Dokumenta Historike 1912-1920*; Tiranë, 2007, f. 83.

9. NOSI, Lef; Dok. Nr.13300; *Dokumenta Historike 1912-1920*; Tiranë, 2007, f. 81.

10. NOSI, Lef; Dok. Nr.2103 dhe 7098; *Dokumenta Historike 1912-1920*; Tiranë, 2007, f. 82-83.

11. SHQARRI, Muharrem; *Atdhetari Sheh Hamid Kraja*; OMBRA GVG, Tiranë, 2014, f. 85.

12. NOSI, Lef; Dok. Nr. 1146; *Dokumenta Historike 1912-1920*; Tiranë, 2007, f. 89.

Lushja, Papa Jovani, Sulejman Korreshi, Llambi Xoxi, Haxhi bej Imshta, Fejzullah bej Imshta, Thanas Paftali.¹³

Për të arritur në Kryeqytetin e Pavarësisë, në Vlorë, ku pa diskutim ishin mbledhur krye-atdhetarët, krye-intelektualët dhe njëkohësisht kryefetarët e vendit. Disa nga firmëtarët e Pavarësisë të 28 nëntorit 1912 në Vlorë ishin: Për Beratin: Sami Vrioni, Ilias Vrioni, Taq Tutulani, Babë Dud Karbunara; për Skraparin: Xhelal Koprencka; Hajredin Cakrani; për Lushnjën: Qemal Mullai, Ferit bej Vokopola, Nebi efendi Sefa; për Dibrën: Myfti Vehbi Agolli-Dibra, Hafiz Sherif Lëngu (që të dy ishin Kryetarë të Komunitetit Musliman Shqiptar 1912-29 dhe 1942-45); për Matin: Ahmet Zogu, Riza bej Zogolli, Kurt Agë Kadiu; për Ohrin dhe Strugën: Zyhdhi Ohri, Dr. H. Myrtezai, Nuri Sojlli, Hamdi Ohri, Mustafa Baruti, Dervish Hima; për Durrësin: Abaz efendi Çelkupa, Mustafa Agë Hanxhiu, Jahja Ballhysa, Dom Nikoll Kaçorri; për Tiranën: Abdi Toptani, Murat Toptani; për Shijakun: Xhelal Deliallisi, Ymer Deliallisi, Ibrahim Efendiu; për Krujën: Mustafa Merlika-Kruja; për Elbasanin: Lef Nosi, Shefqet Daiu, Qemal Karaosmani, Dervish Biçaku; për Peqinin: Mahmud efendi Kaziu; për Gramshin dhe Tomorricën: Ismail

Qemal Gramshi; për Gjirokastrën: Azis efendi Gjirokastra, Elmaz Boçe, Veli Harxhi, Myfit Libohova, Petro Poga, Jani Papadhopulli; për Përmetin: Veli Këlcyra, Syrja Vlora; për Tepelenën: Feim Mezhgorani; për Janinën: Kristo Meksi, Aristidh Ruci; për Çamërinë: Veli Gërra, Jakup Veseli, Rexhep Demi, Aziz Tahir Ajdonati; për Delvinën: Avni Delvina; për Korçën: Pandeli Cale, Thanas Floqi, Spiro Ilo; për Pogradecin: Hajdar Blloshmi; për Kosovën, Gjakovën, Plavë-Gucinë: Rexhep Mitrovica, Bedri Ipeku, Salih Gjuka, Midhat Frashëri, Mehmet Pashë Deralla, Isa Boletini, Riza Gjakova, Hajdin Draga, Dervish Ipeku, Zenel Begolli, Qerim Begolli; për Shkodrën: Luigj Gurakuqi; dhe përfaqësues për Vlorën ishin: Ismail Qemali, Zihni Abaz Kanina, Aristidh Ruci, Qazim Kokoshi, Jani Minga, Eqrem Bej Vlora; për Diasporën: Dhimitër Zografi, Dhimitër Mborja, Dhimitër Berati, Dhimitër Ilo, etj., etj.¹⁴

Pothuajse të gjithë këto personalitete, firmëtarë të aktit të Pavarësisë, kanë qenë fetarë, kjo pasi ata minimalisht kishin një arsim fillor apo të mesëm për fenë. Por disa disa prej tyre ishin të arsimuar për teologji, madje ishin klerikë të qyteteve përkatëse që gëzonin respekt dhe kishin reputacion të padiskutueshëm

13. GRIPSHI, Genc; *Historia e Peqinit*; Reklama, Tiranë, 2014, f. 141.

14. FRASHËRI, Kristo; *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë 28 nëntor 1912*; Akademia e Shkencave, Tiranë 2008, f. 91-94.

në popullsinë shqiptare gjatë viteve 1912-1920. Disa prej tyre ishin myderrizë (mësues feje), disa të tjerë imamë apo priftërinj apo baballarë, të cilët drejtonin objektet e kultit në qytetet e tyre. Ndërsa të tjerë ishin dhe në rolin e Myftiut apo të Metropolitit, e kështu me radhë, por disa prej këtyre klerikëve ishin dhe drejtues të Bashkive përkatëse, çka nënkupton një rrezik akoma më të madh për këta klerikë. Në këtë mënyrë, përfaqësuesit e popullit në Kuvendin e Vlorës në vitin 1912 ishin muslimanë e të krishterë, dhe, një numër i konsiderueshëm i tyre ishin Klerikë ndër të cilët: Myftiu Vehbi Efendi Agolli, Hafiz Sherif Langu, Babë Dud (Jorgji) Karbunara, Taq (Dhimitër) Tutulani, Dom Nikoll Kaçorri etj. Në 'Kujtimet' e tij Ismail (Qemal) Vlora e cilëson historike dhe me shumë rëndësi aktin e Pavarësisë. Ai shkruan se: 'Kuvendi Kombëtar, i përbërë prej delegatësh nga të gjithë anët e Shqipërisë pa dallim feje, të mbledhur sot (28.11.1912) në qytetin e Vlorës, shpalli Pavarësinë politike të Shqipërisë...' ¹⁵

Bashkëjetesa mes klerikëve dhe besimtarëve të besimeve të ndryshme arriti kulmin në Kuvendin e Vlorës, kur u mor vendimi që Qeveria e Islamit Qemalit do të ketë në kabinetin e tij, pjesëtarë të katër besimeve fetare pavarësisht përqindjes së besimtarëve që kishte

në popull secili komunitet fetar. Duhet theksuar se Ismail Qemali në përzgjedhjen e qeverisë nga ana e tij kishte përfshirë 8 personalitete me reputacion, të cilët ai i shikonte më të dobishëm për një jetë të gjatë të qeverisë, derisa të normalizohej situata. Ky kabinet i propozuar nga Ismail Vlora nuk gjeti miratimin e të pranishmëve, pasi në përbërje të tij ishin vetëm myslimanë (sunni dhe bektashi) dhe nuk kishte të krishterë. Bab Dud Karbunara ishte i pari i cili refuzoi këtë zgjedhje duke propozuar që Kabineti Qeveritar të ketë myslimanë e të krishterë, dhe për të ruajtur integritetin e secilit, personat të cilët do të propozoheshin duhet të zgjidheshin me votë nga të pranishmit. ¹⁶

Për këtë Kuvendin i doli një detyrë me shumë rëndësi, votimi i Kabinetit të Qeverisë së Përkohshme, duke treguar në këtë mënyrë një tolerancë shembulore dhe njëkohësisht një akt demokratik, pasi në secilin post ministror u zgjodh personi i cili merte më shumë vota nga garuesit pavarësisht besimit që kishte. Në këtë mënyrë, Qeveria e Përkohshme e Vlorës u formua mbi përkatësinë fetare të vendit, me propozimin e Bab Dud Karbunarës në të duhet të merrnin pjesë myslimanë e të krishterë, dhe secili ministër do të zgjidhej pasi të merrte shumicën e votave të pjesëmarrësve

15. QEMALI, Ismail; *Kujtime*; Toena, Tiranë 2009, f. 418.

16. Për më shumë shih: *Përlindja e Shqipërisë, 1913–1914, Gazeta zyrtare e Qeverisë së Vlorës*.

të pranishëm. Përfundimisht Qeveria e Vlorës kishte këtë përbërje: Kryetar i Qeverisë dhe ministër i Punëve të Jashtme, Ismail Qemal Vlora; Nënkryetar i Qeverisë, Dom Nikollë Kaçorri; zv. kryeministër (25.12.1912) Preng Bibë Doda; Ministër i Arsimit, Luigj Gurakuqi; Ministër i Punëve të Brendshme, Myfit Libohova; Ministër i Financave, Abdi Toptani; Ministër i Luftës, Mehmet Pashë Dëralla (Tetova); Ministër i Drejtësisë, Petro Poga; Ministër i Punëve Botore, Mid'hat Frashëri; Ministër i Bujqësisë, Pandeli Cale; Ministër i Postë-Telegrafëve, Lef Nosi.¹⁷

Pas kësaj Kuvendit i doli një tjetër detyrë, përzgjedhja e Pleqësisë, e cila do të përbëhej nga 18 persona. Me propozim të Ismail (Qemalit) Vlorës u vendos që Pleqësia të ishte 'mëkëmbëse' e Kuvendit, të kishte rolin e këshilluesit, kontrolluesit dhe bashkëpuntorit me Qeverinë, por kurrësi ta rrëzonte atë.¹⁸ Me propozimin e Luigj Gurakuqit, Vehbi Dibra u zgjodh Kryetar i Pleqësisë (Senatit) dhe nënkryetar u zgjodh Lef Nosi i një përkatësie tjetër fetare.¹⁹ Njëkohësisht Vehbi

Dibra ushtroi detyrën e zëvendësit të Ismail Qemalit kur ky ishte jashtë vendit. Kuvendi i Pleqësisë nën drejtimin e të nderuarit Myftiut Vehbi Dibra mori shumë vendime me rëndësi, me një shembull konkret të demokracisë, të tolerancës dhe bashkëjetesës fetare.

Nismën e 'tolerancës dhe bashkëjetesës' fetare, së pari e ka ndërmarë i pari myslimanëve, Kryemyftiu i Shqipërisë, Haxhi Vehbi Dibra, i cili dha Fetvanë (legjitimoi fetarisht) Pavarësinë e Shqipërisë. Në fakt fetvaja e tij ishte për legjitimitetin e Flamurit me shqiponjë, pasi kjo nuk u pranua nga disa myftinj të vendit dhe njëkohësisht nuk u pranua nga populli. Nuk ishte e lehtë për një popull që bashkejonin me osmanët nën ombrellën e madhe të Perandorisë, që një moment aq delikat të pranonin shkëputjen nga Perandoria. Për këtë Haxhi Vehbi Dibra në rolin e Kryemyftiut të vendit dha fetvanë ku ndër të tjera arsyetoi se: "...me qëllim për të ruajtur bashkimin e popullit dhe për të ndaluar mosmarrëveshjet e inatet dhe me qëllim që të sigurohet qetësia e përgjithshme, figura e shqiponjës duhet. Kjo fetva është e bazuar në Sheriat dhe sipas nevojës së kohës dhe të vendit..."²⁰ Vehbi Dibra nuk u mjaftua vetëm me fetvanë që ta konsideronte këtë problem të zgjidhur, por Ismail Qemali i la

17. DERVISHI, Kastriot; *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*; Shtëpia botuese 55, Tiranë 2006, f. 23.

18. Grup autorësh; *Historia e popullit shqiptar III (periudha e Pavarësisë 1912-1939)*; Toena, Tiranë 2007, f. 18.

19. XHELILI, Qazim; *Vehbi Dibra – personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare*; Albin, Tiranë, 1998, f. 96.

20. A.Q.SH. Fondi *Qeverisë së Përkohshme e Vlorës*, Dosja III, 5/2, fleta 632.

kopetenca të plotë që ta zgjidhte këtë problem ashtu si mendonte ai, në rrënjë, në bazë. Kështuqë Haxhi Vehbiu shëtititi në disa qytete të vendit, duke biseduar me myftinjtë dhe me myslimanët, të cilët përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë, dhe në këtë mënyrë u stabilizua gjendja.²¹ Me këto veprime dhe fjalë të tij, Haxhi Vehbiu në njëfarë mënyrë iu drejtua myslimanëve

shqiptarë që tashmë fati i tyre nuk ishte me Perandorinë, e cila si dukej po perëndonte, por nga ana tjetër, ata duhet të ishin të bashkuar rreth 'kombësisë', pavarësisht përkatësisë fetare që kishte gjithsecili prej tyre. Deviza e këtij atdhetari të shquar ishte bashkimi dhe vllazërimi. Ai shprehej se: "Atdheu ynë ka nevojë për bashkimin e vllazërimin kombëtar pa dallim feje."²²

21. XHELILI, Qazim; *Vehbi Dibra – personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare*; Albin, Tiranë, 1998, f. 106.

22. A.Q.SH. Fondi 482, Dosja, 14, viti 1925, f. 191.

Referencat

- Burime Arkivore
A.Q.SH. Fondi 482, Dosja, 14, viti 1925, f. 191
A.Q.SH. Fondi Qeverisë së Përkohshme e Vlorës, Dosja III, 5/2, fleta 632
Studime & Libra.
DERVISHI, Kastriot; *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*; Shtëpia botuese 55, Tiranë, 2006.
DIBRA, Haxhi Vehbi; Ç'urdhëron Kur'ani; Komuniteti Musliman Shqiptar, Tiranë, 2014.
DUKA, Ferit; "Sfondi historik i tolerancës fetare në Shqipëri", Simpozium ndërkombëtar 'Këndëvështrimi i diversitetit fetar, kulturor dhe shoqëror në Ballkan nga prespektiva globale", 25-26 Mars 2011 në Tiranë; Botim i PRIZMI, Tiranë, 2012.
Edith Durham; *Brenga e Ballkanit*; Tiranë, 1991.
FEVZIU, Blendi; 100 vjet-një ekskursion në politikën e shtetit shqiptar nga 1912-2012; UET-PRESS, Tiranë, 2012.
FISHTA, Gjergj; *Lahuta e Malcis*; Uegen, Tiranë, 2010.
FRASHËRI, Kristo; *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë 28 nëntor 1912*; Akademia e Shkencave, Tiranë, 2008.
Grup autorësh; *ENCIKLOPEDI – 100 Personalitete shqiptare të kulturës islame gjatë shek. XIX – XX*; KMSH, Tiranë, 2012.
Grup autorësh; *Fjalor i shqipes së sotme*; botimi i parë nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 1984; ribotim nga Toena, Tiranë, 2002.
Grup autorësh; *Historia e popullit shqiptar III (periudha e Pavarësisë 1912-1939)*; Toena, Tiranë, 2007.
GRIPSHI, Genc; *Historia e Peqinit*; Reklama, Tiranë, 2014.

KRAJA, Hafiz Ali; A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar?; Botim i parë parë në vitin 1934; Komuniteti Musliman Shqiptar, Tiranë, 2010.

KOTHERJA, Hyqmet; Pavarësia e Elbasanit 1912; Dy Lindje Dy Perëndime, Tiranë, 2012.

MATA, Ruxhdi; At Shtjefen Gjeçovi, Jeta dhe Vepra; SHBLSH, Tiranë, 1982

MERDANI; Arlinda; Mardhëniet ndërfitare në Shqipëri, Prespektiva të reja për Bashkimin Europian; ONUFRI, Tiranë, 2014.

NOLI, Fan S.; Ligjërime (1906 - 1964); përgatiti Nasho Jorgaqi; DUDAJ, Tiranë, 2002.

NOSI, Lef; Dok. Nr. 2, Dokumenta Historike 1912-1920; Tiranë, 2007.

POPOVIÇ, Alexandër; Islamizimi Ballkanin; Dituria, Tiranë, 2006.

QEMALI, Ismail; Kujtime; Toena, Tiranë, 2009.

SHQARRI, Muharrem; Atdhetari Sheh Hamid Kraja; OMBRA GVG, Tiranë, 2014.

XHELILI, Qazim; Vehbi Dibra – personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare; Albin, Tiranë, 1998.

Gazeta dhe Revista

Kultura Islame; viti 1944, “Tirana”, Tiranë 1942.

Kultura Islame; viti 1942, “Tirana”, Tiranë 1944.

Përlindja e Shqipënisë; Vlorë 1913.

Përlindja e Shqipënisë; Vlorë 1914.

Udha e s’Vërtetës; viti parë, nr. 2, “Ora” Shkodër, Tetor 1923.

Zani i Naltë; viti 1923, “Mbrothësia”, Tiranë 1923.

Zani i Naltë; viti 1927, “Ora”, Shkodër 1927.

Zani i Naltë; viti 1928, “Ora”, Shkodër 1928.

Zani i Naltë; viti 1932, “Ora”, Shkodër 1932.

Zani i Naltë; viti 1935, “Ora”, Shkodër 1935.

Zani i Naltë; viti 1936, “Ora”, Shkodër 1936.

Zani i Naltë; viti 1938, “Ora”, Shkodër 1938.

Toleranca fetare në Vilajetin e Kosovës dhe shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (1908-1912)

Nuridin Ahmeti

Instituti Albanologjik - Prishtinë

Është mendim i përbashkët i studuesve vendas e të huaj, se epiqendra e kryengritjeve shqiptare të viteve 1908-1912 ishte në Vilajetin e Kosovës. Si prijës të këtyre kryengritjeve dallohen disa figura udhëheqëse si; Idriz Seferi, Isa Boletini etj., të cilët ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë kishin prijësit fetarë të kohës, si bie fjala Idriz Seferi, kishte sekretar personal të tij boxhën e njohur nga rrethina e Gjilanit Mulla Halimin, kurse me disa prijës islam bashkëpunoi ngushtë duke i angazhuar drejtpërsëdrejti edhe në luftime kundër xhonturqeve si: Mulla Sinan Maxheren nga rrethina e Preshevës dhe Mulla Idrizin nga Gjilani, boxhallarë të cilët kishin një bashkëpunim të qëndrueshëm edhe me priftërinjtë shqiptarë të asaj ane Dom Mikel Tarabulusin, Dom Tadej Ivanaj etj., me qëllim të mbarëvajtjes së më të mirë të Lëvizjes Kombëtare dhe qëllimeve të tyre. Karakteristikë në këtë periudhë kohore në Vilajetin e Kosovës është se shënohen edhe disa fërkime ndërjetare si në Prizren dhe Gjakovë, p.sh. në ditët e caktuara islame koka e derrit të therur hidhet në xhamia, me qëllim të futjes së përçarjes ndërmjet popullatës myslimane dhe katolike, e gjithë kjo evitohet në mënyrën më të mirë nga prijësit fetarë të kohës.

Më këtë vështrim mëtojmë që përmes dokumenteve dhe literaturës relevante të vëmë në pah rolin e tolerancës ndërjetare në njërën anë dhe kontributin e prijësve fetarë në Lëvizjen Kombëtare në Vilajetin e Kosovës gjatë viteve 1908-1912.

“Kristianë e myslimanë janë vëllezër shqiptarë të pandarë. Të kemi dashuri edhe për bashkatdhetarët e krishterë, sepse edhe ata i kemi vëllezër e s’kemi si ndahemi. Të përpiqemi edhe për të mirën e tyre si për veten tonë... të ndjekim një rrugë të përbashkët... t’i tregojmë botës mbarë se shqiptarët pa dallim feje, janë vëllezër si bijë të njëshëm të së dashurës sonë Shqipëri.”

(Haxhi Vehbi ef. Dibra).¹

1. Gazmend Shpuza, *Kongresi Mysliman Shqiptar (1923)*, në: “Kultura Popullore”, nr. 1-2, ASHRSH-IKP, Tiranë, 1997, f. 192-193.

Hyrje

Tematika e tolerancës fetare në shoqërinë shqiptare është një ndër problematikat e trajtuara mjaft në historiografinë shqiptare, veçanërisht pas viteve '90 të shekullit të kaluar. Ky fenomen te shqiptarët, nga shumica e studiuesve tanë u vlerësua në superlativ, si: “*shembull për rajonin*”, “*pasuri e kultivuar*” etj., por ka edhe të atillë që kanë pasur rezerva, por shpesh ky trajtim është nisur nga premisa iluministe dhe në funksion të komb-formimit, respektivisht të ndërtimit të unitetit shqiptar.

Shikuar në aspektin terminologjik, gjejmë emërtime e epitete të ndryshme nga studiuesit, si: “*Tolerancë ndërfetare*”, “*Mirëkuptim ndërfetar*”, “*Harmoni ndërfetare*”, “*Bashkëjetesë*”, etj.

Ndërkaq ne jemi ndalur vetëm në një periudhë të kufizuar kohore, në periudhën më dinamike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në vitet 1908-1912, dhe në një hapësirë të kufizuar territoriale, në Vilajetin e Kosovës. Kemi mendimin se ky fenomen në këtë hapësirë është trajtuar pak, e që për vitet që po flasim kishte rëndësinë e vet, për disa arsye:

E para - Vilajeti i Kosovës nga historiografia shqiptare konsiderohet si qendër e kryengritjeve në vitet 1908-1909. Në këtë kuadër, përbërja fetare luante rol mjaft domethënës në mbarëvajtjen e kësaj kryengritjeje dhe në mobilizimin e masave në luftën kundër xhonturqve.

E dyta - Vënia në pah e shembujve që do t'i potencojmë më poshtë, janë një dëshmi me interes për panoramën e tolerancës ndërfetare te shqiptarët, para më shumë së njëqind vitesh, në Vilajetin e Kosovës.

E treta - Ngjarjet që ndodhën me karakter fetar në Prizren dhe Gjakovë gjatë viteve 1908-1909 kishin shqetësuar jo vetëm konsujt e huaj në Prizren, sidomos ata austro-hungarez, por edhe administratën vendore dhe autoritetet e Prizrenit.

Personaliteti i Mulla Sherif Efendiut në mbarëvajtjen e mirëkuptimit ndërfetar në Prizren

Në vitin 1908, pas krijimit të rrethanave të reja politike te shqiptarët, ardhja e xhonturqve në pushtet, mospërmblidhja e premtimeve ndaj shqiptarëve, zhgënjimi i shqiptarëve të cilët kishin dhënë kontribut për t'i sjellë ata në pushtet, krijuan mosbesim te popullata vendase dhe rivalitet midis shqiptarëve dhe xhonturqve, që kulmoi më pas edhe me kryengritje të përgjithshme.

Viti 1908 në Vilajetin e Kosovës, përveç të tjerash, po shënonte edhe disa fërkime ndërfetare që, padyshim, do të shkaktonin shqetësime jo vetëm te popullata vendase, por edhe te konsujt e huaj që në atë kohë ishin të vendosur në qendrat e ndryshme të Vilajeteve osmane me popullatë kryesisht shqiptare, posaçërisht te

konsujt austro-hungarez që këto ngjarje i përcillnin me vëmendje, pasi Vjena angazhohej për ruajtjen e stabilitetit dhe status quo-së në Ballkan, ndërsa serbët dhe rusët, të cilët në Kosovë kishin përfaqësitë e tyre, synonin të destabilizonin situatën përmes provokacioneve të ndryshme. Në këtë linjë, serbët dhe rusët përpiqeshin të shfrytëzonin dallimet fetare në mesin e shqiptarëve, duke synuar që një konflikt të tillë ndërfitar ta shfrytëzonin për të krijuar terrenin e depërtimit të tyre drejt Kosovës.

Në rrethinën e Gjakovës, në vitin 1907 rrëmbehet një prift katolik (Luigj Paliqi N. A.)², më pas në fshatin Smolicë të Gjakovës kokat e derrave të therur hidhen në xhami ditën e Festës së Bajramit dhe me gjakun e derrave spërkaten muret e xhamisë. Sipas konsullit austro-hungarez në Prizren, Oskar Prohaska, masat nga popullata myslimane ndaj katolikëve ishin pothuajse të menjëhershme duke bojkotuar popullatën katolike, konkretisht dyqanet disa herë³ për disa muaj.

Pothuaj me skenar të njëjtë sikurse në Gjakovë edhe në Prizren, në vitin 1908 në Festën e Bajramit në disa xhami hidhen kokat e derrave të therur dhe muret e xhamisë lyhen me gjak, fenomen ky i provokimit të popullatës myslimane në Kosovë në

ditë të veçanta feste, që ka zgjatur, pothuajse pa ndalur, deri në luftën e fundit në Kosovë në vitin 1999, kur pjesa më e madhe e popullatës së Kosovës nga forcat policore serbe janë nxjerrë jashtë kufijve pikërisht ditën e Festës së Bajramit.⁴

Kjo ngjarje do të rezultojë edhe me bojkotimin nga popullata myslimane të dyqaneve dhe mallrave të popullatës katolike në Prizren, dhe sipas konsullit austro-hungarez në Prizren, Prohaska, i cili e njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme austro-hungareze, veprimet e myslimanëve kishin shkuar deri në atë masë sa popullata myslimane ndaloi popullatën katolike edhe në punimin e tokës, në periudhën mars-korrik 1908.⁵

Duke e vërejtur këtë tensionim të situatës ndërmjet popullatës myslimane dhe katolike në Prizren dhe nga shqetësimi se ky problem do të marrë përmasa më të mëdha, myftiu i Prizrenit, deputeti i Parlamentit Osman, njeri me autoritet i kësaj ane, mulla Sherif Efendiu, më 13 korrik të vitit 1908 organizon në shtëpinë e tij në Prizren, kuvendin e krerëve fetarë shqiptarë myslimanë, ku vendoset, që nga ajo ditë, të ndërpritej bojkoti ndaj shqiptarëve katolikë.⁶ Kjo marrëveshje u arrit

2. Stefanaq Pollo, *Në gjurmë të historisë shqiptare* 2, ASHSH- IH, Tiranë, 2003, f. 117.

3. Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar, Përpjekja (Përktheu nga origjinali: Artan Puto), Tiranë, 2009, f. 491.*

4. Hysen Matoshi, *Lotët për atdheun e robëruar, në: "Takvim", nr. 42, BIK, Prishtinë, 2010.*

5. Sylë Ukshini, *Kuvendi i Ferizajt në burimet e proveniencës Austro- Hungareze, në: "Vjetar", nr. 41- 42, Arkivi Shtetëror i Kosovës, Prishtinë, f. 298.*

6. *Po aty, f. 299.*

falë kontributit dhe largpamësisë që treguan veçanërisht, mulla Sherif Efendiu, si përfaqësues i popullatës myslimane në atë kuvend.⁷

Mbi rolin e ulemave të Prizrenit rreth raporteve me popullatën katolike në këtë qytet dhe për disa incidente njofton edhe administrata e kohës në Prizren.⁸

Mulla Sherif Efendiu, si autoritet i kohës, duke analizuar gjendjen e krijuar dhe duke bashkëpunuar me krerët e fiseve të besimeve përkatëse, arrin që ta evitojë më të keqen.

Konflikte të tilla lënë dyshime të përfshirjes së konsullatës serbe dhe bandave të tyre në këtë ngjarje. Në lidhje me këtë, në një telegram të vitit 1908 të Konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, potencohet propaganda e fuqishme që qarqet serbe dhe bandat e tyre propagandonin ndaj Austro-Hungarisë në Vilajetin e Kosovës dhe ishin shumë aktive, me qëllim të dështimit të misionit të tyre në Vilajetin e Kosovës.⁹

Duke pasur parasysh se Austro-Hungaria në atë kohë kishte marrëveshje për mbrojtjen e popullatës katolike në gjithë hapësirën e Perandorisë Osmane

dhe në anën tjetër propaganda e fuqishme serbe kundër Austro-Hungarisë, siç duket kishte gjetur mjetin e përshtatshëm, futjen e konflikteve ndërjetare të shqiptarët me qëllim të realizimit të planeve të veta ekspansioniste, fatmirësisht nuk u arrit falë angazhimit dhe vetëdijes së prijësve fetarë e veçanërisht të atyre që i cekëm më lart.

Ndër kontribuuesit në mbarëvajtjen e tolerancës ndërjetare në Prizren, hasim edhe priftin katolik Imzot Lazër Mjedën, i cili nga viti 1909 ishte emëruar nga Vatikani në detyrën e arqipeshkvit të Shkupit me seli në Prizren¹⁰, kontributi i tij është mjaft domethënës sidomos gjatë viteve 1912-1913, kur ushtritë serbo-malazeze ushtronin dhunë mbi popullatën myslimane dhe katolike, duke u bërë presion për konvertim me dhunë në fenë ortodokse. Lazër Mjeda ishte shumë aktiv në dërgimin e raporteve në Ministrinë e Punëve të Jashtme Austro-Hungareze dhe duke alarmuar opinionin ndërkombëtar për masakrat që po shkaktonin ushtritë e aleancës ballkanike,¹¹

10. Imzot Mark Sopi, *Imzot Lazër Mjeda (1860- 1935) shembulli i barinut të mirë dhe atdashedashës*, në: “ Imzot Lazër Mjeda-mbrojtës dhe lëvrues i identitetit shqiptar”, Prishtinë- St.Gallen, 2011, f. 28; Albert Ramaj, *Lazër Mjeda në Arqipeshëqvinë Shkup-Prizren mes 1909-1921*, në: “ Imzot Lazër Mjeda - mbrojtës dhe lëvrues i identitetit shqiptar”, Prishtinë- St. Gallen, 2011, f. 47-172.

11. Gjon Berisha, *Të dhëna nga Imzot Lazër Mjeda mbi gjenocidin e ushtrive të Aleancës Ballkanike në Kosovë gjatë viteve 1912-1913*,

7. Nuridin Ahmeti, *Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në Vilajetin e Kosovës (1878-1912)*, LAP, Prishtinë, 2011, f. 209.

8. Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü-Osmanlı Arşivi Daire Başkanlığı,(BBA), Kodu; Y. MTV; Dosya nr. 308.

9. Sylë Ukshini, *Kuvendi i Ferizajt në burimet e proveniencës Austro- Hungareze..*, pun. i cit., f. 293.

raportet e të cilit, padyshim, që kur flitet për masakrat e lartcekura janë pikë reference jo vetëm për studiuesit vendore¹², por edhe për ata ndërkombëtarë.¹³ Raportet e dërguara nuk janë selektive në aspektin fetar, por e tregonin përgjithësisht gjendjen e popullatës shqiptare,¹⁴ qoftë të besimit katolik apo edhe mysliman.

Ngjarje të tjera të rëndësishme që ndodhën në Vilajetin e Kosovës janë edhe kryengritjet e viti 1908-1912, të udhëhequra nga Idriz Seferi e Isa Boletini.

Figura e Mulla Sinan Maxhres¹⁵

në: “Imzot Lazër Mjeda- mbrojtës dhe lëvrues i identitetit shqiptar”, Prishtinë- St. Gallen, 2011, f. 47-172.

12. Gjergj Gashi, *Kosova altari i Arbërisë 1910-1941*, vëll. 2, Onufri, Tiranë, f. 79, 80.

13. Shih: Noel Malkolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha-Prishtinë & Shtëpia e Librit-Tiranë, f. 264, 265, 266.

14. Gjergj Gashi, *Kosova altari i Arbërisë 1910-1941*, vëll. 2, Onufri, Tiranë, f. 39, 40; Genti Kruja, *Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërjetar*, Prizmi, Tiranë, 2008, f. 144; Mark Krasniqi, *Toleranca në traditën shqiptare*, ASHAK, Prishtinë, 2007, f. 67.

15. **Mulla Sinan Maxhera** u lind në fshatin Maxhere të Karadakut të Preshevës në vitin 1863, nga e ëma Ajetja dhe babai Bilali. Rridhte nga një familje me tradita patriotike. Mësimet e para i mori te hoxha i fshatit, ndërsa medresenë e mesme e mbaroi në Shkup, për ta vazhduar më vonë Fakultetin e Drejtësisë në Stamboll. Si ushtar i Perandorisë Osmane mori pjesë në luftë kundër ushtrisë greke, ku edhe u plagos. Ka punuar si hoxhë në fshatin Caravajk, Pogradë e Dobërçan, ku nxënësve pos lëndëve fetare u mbante edhe ligjërata

dhe dom Mikel Tarabulusit¹⁶

me karakter kombëtar. Me autoritetin që gëzonte në popull, Mulla Sinani luajti një rol të rëndësishëm edhe në pajtimin e gjaqeve dhe në zhdukjen e hakmarrjes. Mori pjesë në luftën e prillit të vitit 1910 përkrah Idriz Seferit. Për trimërinë e treguar në këtë kryengritje populli i thuri edhe këngë. Pas shuarjes së kryengritjes, pushteti xhonturk do të organizojë ekspedita ndëshkuese kundër kryengritësve shqiptarë, me ç'rast Mulla Sinani do të arrestohet dhe do të burgoset në Kaçanik. Gjykata ushtarake xhonturke do ta dënojë me vdekje së bashku me 6 vetë të tjerë. Mulla Sinani u var në Kaçanik më 7 korrik të vitit 1910 dhe u varros në varrezat e vjetra të këtij qyteti. Katër muaj pas vdekjes, gruas së tij do i lindë djalë, të cilin familja e pagëzon me emrin Sinan. Sipas studiuesit Shaban Braha, Mulla Sinan Maxhera është varur tek “Ura e Vezirit” në rajonin e Kukësit, shih: Shaban Braha, *Idriz Seferi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, “8 Nëntori”, Tiranë, 1981, f. 95.

16. **Dom Mikel Tarbulusi**, Prejardhjen e kishte nga Prizreni, për vite të tëra ai shërbeu në Stubell e epërme si famullitar, ku kaloi një pjesë të mirë të jetës. Mikeli erdhi si prift, por shërbeu më tepër apo kryesisht si mësues e patriot shqiptar. Herët mori lidhje me Lëvizjen Kombëtare dhe me kohë u bë mik i vërtetë i Idriz Seferit. Qysh në fillim të shek. XX Mikeli e filloi aktivitetin kombëtar. Në vitin 1905 e hapi shkollën e parë shqipe në Stubllën e Epërme të Vitisë. Kishte guximin të fliste për çështje kombëtare, kishte marrëdhënie të ngushta e miqësore me shumë shqiptarë myslimanë dhe shpesh herë bisedonte haptazi për çështje thjesht patriotike, ja seç thoshte ai: *Gjatë një viti kisha dëshiruar të jem, 6 muaj prift, 6 muaj hoxhë, e 12 muaj mësues*. Për shkak të qëndrimeve patriotike dhe kombëtare, u ndoq dhe u persekutua nga regjimet e ndryshme. Shkoi në këmbë për të marrë pjesë në solemnitetin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Për

Pas mospërbushjes së premtimeve nga xhonturqit dhe padrejtësive sistematike sidomos në aspektin e mbledhjes së taksave, popullata shqiptare e Vilajetit të Kosovës kishte filluar përgatitjet e një kryengritjeje në vitin 1908, duke u ndeshur në grykën e Kaçanikut.

Pa hyrë në analizën e zhvillimit të luftimeve dua të ndalem te njëra nga figurat kyçe të kësaj kohe Mulla Sinan Maxhra¹⁷, të cilit Idriz Seferi ia besoi postin e sekretarit personal të tij.¹⁸ Fatkeqësisht kjo figurë, Mulla Sinan Maxhra, shumë pak i përmendur nga studiuesit tanë, njeri i cili nuk kishte pranuar t'i ndahej në momentet vendimtare as në frontin e luftës Idriz Seferit, dhe pas shuarjes së kryengritjes, e njohur si kryengritja e Idriz Seferit, nga ana e xhonturqve kapet dhe varet për së gjalli, domethënëse e rastit të përmendur është se Idriz Seferi, duke pasur parasysh se vendi ku u zhvilluan kryengritjet kishte popullatë të përzier myslimane dhe

katolike, u tregua largpamës duke angazhuar edhe prijës fetarë të kësaj ane për mobilizimin e masave.

Përderisa nga myslimanët zgjodhi prijësit e njohur Mulla Sinan Maxhrën dhe Mulla Halimin¹⁹, “*Kleriku përparimtar e patriot Halim Ahmeti, njëri nga propagandistët e njohur të Lëvizjes Kombëtare në Moravë dhe njëri nga bashkëluftëtarët e Idriz Seferit në betejat e Kaçanikut e Karadakut, ku edhe qe plagosur, iu shtrua burgimit dhe torturave në Prishtinë*”²⁰, nga popullata katolike kishte zgjedhur priftin Dom Mikel Tarabulisin, i cili përveç punës edukative dhe arsimore në Gjuhën Shqipe, do të bashkëpunojë ngushtë me Idriz Seferin dhe prijësit e tjerë

shkak të torturave, arrestimeve e ndjekjeve të regjimeve të ndryshme, u sëmur dhe vdiq nga tuberkulozi në vitet ‘20 të shek. XX. Sadullah Brestovci, *vep. e cit.*, f. 130-186-187.

17. Shih: Shaban Braha, *Vep. e cit.*, f. 132.
18. Sadulla Brestovci, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në kazan e Gjilanit - Islam Pira 1861- 1931*, IAP, Prishtinë, 2008, f. 163, 164; Rexhep Selimi, *Kontributi i Mulla Sinan Maxharës në lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, në IH- Jeta dhe vepra e Idriz Seferit, Prishtinë, 2003, f. 113; Nuridin Ahmeti, *Kontributi i klerikëve në kryengritjet e vitit 1910-1912 në Vilajetin e Kosovës*, në: “Albanologji”, 1-2010, IAP, Prishtinë, 2011, f. 181-201.

19. **Mulla Halimi** u lind në fshatin Cërnice. Babi i tij, Mulla Ahmeti dhe xhaxhai i tij Mulla Memishi, ishin njerëz përparimtarë të asaj ane. Ndonëse hoxhë dhe i biri i hoxhës, Mulla Halimi ishte njëri ndër luftëtarët më besnikë të Idriz Seferit, i cili dha prova si një kundërshtar i vendosur i pushtetit xhonturk, si në predikime, ashtu edhe në fushën e betejës. Ai, së bashku me disa të afërm të tij, do të marrë pjesë në kryengritjen e Kaçanikut të vitit 1910. Disa ditë pas betejës ishte zënë dhe ishte burgosur dhe si kundërshtar i zëshëm i pushtetit xhonturk ishte dënuar me tetë vjet burg. Në ato anë ishte i njohur si Mulla Halimi. Vdiq më 1942. Mulla Halimi, jo vetëm që ushqeui vetveten me ndjenja fetare e kombëtare, por këtë ndjenjë e përcolli edhe te pasardhësit e tij. Ata, duke i ruajtur me fanatizëm këshillat dhe urtësitë e Mulla Halimit, qëndruan një shekull nëpër burgjet e pushtuesve të Shqipërisë etnike, pa u pajtuar asnjëherë me robërinë. Sadulla Brestovci, *vep. e cit.*, f. 164-165.

20. Shaban Braha, *vep. e cit.*, f. 132.

fetarë myslimanë për mbarëvajtjen e tolerancës ndërfaqetare, që pa dyshim pati efektet e veta edhe në organizimet e kryengritjes kundër xhonturqve.

Një guxim tjetër kemi edhe nga një prift i kësaj ane që quhet Dom Tadej Ivanaj²¹, prift me origjinë kroate po që shërbente në fshatin Stubëll të Vitisë së Epërme, i cili në momentin e largimit të popullatës myslimane të Gjilanit me rrethinë nga zullumi xhonturk, thuhet se kishte hapur dyert për strehimin e popullatës myslimane, duke i mbajtur me ushqim e duke u dhënë ndihmë të nevojshme.

Përfundimi

Si përfundim mund të konstatohet se për realizimin e objektivave të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dukuria e tolerancës fetare luajti një rol unifikues kulturor dhe politik, duke u shndërruar në një potencial të fuqishëm për formimin dhe fuqizimin e identitetit kombëtar shqiptar në kohën e lëvizjeve që çuan në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Elementi shqiptar mysliman që përbënte shumicën, në Vilajetin e Kosovës në luftën për realizimin e objektivave të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, pavarësisht konflikteve sporadike të provokuara nga jashtë, ndërtoi një front të përbashkët me pjesëtarët e komunitetit shqiptar të besimit

katolik. Ky tejkalim i dallimeve fetare ishte në funksion të realizimit të kauzës së përbashkët për çlirimin kombëtar nga sundimi pesë shekullor osman. Natyrisht, siç theksuam edhe më lart, në këtë kauzë dhe në këtë tolerancë fetare kontributi kryesor bie mbi prijësit politikë dhe fetarë, për të cilët përkatësia fetare ishte një çështje dytësore përballë përkatësisë etnike dhe idealit për bërjen e kombit dhe të pavarësisë së Shqipërisë. Meritë të veçantë në këtë aspekt kanë edhe prijësit fetarë shqiptarë, që ditën ta transmetonin fenë dhe parimet fetare tek të tjerët në mënyrën më të mirë dhe nuk lejuan keqinterpretimin e parimeve fetare.²² Autoriteti dhe puna e prijësve fetarë, jo vetëm në Vilajetin Kosovës, por edhe në të gjithë hapësirën shqiptare, ishte vendimtare në fatet e kombit. Kjo u dëshmuar edhe më 28 nëntor 1912, në Kuvendin e Vlorës, me pjesëmarrjen e krerëve fetarë si firmëtarë, por edhe duke iu besuar poste të rëndësishme në Qeverinë e Përkohshme të Ismail Qemalit.

22. Qemajl Morina, *Identiteti fetar i shqiptarëve*, në: "Edukata Islame", nr. 70, KBIK, Prishtinë, 2003, f. 6; Gazmend Shpuza, *Bashkëjetesa ndërfaqetare midis shqiptarëve*, në: "Nga Perandoria Osmane në Shqipëri", Tiranë, 2005, f. 46; Qani Nesimi, *Toleranca fetare te shqiptaret*, në: "Univers", nr. 7, Tiranë, 2005, f. 100.

21. Arkivi i Kosovës, (AK), F. Sadulla Brestovci, K. 1, f. 10 (dorëshkrim).

Zani i Naltë, një model etik dhe përgjegjës i komunikimit fetar shqiptar

Prof. assoc. dr. Mark Marku
Universiteti i Tiranës

**Zani i Naltë, produkt i një filozofie mirëkuptimi:
Zot i përbashkët, atdhe i përbashkët, besime të ndryshme.**

Abstrakt

Formula shqiptare: Zot i përbashkët, atdhe i përbashkët, besime të ndryshme, qe formula e përballimit të sfidës kombformuese e shqiptarëve dhe u përqaftua nga elita klerikale e të gjitha besimeve, pavarësisht besimeve, rezistencës apo pasigurisë që ajo mbartte. Elita klerikale, politike dhe kulturore myslimane është një nga ideatorët dhe zbatueset e kësaj formule. Historiani Peter Bartl thotë se, “qenë pikërisht shkrimtarët myslimanë që mund të cilësohen si nacionalistë të vërtetë ata që dolën si luftëtarë të mendimit kombëtar shqiptar. Me anë të shkrimeve të tyre ata ushtruan në kohën e Rilindjes kombëtare një ndikim të madh mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”.

Në historinë e besimeve të popullit shqiptar, pa dyshim, një moment të rëndësishëm përbën periudha nga viti 1878 deri në vitin 1925, në të cilën shqiptarët u vunë para sfidës së krijimit të shtetit kombëtar shqiptar dhe konsolidimit të tij. Dobësimi dhe më pas rënia e Perandorisë Osmane shkoi paralelisht me konsolidimin e lëvizjeve kombëtare të popujve të Ballkanit, grekëve, rumunëve, serbëve, malazezëve,

bullgarëve, shqiptarëve, për krijimin e shteteve kombëtare. Shqiptarët, në ndryshim nga popujt e tjerë ballkanikë, kishin në këtë proces një sfidë shtesë për ta tejkaluar: problemin fetar. Ndryshe nga popujt e tjerë ballkanikë, që ishin kryesisht homogjenë për sa i përket besimit, pasi popullsia e tyre ishte kryesisht ortodokse, shqiptarët, për shkak të rrethanave historike, ndaheshin në katër komunitete fetare: myslimanë, bektashi, ortodoksë dhe katolikë, me

myslimanët shumicë mbizotëruese.

Sfida e krijimit të një shteti kombëtar unitar me tre besime të popullsisë së tij ishte një sfidë jo e vogël, qoftë për krijimin e identitetit kombëtar, qoftë për organizimin e lëvizjes kombëtare shqiptare, qoftë për organizimin e shtetit shqiptar dhe konsolidimin e tij. Dihet që feja është një element që ka luajtur një rol të rëndësishëm në lëvizjet kombëtare që sollën krijimin e shteteve kombëtare nga 1700 e këtej në Evropë. Feja ka qenë një element i rëndësishëm kombformues krahas elementeve të tjerë identitarë si: raca, gjuha, territori, kultura, historia e përbashkët. Madje ka kombe, ku ajo ka shërbyer si element parësor identifikues siç ndodh për shembull te fqinjët tanë ballkanas: kroatët, boshnjakët dhe serbët. Këta të fundit i përkasin të njëjtës racë, asaj sllave, flasin thuajse të njëjtën gjuhë, ndajnë mes tyre një territor të përbashkët por, u identifikuan si kombi kroat, serb dhe boshnjak, pikërisht për shkak se ndjekin besime të ndryshme; serbët besimin ortodoks, kroatët besimin katolik dhe boshnjakët besimin mysliman.

Elita kulturore dhe politike e Rilindjes e kishte parashikuar këtë pengesë që në fillim të shfaqjes së idesë kombëtare shqiptare, por kjo nuk e dekurajoi atë për realizimin e tij. Hobsbaum në librin e tij *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780-ta* vëren: “Nacionalizmi modern sidomos në fazat e veta prozelite e ka parë

fenë me shumë rezervë, si një forcë që mund ta sfidonte monopolin e besnikërisë që kombi e kërkon nga besimtarët e vet... Fetë e ndryshme që u shpikën në kohë të ndryshme midis shekullit VI para Krishtit dhe shekullit VII pas Krishtit janë universale për nga vetë përkufizimi i tyre dhe kësioj janë krijuar për të shuar dallimet etnike, gjuhësore, politike apo të tjetërlojta”.¹ Për këtë arsye, rilindësit i kushtonin jo pak rëndësi problemit të fesë dhe raporteve të saj me shtetin e ardhshëm shqiptar. Garantimi i të gjitha besimeve se asnjëri prej tyre nuk do të kishte pozita mbizotëruese në shtetin e ardhshëm kombëtar dhe se, me krijimin e tij, mund të sigurohej jeta normale e besimtarëve të të gjitha besimeve, ka qenë edhe problemi themelor që shtrohej para ideatorëve dhe themeluesve të shtetit shqiptar. Sami Frashëri, që në vitin 1891 në veprën e tij “Shqipëria, ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet?”, pasi përshkruan organizimin e jetës fetare në shtetin e ardhshëm, thotë se: “të parët e besëve, domethënë myftiu i madh, eksarku dhe kryepeshkopi do të jenë me nder të madh por nuk do të përzhjenë përveçse në punërat e besësë. Ulemaja, dervishët e priftëria do të mos përzhjenë as në mësimet e në shkollat përveç mësimin të fesë që do të bëjnë nëpër xhamit,

1. Erik Hobsbaum, “Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780-ta e këtej”, f. 68, Toena, Tiranë, 1996.

medreset, kishat”². Kërkesa për një shtet ku feja të ishte e ndarë nga shteti është artikuluar nga thujse të gjithë aktorët kryesorë të lëvizjes kombëtare shqiptare dhe për këtë arsye shteti shqiptar, i krijuar në vitin 1912, ishte një shtet *par excellence* laik. Një pjesë e konsiderueshme e elitës politike të lëvizjes kombëtare vinte nga Perandoria Osmane dhe nga përvoja kishte mësuar se besimet e ndryshme mund të bashkëjetojnë njëri me tjetrin nën kupolën shtetërore, me kushtin e vetëm që shteti të mos ishte abuziv me ndonjërin prej tyre. Historiani italian Antonio Biagini vëren në librin e tij Historia e Shqipërisë nga zanafilla në ditët tona se, “Në Perandorinë Osmane nuk ishin besimet fetare ato që bënë të pamundur bashkëjetesën e racave të ndryshme, por ishin dallimet në trajtimin e tyre nga ana e qeverisë ato që ngjallnin dhe ushqenin urrejtjen. Sikur të gjithë të ishin trajtuar në të njëjtën mënyrë, toleranca do të kishte mbretëruar ashtu si mbretëronte në malet shqiptare”.³

Studiuesit që janë marrë me historinë e krijimit të shtetit kombëtar shqiptar, si dhe me rolin që kanë pasur besimet fetare të shqiptarëve në

këtë proces, e shpjegojnë fenomenin shqiptar të kombformimit në mënyrë sipërfaqësore dhe thujse të gjithë njëzëri e shpjegojnë këtë me karakterin afetar të shqiptarëve. Duke iu referuar një modeli mbizotërues të lëvizjeve kombëtare evropiane, ku identiteti fetar dhe ai gjuhësor apo racor thujse përputhen, ata mendojnë se, shqiptarët u bashkuan në lëvizjen kombëtare, sepse identifikohen më shumë përmes racës dhe gjuhës dhe fare pak përmes besimit. Roberto Morozzo della Rocca në librin e tij *Kombësia dhe Feja në Shqipëri*, e përmbledh kështu këtë konsideratë të përgjithshme të të gjithë studiuesve: “Të vjetrit kanë thënë se populli shqiptar është më shumë popull luftëtar se popull fetar. Nganjëherë, - thotë ai, - është theksuar se feja e vërtetë e shqiptarëve qëndron në krenarinë, në besën për fjalën e dhënë, në ndjenjën e nderit, në lidhjen me traditat, me pak fjalë feja tek shqiptarët ishte fe e karakterit dhe temperamentit. Bajroni gjatë udhëtimeve të tij në Ballkan dyshonte shumë për interesin e shqiptarëve ndaj fesë. Ministri italian Ciano, farkëtues i pushtimit italian të 1939-ës, ishte krejt i bindur për ateizmin e shqiptarëve dhe synonte të vepronte duke e pasur parasysh këtë”.⁴

Personalisht mendoj se, pavarësisht një doze të vërtete që përmban një konstatim i tillë, ai nuk

2. Sami Frashëri, “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet?”, f. 83, Kapitulli XV, Punërat e besëvet, Sh. B. Naim Frashëri, 1962.

3. Antonio Biagini, “Historia e Shqipërisë nga zanafilla në ditët tona”, f. 95, Shtëpia e librit dhe komunikimit, 2000.

4. Roberto Morozzo Della Rocca, “Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944”, f. 7, Elena Gjika, Tiranë, 1994.

e sqaron arsyen e konvergimit të besimtarëve të ndryshëm shqiptarë për sa i përket çështjes kombëtare. Mundet që elitat klerikale, kulturore dhe politike të shqiptarët të kenë kuptuar filozofinë e një historie mbijetese të përbashkët të shqiptarëve përgjatë gjithë historisë së tyre të ndërlikuar, që i ka bërë ata të orientohen drejt besimeve të ndryshme, por të mbeten njëherësh shqiptarë. Kjo filozofi mbijetese dhe bashkëjetese fetare bën të mundur që në shtetin e parë shqiptar zëvendëskryeministër të jetë një prift katolik, Dom Nikoll Kaçorri, dhe kryetar i senatit të jetë myftiu Vehbi Dibra.

Formula shqiptare: Zot i përbashkët, atdhe i përbashkët, besime të ndryshme, qe formula e përbashkët të sfidës kombformuese e shqiptarëve dhe u përqafua nga elita klerikale e të gjitha besimeve, pavarësisht hezitimeve, rezistencës apo pasigurisë që ajo mbartte. Elita klerikale, politike dhe kulturore myslimane është një nga ideoret dhe zbatueset e kësaj formule. Historiani Peter Bartl thotë se, “qenë pikërisht shkrimtarët myslimanë që mund të cilësohen si nacionalistë të vërtetë ata që dolën si luftëtarë të mendimit kombëtar shqiptar. Me anë të shkrimeve të tyre ata ushtruan në kohën e Rilindjes kombëtare një ndikim të madh mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”⁵.

Mjafton të kujtojmë se grupi kulturor i Stambollit përbëhej nga shkrimtarë, dijetarë, klerikë, intelektualë, një pjesë e mirë e të cilëve ishin funksionarë të aparatit burokratik perandorak. Në këtë grup bënin pjesë Sami, Naim e Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Hoxha Tahsini, Ismail Qemali, Hasan Prishtina. Elita kulturore dhe politike e Stambollit krijoi Shoqërinë e Stambollit (1879), e cila u ndalua në vitin 1881, por që u zhvendos në Bukuresht ku kishte kushte më të favorshme për të ushtruar veprimtarinë e saj. Në 23 vitet e ekzistencës së kësaj shoqërie u botuan 25 libra në gjuhën shqipe. Si rezultat i aktivitetit të kësaj veprimtarie, u hap gazeta “Drita” dhe një sërë shkollash në gjuhën shqipe në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Edhe pse mjaft të kushtëzuar për shkak të qëndrimit refraktar të pushtetit perandorak ndaj çdo tentative për shtrimin e çështjes shqiptare, për shkak se Perandoria Osmane e shihte çështjen shqiptare si çështje të mbyllur për shkak të islamizimit të shqiptarëve, kjo elitë shkoi në mënyrë graduale drejt radikalizimit të qëndrimit të saj ndaj Perandorisë Osmane dhe u bë një nga komponentët e rëndësishëm të lëvizjes kulturore, politike për krijimin e shtetit të pavarur shqiptar.

për pavarësi kombëtare”, Dituria, 2006, f. 160.

5. Bartl, P. “Myslimanët shqiptarë në luftën

Zani i Naltë: model etik dhe përgjegjës në komunikimin fetar shqiptar.

Botimi i “Zani i Naltë” në vitin 1923 përkon me një fazë të rëndësishme të shtetit shqiptar dhe komunitetit mysliman shqiptar. Në këtë vit shoqëria shqiptare e organizuar nën shtetin shqiptar dhe jashtë kufijve të tij po kalonte një fazë delikate e të rëndësishme të historisë së tij. Pas gati një dekade prej themelimit të tij në vitin 1912, periudhë e mbushur me rreziqe për ekzistencën e shtetit të ri shqiptar, por edhe me dështime, shteti shqiptar po kalonte një proces të vështirë stabilizimi, proces ky i rrezikuar tashmë jo nga faktori i jashtëm, por nga tensionimi i faktorëve të brendshëm. Ndërkohë që komuniteti mysliman shqiptar në të njëjtën periudhë po kalonte një proces gjithashtu historik: riorganizimin si komunitet mysliman shqiptar autonom. Studiuesi Ali M. Basha në librin e tij “Islami në Shqipëri gjatë shekujve”, thotë se “qysh në vitet 1916-1917, ndonëse periudhë lufte, u bënë disa hapa të rëndësishëm për organizimin dhe strukturimin e fesë islame në vendin tonë”.⁶ Në vitin 1923, më 24 shkurt, u mbajt Kongresi Mysliman Shqiptar, i cili *de facto* shënoi krijimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar të

shkëputur nga Kalifati i Stambollit një vit para se parlamenti turk të merrte vendim për dhënien fund të Kalifatit të Stambollit në vitin 1924.

Ky akt i përgjigjej jo vetëm një nevojë të brendshme organizimi të myslimanëve shqiptarë, por edhe vetëdijes, përgjegjësisë dhe luajalitetit ndaj shtetit të ri shqiptar dhe shoqërisë së re. “Zani i Naltë”, që me themelimin e saj në vitin 1923 dhe gjatë gjithë veprimtarisë së tij, përmbushi pikërisht këtë nevojë dhe këtë përgjegjësi. Ai që dhe vazhdon të jetë një instrument i rëndësishëm komunikimi për bashkësinë e besimtarëve myslimanë shqiptarë dhe një zë i respektuar në shoqërinë shqiptare. “Zani i Naltë” i ka qëndruar besnik programit të shpallur që me themelimin e tij. Ky program konsistonte në këto pika:

M’e bashkuem në një trup të fortë e të qëndrueshëm popullin Mysliman shqiptar.

Me përmirësuar gjendjen e vakufetve, Xhamijave, Mesxhiteve, të Medresevet, të Teqevet e të tjera instituteve të Mysliman të kësaj soji.

Me ia zbuluar popullit Mysliman shqiptar të vërtetat e besimit në një mënyrë të thjeshtë e të panerlikuem, tue i a ngrohun këtij zemrën në dashtni për këto të vërteta.

Si mbas statutit me plotsue vllaznin ndërmjet të gjithë elementeve në Shqipëri.

Me këto miete mandej me forcuar edhe themelet e një politikës

6. Ali M. Basha, “Islami në Shqipëri gjatë shekujve”, Tiranë, 2000, f. 116.

së shëndoshë e fjesht kombëtare në shtetin tonë.⁷

Gjithë koleksioni i pasur i kësaj reviste ndër vite dëshmon pikërisht realizimin hap pas hapi të vizionit që kanë pasur themeluesit e saj në fillim të jetës së revistës, besnikërinë ndaj këtij vizioni.

Si instrument komunikimi revista është një model mjaft i mirë i komunikimit efikas fetar në Shqipëri. I mbështetur në fjalën e tij, besimi ka institucionet e veta: librat e shenjtë, institucionet e kultit dhe më vonë mediat. Libri dhe shtypi i shkruar si formë e përhapjes së besimit janë përvetësuar shumë shpejt nga institucionet fetare. Komuniteti Mysliman Shqiptar, si komunitet fetar, e nis jetën e tij duke i dhënë një rëndësi të veçantë shtypit si element efikas për përhapjen e besimit dhe di ta përdorë atë me efikasitet. Shndërrimi i diskursit religjioz në një diskurs mediatik realizohet në mënyrë mjaft efikase të “Zani i Naltë”. Mes revistave fetare të botuara në Shqipëri ai përbën një model më vete. Besimtari mysliman, por jo vetëm ai, komunikon me institucionet e tij në mënyrë të ndërmjetësuar përmes mediave me një gjuhë që është e tija, pra e thjeshtë, e kuptueshme, por jo e thjeshtëzuar. Është një komunikim që krijon njëherësh vetveten si kod komunikimi dhe komunitetin

e përdoruesve të këtij kod, komunikuesit besimtarë. Por nga ky këndvështrim, “Zani i Naltë” përbën një model mjaft interesant studimor.

Por revista “Zani i Naltë”, si dhe një pjesë e mirë mediave fetare në Shqipëri, paraqet një simbiozë mes botës së kulturës dhe botës së besimit. Kjo revistë shndërrohet në një instrument të rëndësishëm jo vetëm komunikimi religjioz, por edhe në një forum kulturor. Si revistë fetare, asaj i duhet të përballojë sfidën e shekullarizimit dhe të laicizimit të kulturës, trend ky mbizotërues në kulturën e shekullit të njëzet. Ky trend me anët pozitive dhe negative të vetat (sipas këndvështrimit), ka sjellë një delegitimim të përmbajtjeve fetare në produktet kulturore, madje në ekstremin e vet shkon deri në paradoks: kundërvënien mes fesë dhe kulturës, a thua se prania e njëres përjashton automatikisht tjetrën, a thua se besimi nuk është pjesë e sferës së kulturës së përgjithshme të njerëzimit. “Zani i Naltë”, si revistë fetare, është natyrshëm kundër një trendi të tillë, ashtu sikurse janë të gjitha revistat fetare pavarësisht besimit që i përkasin. Ajo mban gjallë një koncept kulturor për botën, një mënyrë të vështruarit të botës dhe trajtimi të dukurive të saj nisur nga këndvështrimi i besimit islam. Ajo i pasuron këndvështrimet për botën me këndvështrimin e saj dhe me këtë u shërben si besimtarëve myslimanë shqiptarë, ashtu edhe kulturës shqipe.

7. Zani i naltë, nr. 1, Tetor 1923, Tiranë, f. 5-6.

Por, dhe këtu, ajo shfaqet si model etik. “Zani i Naltë” e nxjerr zërin e saj, jo “nalt” në kuptimin e tonalitetit, jo ekskluzivisht, jo agresivisht. Ajo është e vetëdijshme për një realitet multikulturor, multifetar, për një realitet plural nga pikëpamja e ideve dhe këndvështrimeve. Ajo zgjedh rrugën e respektit për këtë realitet. Pikërisht mbi këtë vetëdije ndërton një model etik që e respekton “zanin” e të tjerëve. Një model i tillë që e respekton zërin e tjetrit në komunikimin mediatik shqiptar dhe në hapësirën tonë publike

mbështetet jo në hipokrizinë, as në “tradhtinë” ndaj besimit tënd. Ajo mbështetet në kurajën qytetare, në besimin e thellë, në kulturën e vërtetë. Nisur nga një praktikë sociale e ndërlikuar, ajo shkon drejt një modeli etik të komunikimit ndërreligjioz. Kontributi i “Zani i Naltë” për ndërtimin e këtij modeli është i rëndësishëm dhe tashmë përbën një traditë që duhet njohur dhe ndjekur. Botimi i plotë i koleksionit të kësaj reviste i shërben pikërisht këtij qëllimi.

Hafiz Ymer Shemsedini - Mësues i Gjuhës Shqipe, i Islamit dhe i atdhetarizmit në Kosovë e më gjerë

Me rastin e 120 vjetorit të lindjes - 70 vjetorit të vdekjes
(1895- 1945)

Prof. dr. Musa Kraja

Abstrakt

Hafiz Ymeri i Kosovës është një nga ata personalitete të shquara shqiptare që shkriu në një mbrojtjen e fesë islame, mbrojtjen e gjuhës shqipe, luftën për liri, luftën kundër denacionalizimit të Kosovës, dhe propagandën e veprimtarinë kundër shpërnguljes së shqiptarëve. Ai ishte imam, por ishte edhe mësues i mirëfilltë i shqipes, sepse hapi shkollë shqipe të drejtpërdrejtë në fshatin Sazli, për të cilën, pas tri javësh provoi edhe zinxhirët e burgut bullgar, por, mbeti mësues i shqipes, i fesë islame dhe i atdhetarizmit në drejtimet e tjera që do t'i parashtrojmë më poshtë.

Jeta e Hafiz Ymerit përveç detyrës së tij në xhaminë e emëruar të Talinocit si imam, së cilës iu përkushtua aty dhe kudo ku shërbeu me xhematin e tij e më gjerë, është e ngarkuar me veprimtari arsimore me të vegjël e të mëdhenj, duke shfrytëzuar hapësirat e mundshme si mësues i gjuhës shqipe, në mënyrë të organizuar, si poet me ndjenja të theksuara atdhetarie, si veprimtar i paepur i çështjes kombëtare.

Formimi i tij si atdhetar vjen e rritet nga shqetësimi për copëtimin e keqtrajtimin e bashkatdhetarëve të shpërndarë, sa me serbët, sa me bullgarët, sa një krah e në një tjetër. Situata denigruese nga pushtuesit e mjedisit ku jetoi Hafiz Ymer Shemsedini, u përballua me dinjitet prej tij, me mbështetjen që pati dhe me ndikimin e drejtpërdrejtë jo vetëm nga daja, Haxhi Pllana, personalitet i nderuar në Prishtinë e më gjerë, por edhe nga kontakti i vazhdueshëm

me Haxhi Mulla Ahmet Markoçin e Prishtinës, atdhetar, pedagog i shquar i Medresesë. Shemsedini karakterizohet nga një vullnet titanik për studime, kryesisht si autodidakt me objektiva të qarta personale, për të arritur në nivelin e hafizit, deri sa arriti të mbrojë këtë titull të nderuar publikisht, çka përbën një ballafaqim të hapur të nivelit të tij me kërkesat e arritjes së standardit për këtë titull. Ne mbrojtjen që bëri publikisht për t'u bere hafiz, në Xhaminë e Boshnjakëve, ishte në komision edhe Shaban Sheqeri -Vata, që më vonë do të shpallet profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Veprimtaria pedagogjike e Hafiz Ymerit, ashtu edhe ajo e fushës së krijimtarisë letrare, është studiuar nga Dr. Muhamet Pirraku, duke na dhënë një pamje të mirë të portretit të tij atdhetar e pedagogjik në dobi të Kombit Shqiptar, e cila meriton një studim edhe më të plotë. Edhe Prof. dr. Hajrullah Koliqi, në veprën e tij madhore “Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar”, Prishtinë 2013, botim i dytë, i kushton një vend të veçantë këtij personaliteti, duke nënvizuar mes të tjerash se Hafiz Shemsedini bashkëpunoi me Mulla Rexhep Krasniqin, me mësuesin shëtitës Vesel Pagarusha, me Mulla Rexhep Shalën etj, në disa drejtime të dobishme atdhetare, por ne po nënvizojmë me shkas në këto përvjetorë të lindjes dhe të ndërrimit të jetës disa drejtime me karakteristike:

Si mësues i mirëfilltë i gjuhës dhe i shkollës shqipe

Dihet që në periudhën e pushtimit austro-hungarez, për arsye të njohura të strategjisë së pushtuesit, si kundërvënie e synimeve sllave, italiane e greke, por edhe për të forcuar më tej edhe ndikimet e veta, atdhetaret tanë e shfrytëzuan me mjeshtëri këtë konjunkturë të favorshme për përhapjen e zhvillimin e shkollave shqipe në hapësirën shqiptare, duke qenë edhe atëherë e sot, mirënjohës Austrisë, për ndihmën që dhanë jo vetëm në lejimin e shkollave shqipe, por në shumë raste edhe në mbështetjen e tyre financiare, etj. Veprimtaria aktive e Luigj Gurakuqit, Mati Logorecit, Sotir Peçit, e mësuesve të tjerë atdhetarë, u ndje me rrezatim të dukshëm në disa zona të pushtimit austro-hungarez, ku u hapën disa dhjetëra shkolla në gjuhën shqipe. U këmbëngul që të zbatohet një tolerancë e plotë fetare, duke lejuar zhvillimin e fesë si lëndë më vete e me mësues të veçantë. U respektuan e u shpallën ditë pushimi të gjitha festat fetare, pavarësisht nga besimet. U bënë përpjekje për vëllazërimin e shqiptarëve me besime të ndryshme. Përpjekja për njësimin e gjuhës shqipe nga Komisia Letrare, me një veprimtari të gjerë në botime tekstesh shkollore, në përpjekje për pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja e të panevojshme dhe në pasurimin e saj me fjalë e frazeologji të re shqipe e

materiale të tjera në gjuhën amtare, ndonëse në një terren të kufizuar, të pushtimit austro-hungarez, pati ndikim edhe frymëzim, gjithashtu, edhe pse në rrethana të tjera, për zhvillimin e kësaj përvoje edhe në hapësirat shqiptare, sidomos në Kosovë.¹ Kjo situatë ndikoi edhe si nxitje nga morën frymëzim edhe të tjerë mësues e teologë atdhetarë përtej kufijve të copëtuar. Kjo erë e mirë për arsimin u ndje shpejt nga Hafiz Ymeri, dhe tek mësues e teologë të tjerë shqiptarë në Kosovë, i cili shpejtoi ta përqafojë duke hapur shkollën shqipe në Sazli, por, i ndodhur jashtë territorit të zyrtarizuar për hapjen e shkollave shqipe, ndeshi në dhunën bullgare, sllave dhe vuajti në prangat e burgut të tyre. Ishte ndërhyrja e Haxhi Pllanës, që Hafiz Ymeri të mos qëndronte gjatë në burgun e Ferizajt.

Në fund të viteve '20 u emërua imam në xhaminë e Talinocit, ku vinin besimtarë nga Sazlia, Biba, Pojatishta, Softoviqi, Papazi, etj, tek të cilët u ngjall edhe më tepër vlerësimi e interesimi për mësimin e rinisë në gjuhën shqipe. Xhemati i tij ishte shumë aktiv në veprimtarinë politike e kulturore, duke i kushtuar rëndësi edhe arsimit të rinisë në gjuhën shqipe ilegalisht, nën ombrellën e mejtepit zyrtar, që funksiononte legalisht. Në

vitin 1934 xhemati i Sazlisë dhe i fshatrave të tjerë përreth, i ngritën një dhomë për mejtep që të mësonin fëmijët djem e vajza, i cili do ta vazhdojë funksionimin e vet deri në vitin 1941, kur do të shpartallohej Jugosllavia versajase. Ndonëse ishte shkolle “turke-muslimane zyrtare”, mejtepi i Sazlisë përgatiti kuadro për veprimtari kulturore e kombëtare të gjithanshme. Atje, krahas shkrim leximit arabo-osman, pjesës më të madhe të nxënësve të vullnetshëm, Hafizi ua mësoi edhe shkrim leximin në gjuhën shqipe, kurse krahas mësimave fetare, zhvilloi edhe njohuri mësimore nga dijenitë e shkencave natyrore e historike. Mejtepi i Hafiz Ymerit i dha produktet e veta të rëndësishme, sepse përgatiti kuadër të aftë për administrator dhe vazhdues të punës në shkolla shqipe, të cilët vlejtn aq shumë për periudhën e Luftës së Dytë Botërore², kur në disa vise të hapësirës shqiptare, u hapën kurse dhe shkolla shqipe, si dhe administratë shqiptare.

Në vitin 1937 ishte një ndër bashkëpunëtorët e shoqatës “Drita”, me Mulla Rexhep Krasniqin, me mësuesin shëtitës Vesel Pagarusha dhe Mulla Arif Shalën.

Nëpërmjet lidhjeve që kishte me shqiptarët në Shkup, ai siguronte libra shqip për shkollat në gjuhën

1. Prof. as. dr. Ilir Kanini: “Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës I-rë Botërore, f. 28.

2. Dr. Liman Rushiti: Informacione të mbledhura në Sasli, Mejtepi i Hafiz Ymerit, Sasli, 24-3-1978.

shqipe, si dhe për lëndë të tjera, libra letrarë, historikë, etj.

Ai ishte mësues edhe me veprën e tij letrare e kombëtare. Punoi me nxënësit e tij dhe me të rriturit për mësimin e shkrim leximin në gjuhën shqipe me alfabetin latin të vendosur në Kongresin e Manastirit.

Edhe pse në disa zona ishte koha e ndalimit të gjuhës e letërsisë shqipe, Hafizi nuk u frikësua. Mësimet kuranore i shkroi në gjuhën e popullit, të kuptueshme e të qartë. U mbajtën ligjërata në bazë të shkrimeve të përdorura si doracakë shkollor.

Pushteti jugosllav nuk kishte besim në myftinj të imamët shqiptarë, të cilët kishin një shtrirje të gjerë me 50 myfti e 600 imamë shqiptarë në Kosovën e vitit 1923, edhe pse shumica e tyre nuk e zotëronin gjuhën serbe i trajtonte me idenë se “të gjithë janë të edukuar në frymën armiqësore ndaj shtetit tonë”³. Prandaj më vonë i mbyllën të gjitha mejtepet, duke lejuar një medrese, ndërsa në shkolla vendosi të zhvillohej lënda e mësimin të besimit.

Hafizi ishte i njohur njëkohësisht edhe si një ndër rapsodët e instrumentistët më të shquar të Kosovës së viteve 20-30 të shekullit XX. Në festa e ngjarje të shënuara, Hafiz Ymeri me çiftelinë e tij

këndonte këngë atdhetarie, historike të krahinës e mbarë viseve shqiptare. I këndoi akteve të trimërisë, plagës së mërgimit, duke vënë në melodi edhe vargje të poezive dhe të poemës së tij “Nazim Gafurri”, duke krijuar emocione te dëgjuesit e shumtë, të cilat ndikonin dukshëm në ndjenjat e tyre atdhedashëse, në zgjimin e konsolidimin e tyre.

Vepra e tij, poema “Nazim Gafurri”, është nga më të njohurat krijime letraro -historiografike në Kosovën e mes dy luftërave botërore. Studiuesi i njohur Muhamet Pirraku e ka quajtur këtë personazh, në një artikull të botuar në “Dituria Islame” në Prishtinë, pikërisht në vitet 1990, vit tronditjesh të forta politike, “Shëmbëlltyrë e ndritshme e historisë kombëtare shqiptare”.

Së dyti, motivet atdhetare ishin frymëzimi parësor i Hafiz Ymerit. Të mbrosh fenë islame, për kohën e poetit, ishte luftë për Kombin Shqiptar⁴, ta mbrosh gjuhën shqipe ishte heroizëm kombëtar, të përpiqesh për lirinë, ta ndihmosh rezistencën shqiptare kundër denacionalizimit të Kosovës, kundër shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet e veta, siç synonin serbët, luftë atdhedashëse, ishte sakrificë dhe heroizëm kombëtar. Në krijimtarinë e tij letrare, që zuri vend edhe në brendinë e shkollave të kohës,

3. Prof. dr. Hajrullah Koliqi: “Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar”, Prishtinë, 2013, f. 401.

4. Mbështetur në studimin e dr. Muhamet Pirrakut, botuar në Drita Islame, Prishtinë, 1992.

bashkëpunoi shumë ngushtë me Rizah Strelin.

Rapsodi Rizah Strelin, krijues i talentuar i shkollës së Hafiz Ymerit dhe Mulla Veysel Xhelaudin Gutës, e shoqëroi shumë herë. Ai shkroi vargje kushtuar Hafiz Ymerit:

“T’falem nderës Hafiz i jonë,
Gjith rinis i ke ndihmue,
Gjith kur folshim për guhë tonë,
fjaltë e tona i ke forcue...”

Në mejtepet ku jepte mësim Hafiz Ymeri në mes të dy luftërave botërore, përkraheshin dy sistemet e shkrimit për shqipen, shkrimi arab për lëndët mësimore fetare dhe shkrimi latin për lëndët shoqërore, gjithnjë kjo e dyta zhvillohej ilegalisht, nën ombrellën e shkollës fetare.

Hafiz Ymeri vazhdonte të punonte me përkushtim për Shqipërinë e plotë dhe nuk u josh asnjëherë ndaj synimeve ideologjike sllave e të tjera, aq shumë të interesuara për copëtimin dhe shkombëtarizimin shqiptar. Ai kishte për ideal Shqipërinë etnike dhe nuk u pajtua asnjëherë me lëshimet as koncensionet ideologjike. Vdiq në moshën 50 vjeçare, në vitin 1945.⁵

Hafiz Shemsedini ka hyrë me dinjitet në radhët e teologëve më të shquar shqiptar në Historinë e Arsimit e të Shkollës Shqipe, që, krahas detyrës fetare, ka kryer

me përkushtim të veçantë edhe detyrën atdhetare të ushtrimit e të mësuarit në brezat e rij, në kushte terrori të egër e gjenocidi barbar të gjuhës e leximit shqip, si themele të etnisë, identitetit tonë për brezat e rinj, duke përdorur me mjeshtëri edhe artin muzikor kombëtar, që ndikoi aq shumë në emocionet e nxënësve dhe të rriturve, në krijimin e konsolidimit e ndjesive, bindjeve atdhetare të bashkatdhetarët e vet.

Shënime për jetën

Hafiz Ymerikalindurnë Prishtinë më 1895 në një familje hoxhallarësh. Babai, Shemsedini ishte imam në një xhami të Prishtinës, i cili shquhej për ligjëratat që mbante para nxënësve në mejtep, derisa vdiq në vitin 1903. I mbetur jetim, Ymeri u rrit dhe u edukua nga daja Haxhi Pllana, hoxhe me një autoritet të madh në popull dhe në organet shtetërore. Daja u bë mësuesi kryesor i nipit, duke e bërë të interesuar për njohuri të thelluara filozofike e islame, dhe e formoi me ndjenja e edukatë humane dhe atdhetare. Hafiz Ymeri mësoi mirë shkrim e lexim shqip me alfabetin e Manastirit dhe u njoh mirë me letërsinë e Rilindjes sonë Kombëtare. Ishte autodidakt. Studiues serioz i cili doli para komisioneve si imam. Në jetën familjare përjetoi vuajtje të pandërprera, i vdiqën fëmijët, etj. Vdiq 70 vjet më parë, në maj 1945, i ndjekur nga reaksioni serb, i dashur dhe i respektuar nga populli.

5. Musa Kraja, “Mësuesit Për Kombin Shqiptar”, Toena, 1993, f. 369- 371, dhe 456.

Jeta e njeriut një udhëtim

Fehmi Xhepa

Njeriu prej natyre i kureshtuem, do me njoftë vedvedin, don me dijtë prej kahë ka ardhë, se ku do të shkojë, sendet që e qarkojnë, revolucionet e metamorfozet që ndodhin në çdo kand të rruzullimit; don me mendue fatin e mjerueshëm t' atyne zâmdhajvet që zbritën prej një madhniye të pa shoqe. Edhe tue i përshkue në mendje të gjitha këto sende, i vjen para syshë zhgatrimi, me të cini është i dënuem gjithçkahi në këtë jetë. Dridhet; se edhe vetë aj, është një ndër ata, mbi të cilët do të randojë pesha e atij zhgatrimi. Kështu në zemër të tij përtrihen mjerime e dishprime; e pa dyshim i dermohet zëmra prej këtyne mjerimevet, kur kujton se nuk dijtë kurgjâ mbi egzistencën e tij të vërtetë, kahë erdhi e ku do të shkojë e se s' fundit një ditë do të ngrijë mun si ato gurët që ka përpara syvet; pse shpirti don me qenë gjithmonë, don me jetue gjith-herë.

Koha e gjallnis së tij me gjith të qeshmet e të qamet, gzimet e hidhrimet, veprat e Shkencës e të civilizimit, gjithë bukurit e natyrës e t' artit, një ditë do të çduken. Me një herë ti o njeri, ja nis udhëtimin drejt kah një botë e përhershme! Të duket se e trashigove këtë Botë, nis të shijojsh bukurit, stolit e mirsit të dhurueme nga një Bamirës, që shpesh herë E harron, ja nis punës, ngreh pallate, permirson rrugë, godit bulevarde dhe dikur arrin kulmin!

Po gjith këto faza të jetës po t' i vërmë me kujdes, shofim se nuk vijnë mâ! I ngjanë një udhëtimi në detë, që një tallas po t' i delte para, ja humbte rrugën e mâ në fund i shkaktonte humbjen. Gjithashtu jeta është si një udhëtim naltë një kodre, plot vujtje, plot mundime, plot rreziqe e fundi i fundit e mbaron udhën, i sos vujtjet, rreziqet e mundimet. E tash ku do të shkojë? A e mbaroj udhën? Po udhëtimin e kësaj jete e mbaroi dhe tash j'u nis një udhëtim

tjetër, udhtimit të Amshuem! Por për të shkue n' at udhtim, ti o njeri, duhet qi të jeshë i plot; sepse njeriu i plotsuem e i persosun e din jetën e vdekjen; e din gjithësinë dhe të vërtetën e saj, e din nga ka ardhë e pse ka ardhë në këtë botë; e din dhe se ku do të shkoje, mbasi të ndahet nga kjo botë. Duhet t' a dijshtë se atje kanë me t'u pa veprat e tua. Gjithashtu duhet t' a dijshtë se për të fitue atë botë lypset të bâjshë një luftë shumë të madhe me vetvehten t' ande, se, për ndryshe, s' ke me j' a mbrri qëllimit, s' ke me fitue gradda të nalta e të lumnueshme, për realizimin e të cilave je krijuar!

Pregadit-iu pra, o njeri, asaj bote të perhershme, sikur pregatitet mysafiri për me shkue ke miku!

Me një fjalë njeriu nuk bâni tjetër veçse përshkojti në këtë jetë, e, mandaj, si vesa para diellit, u çduk, tue lânë mbas shpine dashtunin e flakët të nanës, të babës, tue lânë

motër, tue lânë vëlla, të cilët tue u dá për herë të fundit e përshëndetën, e puthën edhe ky u dha lamtumirën e fundit, për të mos jetue mâ, për të mos shijue mâ diellin e begatshëm për të mos pá mâ bekimin e nanës, dhe ndoshta me të mbaruem udhtimin e përherëshëm e hedh fatkeqsija ose sjellja e tij në shpellë të trishtueme e të frikshme, mbrenda së cilës shef e ndigjon mundime e rrënkime të mdhaja!

Pra, në këtë botë nuk paska tjetër, veçse humbet rinija, humbet trimnija e fuqija, humbet drita e syvet e mâ në fund, për mâ të madhin fat të zi humbet edhe jeta! Mos të harrojmë se pasunija e humbun mund të fitohet përsëri tue punue; shëndeti mund të fitohet me kujdesje, mësimet mund të fitohen tue nxanë, porse koha e humbun nuk fitohet mâ!¹

1. Marrë nga revista "Zani i Naltë", nr. 12, viti XIII, dhjetor 1938, f. 370 - 371

E vërteta triumfoi mbi të kotën...

25 vjet liri besimi

Rihapja e objekteve të kultit pas ndalimit 23 vjeçar të lirisë së besimit, përbën një nga momentet kulmore të historisë, e tejmbushur me data e

përkatëse. Por, përveç rëndësisë së kësaj ngjarjeje, ajo që përbën një vlerë unike, shembull të bashkëjetesës fetare në qytetin e lashtë, është fakti se në rihapjen e këtyre objekteve,



ngjarje me dhe pa rëndësi. Shkodra, qyteti i vlerave të shumta, do t'i printe këtij veprimi të guximshëm për kohën dhe do të sfidonte diktaturën, duke rihapur pas 23 vitesh objektet e kultit dhe duke zhvilluar ritualet

përkatësisht më 11 dhe 16 nëntor 1990, morën pjesë besimtarë të të gjitha feve, që punuan së bashku për të rivënë në funksionim objektet fetare të mbetura nga shkatërrimi ateist. Asnjëherë dhe në asnjë rast,

qytetarët shkodranë nuk kishin qenë aq të bashkuar pavarësisht besimeve fetare, për një qëllim, sfidimin e frikës së diktaturës dhe rikthimin legjitim të lirisë së besimit dhe ushtrimit të saj.

16 nëntor 1990, te Xhamia e Plumbit

Xhamia e Plumbit përgatitej prej pesë ditësh, që të premten e 16 nëntorit, të bënte faljen e namazit për të gjithë qytetarët, që pa dallim feje do merrnin guximin ta ndiqnin këtë ceremoni. Kjo ditë nuk erdhi rastësisht. Ishin dëshirat dhe ëndrrat e një populli, të ndrydhura e të heshtura, që u përpinë me vrull. Rinia shkodrane, duke marrë bekimin e prindërve dhe të moshuarve iu përvesh punës. Do të ishte kleriku i njohur e i nderuar mysliman, 69-vjeçari Haxhi Hafiz Sabri Koçi, i burgosur për shumë vjet nga regjimi komunist, ai që do të mbante predikimin dhe do të falte xhumanë pas 23 vitesh heshtje. Në shtëpinë e familjes Myftia, u bënë shumë takime nga rinia dhe besimtarët e vjetër shkodranë. Kjo familje me tradita të vjetra kulturore, fetare dhe atdhetare, nga gjiri i së cilës kishin dalë prijës të nderuar të besimit mysliman, në ato ditë të vështira, kur diktatura komuniste vazhdonte krimet e saj, pa marrë parasysh rreziqet, priti me bujari Hafiz Sabri Koçin. Të rinjtë, për siguri nga ndonjë incident i organizuar apo dhe i rastit, e morën Hafizin natën, pa gdhirë, dhe e çuan

në shtëpinë e familjes së nderuar Myftia, pranë xhamisë. Djemtë e kësaj familjeje e shumë qytetarë të tjerë e përcollën përmes popullit deri në tribunën e ngritur para Xhamisë së Plumbit. Dëshmitarët e asaj kohe kujtojnë se si pak çaste para fillimit të ceremonisë, Hafiz Sabri Koçi kërkoi që një djalë i ri duhet të hapte këtë ritual dhe t'ia jepte fjalën atij. Rasim Sokoli ishte ai që mes njerëzve të mbledhur, thirri një djalë, Ardian Golemin, i nipi i Haxhi Hafiz Abaz Golemit, dhe bashkë me të dhe Hafiz Sabri Koçin, hipën në tribunë, ndërsa i gjithë sheshi para xhamisë ishte mbushur si asnjëherë. Atë ditë e gjithë Shkodra ishte në këmbë. Që në orët e para të mëngjesit, njerëzit lëviznin nga të gjitha drejtimet: nga ura e Bahçallëkut, nga ura e Bunës, nga Tophana, nga Parruca, nga Perashi, nga Tepja dhe Ajasma po grumbulloheshin në sheshin e Xhamisë së Plumbit, në oborret e shtëpive. Lajmi ishte përhapur në çdo familje, në heshtje, dhe tashmë ishte fakt i kryer. Besimtarët myslimanë dhe bashkë me ta qytetarët shkodranë pa dallim feje, do i riktheheshin riteve fetare. Hafiz Sabri Koçi në një prej intervistave të tij kur ishte gjallë, shprehet se, “duke kujtuar të gjitha vuajtjet e mundimet nuk kisha se çfarë të humbja. I përkrahur nga djemtë dhe i ftuar nga rinia e mrekullueshme shkodrane, unë e ndieja veten superior ndaj atyre që duhej të kisha

frikë. Dita e 16 nëntorit do të mbetet e paharruar në jetën time. E kam të freskët momentin kur u ndodha para një mitingu prej 55 mijë vetësh. U entuziazmova dhe m'u deshën disa çaste për të më kaluar emocionet. Nuk përshkruhet gëzimi e kënaqësia e asaj dite”.

Ceremonia e 16 nëntorit 1990 nuk qe thjesht ceremoni fetare. Ajo krahas vlerës së vet të ringjalljes së fesë, mori një karakter të hapur politik. Ndërsa mitingu madhështor përfundoi dhe njerëzit po shpërndaheshin duke mbajtur me vete gëzimin e harenë e asaj dite të madhe, në Xhaminë e Plumbit u organizua një mbledhje e vogël nga përmasat, por me një rëndësi të veçantë historike për të ardhmen e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Në këtë mbledhje, si të thuash në ilegalitet, u vendos krijimi i “Bashkësisë Islame Shqiptare”, me qendër në Shkodër. U zgjodh kryesia e përbërë nga 20 anëtarë të përkohshëm. Menjëherë, pa humbur kohë, Shoqata hartoi 3 dokumente themelore:

1. Kërkesën për të miratuar institucionin “Bashkësia Islame Shqiptare”.

2. Statutin e “Bashkësia Islame Shqiptare”.

3. Programin e veprimtarisë së bashkësisë.

Realizimi i këtyre detyrave, i statutit dhe i programit, filloi menjëherë, pavarësisht nga vështirësitë e shumta, pa pritur miratimin e shoqatës. Ashtu si në meshën e parë të mbajtur në varrezat e Rrmajit, më 11 nëntor 1990, edhe në ceremoninë e organizuar në Xhaminë e Plumbit më 16 nëntor, morën pjesë pasues të të gjitha besimeve. Ato ishin shenjat e para se Shqipëria po hapej dhe se komunizmi po rrënohej. Këto dy data kujtohen çdo vit nga shqiptarët, si ditët që jo vetëm rikthyen lirinë e besimit dhe shënuan rihapjen e institucioneve fetare pas 23 vitesh, por treguan edhe bashkimin e qytetarëve shqiptarë pa dallim feje. Prej asaj dite për shqiptarët do të hapej një dritare e re shprese dhe jeta shpirtërore do të merrte një hov të jashtëzakonshëm.

Abstracts in English

Studies

1. Beyond the three-dimensional “cage”...

Blerim Lazimi

Physics teacher at “Said Najdeni” High School, Peshkopia

Abstract

Apparently, mathematics itself (along with the physics) proves the existence of the human soul. Since its birth as a science, it continues to be developed and enriched with a high degree of abstraction, which is not a quality of matter (objects or human body). This high degree of thinking, intuition and abstraction, is explained and has its impetus on the presence of the spiritual element in the nature of human beings. Each tree has its fruits. Mathematics is one of the fruits of the spirit. And further: “Geometry is a science.” Its truth reaching the God’s Names Adl (the All-Right) and Mukaddir (the Perfect Determinant) reflects in its full splendor in the geometric mirror the All-Wise shows of the Name Allah.

2. Albania, an example of religious coexistence in Europe

Bishop Luçjan Avgustini

Milan, July 2, 2015

Abstract

“Both the new and the old Albania is characterized by good relations between faiths. Tolerance and religious harmony is the greatest value of Albania and this is not just something proverbial. Albanians managed to face Holocaust. After World War II Albania was the only country where the number of Jews was almost 10-folded. Despite in Albania there are 4 religious communities and we are not known as quiet people, we have never experienced religious conflicts. 2 brothers, one Muslim and the other Catholic lived under the same roof.”

Ismail Kadare

3. Omar Khayyam, the poet who made mathematics rhyming Redi Shehu

Abstract

Many of us, when it comes to Omar Khayyam (1044-1123), immediately fall prey of the traditional association of his name with poetry and possibly the famous Rubaiyat, but in fact, the existence of his personality in the history and culture the Orient and the West relates above all to his being as a prominent scientist, mathematician and astronomer. Thus his contribution in the ages and cultural currents exceeds the limits of popular poetry and lies in an ocean of knowledge and irreplaceable contributions in these fields, becoming one of the great colossus that resisted to the times.

History

4. “The Mirroring of Independence Anniversaries in the religious Catholic and Islam press 1913 – 1944”

Ma. Gazmend Leçini

Abstract

According to the media articles published in the religious press during the period from 1913-1944, one can notice that clerics of all faiths and religions have strongly contributed in the proclamation of independence. Foreign scholars, some also motivated by aims linked to eventual annexation of Albanian territories by their neighbours, considered impossible the option to have Albanians unify in one state, due to their religious diversity. Theories to have one religion dominate on the others in order to produce internal stability have also been raised.

The commitment of clerics from all religions to the benefit of the country is a clear indicator that the notion of faith and the national identity have not excluded or overlapped each-other, but the country has been enjoying a mosaic of identities, where every single individual was not shading the others – in a situation that if different faiths are equally treated, there is room for every one of creeds.

The contribution of these patriot clerics to the benefit of the country has been present along the entire period when this press enjoyed its public, inspiring its readers with the national spirit and the respect for the state institutions. This press – thanks to its publications, helped Albanians pave and fade away any hatred or phobia among different religious believers and followers. This is one of the key values that turn us proud today as well. It was thanks to this patriotic clergy that such a value was endorsed and inherited as a national identity feature.

Almost all the organs of this religious press preferred to use historic articles in order to evoke the Independence Proclamation event, recalling details of the date where love to Fatherland and sacrifice are heartedly highlighted.

These magazines, although being religious, have not been limited to theology articles only, but pressed to publish Poems, Narrative (short stories), studies of different aspects, which turned these magazines in the elite of the timely press.

I wish that the spirit of respect towards each other, the demonstrated comprehension and the posing of national interest in front of any other interest – as the religious press showed in its publications during 1913 – 1944, be continued and enriched.

I hope that this research shall modestly serve this goal.

5. The views of Dr. Abdul Bey Frasheri and Ibrahim Temo on the reformation of Ottoman education system and foreign schools in the Albanian vilayets

Dr. Hasan Bello

Albanological Studies Center, Institute of History – Tirana

Abstract

At the opening speech of the first Ottoman Parliament, Sultan Abdulhamid II (1876-1909) promised that in the context of reforms that he would realize, he would open a school for the senior staff training and within a year he would bring in parliament a new regulation on education. On the other hand, in the first Ottoman Constitution, which took effect in 1876, there were two articles (15 and 16) regarding education. This was an evidence of the seriousness and attention that officials of the Ottoman state, henceforth, would pay to the education issue. Among the managerial elite of the Ottoman Empire, spread of educational institutions was seen as a tool which would improve the economic situation of the Ottoman state. But above all, they understood that the implementation of reforms and modernization of the Empire required a specialized staff. This was also noted in the discussions that took place in Parliament on the legislation of vilayets and municipalities. The implementation of these laws, according to the majority of the deputies was conditioned by the educated employees and people who had a good level of literacy. These discussions highlighted the plight that existed throughout the Empire. Thus, Ajdin's deputy Ahmet Efendi, raised concerns that in the entire region he represented - except for the Imams - there weren't literated people.

Such a fiery speech was held on this issue by Abdul Bey Frasheri on behalf of Ioannina MP, on 14 January 1878. He started his discussion by asking: "What is it the cause of backwardness and underdevelopment of the Ottoman Empire, in the entire regions it owns in Europe, Asia and Africa? According to some hypothesis there are three main reasons for this: the first reason is the ignorance, the second one is despotism and the third reason is the inability of officials who are at the helm of affairs, who are either engaged in entertainment or in vanities, but who bring no progress for the state and nation."

Language

6. Albanian language instruction during the Renaissance until the beginning of the 20's of the last century (First part)

Prof. dr. Njazi Kazazi

Department of Linguistics, University of Shkodra, "Luigj Gurakuqi"

Abstract

The various historical processes that occurred in the Middle Ages left deep traces in the development of culture and education in Albania. At these times it was occupied and because of foreigners assimilating objectives, the development of education in the Albanian language became quite difficult. In such conditions Latin in the North and Greek language in Southern Albania were both used as writing languages in Albanian territories. In the fifteenth century the Turkish-Arabic language became the official language, but it were also used Latin and Italian languages simultaneously. Although these languages penetrated one after another, they failed to get the status of spoken language by the people, thus their use was limited to the administration of the invaders, religious services and in their schools. At those times in the country only foreign schools were recognized as educational institutions. Albanian language apparently began to be taught later, but efforts to develop it through an original script may have started in the seventeenth century.

Literature

7. Independence in literary writings of Albanian scholars

Prof. dr. Hysen Matoshi

Institute of Albanology - Pristina

Abstract

In our history, very little could be learned about Hajji Vebbi Dibra, chairman of Elders in the first Government of Vlora, elected in the historic assembly of Albania's Independence proclamation. Our historiography has been more focused on who knitted the Albanian flag than who has been elected as chairman of the Elders, replacing Ismail Qemali, as a person who has been one of the most coupling figures of this assembly, whose decisions would result as a major turning point in the new history of Albania. Furthermore, beside the fact that this imam's precious contribution of a rare patriotism would not be properly evaluated in the extent he deserved during the Communist period, efforts to annihilate the documentary evidence of the Independence Assembly would be made through counterfeiting and retouching photos. In the margins of the Albanian historiography would remain, for example imam Kadri Prishtina, founder and chairman of the National Defence Committee of Kosovo, Mulla Idriz Gjilani, who has been the leader of national forces attempting to protect Kosovo's borders from Serbian Reconquista during

the end of World War II, etc. The nation put Ulama's of such a caliber at the forefront of the most important developments, but an evil and extremely ideological historiography, for decades excluded them from the pages of our history only because, conceptually they didn't accepted that notable figures of Islamic provenience having such a relevance, which they historically have had.

Philosophy

8. What would Hippocrates say?

Ilir Akshija, M.D., M.Sc.

University Hospital Center, "Mother Teresa", Statistics Department, Tirana, Albania.

Erion Akshija, M.D in Pharmacy.

Pharmacist at Lloyds Pharmacy, Bologna, Italy.

Abstract

Values are bound to actors. Ethical codes as value carriers find their application in distinct segments of society and the Hippocratic Oath has the same fate. We considered the old oath in connection to actors who promise to respect it and their entourage. Albania is specific and common simultaneously. A glimpse of our reality can be reflected in the way we manage ethical codes. The aim of the study was to analyze the oath in our reality as part of the whole from the perspective of a medical doctor to peers, patients and guarantors. We do not want to keep the old form, we want to keep the exotic expression of the old one, to use it in coherence with the modern world, to respect religious sensitivities and be specific to our country, which is the form of the oath to seek. Reviewing of the values in a rapidly changing society seeks continuous discussion or otherwise we compromise our position as neither modern nor archaic, at the risk to remain in an undefined situation. Some values are universal and others belong to a particular group. This diversity should be valued as a richness of assets and these assets must be exploited at the service of all. Demand for dealing with values requires at least determining and update of these values.

Keywords. Hippocratic Oath, Medical Oath, ethic, values.

Sociology

9. Tolerance and religious coexistence in Albania during 1912-45 (based on the practice and lectures of the clergy)

Ahmed Kalaja

PhD Candidate / European University of Tirana, Department of Sociology

Abstract

Religious coexistence is one of the most special values on the Albanian people's tradition. It is widely known that the Albanians are distinguished for these values and for an exemplary coexistence among believers of different faiths present in Albania, mainly Muslims and Christians. In this study we will try to treat the core of this phenomenon, the promotional roots of these values, considered from a previously untreated view, and trying to answer the questions: By what sources the religious coexistence in Albania stems? Who are the main promoters of this phenomenon? What has been the attitude of the religious clergy in Albania? Did imams and priests are promoters of tolerance and religious coexistence in Albania?

These are some of the questions answered in this modest paper, focusing on Clergy lectures, on how beautifully and how delicately they have addressed this issue in front of the believers or of the world.

During the most delicate moments of our national history, the leaders of the Muslim community, due to their undisputed reputation and influence in the population's majority, not only have promoted tolerance and religious coexistence, but also they have considered the believers of other religions as 'fellows', stating such a conviction in front of Muslim believers. These sermons have begun with Haxhi Vehbi Dibra, who was the first Chairman of Muslim believers and have continued with all clerics without exception to this day.

Unforgotten are also the sermons of priests: Fr. Gjergj Fishta, Fr. Shtjefen Gjeçovi or Metropolitan Visarion Xhuvani, to conclude with the pearls of the Orthodox priest Fan Noli, who astounded the world with his three speeches in front of the world leaders in the League of Nations, while being as a representative of all Albanian people though the Orthodox believers were only 20% of the population.

10. Religious tolerance in Kosovo Vilayet and the declaration of Albania's Independence (1908-1912)

Nuridin Ahmeti

Institute of Albanology – Pristina

Abstract

It is a common opinion of domestic and foreign researchers, that the epicenter of the Albanian uprising during 1908-1912 was in Kosovo Vilayet. As leaders of these uprisings some leading figures as Idriz Seferi, Boletini etc. were distinguished; leaders who among the closest collaborators had religious leaders of the time, for example Idriz Seferi, who had as his personal secretary an well-known imam from the suburbs of Gnjilane called Mulla Halimi. On the other hand, he collaborated with some Islamic leaders by involving them directly into battles against the Young Turks such as Mulla Sinan Maxhere from the district of Presevo and Mullah Idris from Gnjilane; imams who had a stable cooperation

with many Albanians priests of that region as Dom Mikel Tarabulusi, Dom Tadej Ivanaj etc., for a better outcome of the National Movement and their goals. A characteristic of this time in Kosovo Vilayet are some interfaith quarrels observed in Prizren and Djakovica, on certain days of the Islamic calendar such as a slaughtered pig head thrown into the mosque, in order to urge division between Muslim and Catholic population, but all this was avoided in the best possible way by the religious leaders of the time.

On this study, through documents and relevant literature we intend to highlight the role of religious tolerance on the one hand and the contribution of religious leaders in the National Movement of Kosovo Vilayet during the years 1908 - 1912 on the other.

“Christians and Muslims are inseparable Albanian brothers. We feel love for our Christian fellows because they are our brothers and it is impossible being divided. Let’s strive for their good as for ourselves ... to pursue a common path ... to show the whole world that Albanians, regardless of religion, are brothers as inseparable children of our beloved Albania.”

(Hajji ef. Vehbi Dibra)

Communication science

11. Zani i Naltë - an ethical model and responsible for Albanian religious communication

Prof. assoc. dr. Mark Marku

Abstract

The Albanian formula: the same God – the same homeland - different beliefs, was the challenge facing nation-building formula of the Albanians and it was embraced by the clerical elite of all faiths, despite hesitations, resistance or uncertainties it carried. The Muslim Clerical, political and cultural elite is one of the originators and implementers of this formula. Historian Peter Bartl says, “There were precisely Muslim writers that can qualify as true nationalists who emerged as warriors of the Albanian national opinion. Through their writings during the Renaissance they exercised a great impact on the Albanian National Movement.”

Personalities

12. Hafiz Ymer Shemsedini - Teacher of Albanian language, Islam and patriotism in Kosovo and broader

On the occasion of the 120-th anniversary of birth and 70-th anniversary of death
Prof. dr. Musa Kraja

Abstract

Hafiz Umer of Kosovo is one of those outstanding Albanian personalities who combined the defense of Islam, the protection of the Albanian language, attempts for freedom, fight

against denationalization of Kosovo, and propagandistic activity against the expulsion of Albanians. He was an imam, but was also an authentic teacher of the Albanian language, because he opened a genuine Albanian school in Sazli village, for which he proved after three weeks the chains of Bulgarian prisons. Despite this, he remained a teacher of Albanian language, Islam and of patriotism in other directions that will explained below.

Retrospective

13. Human life - a journey

Fehmi Xhepa

Abstract

Man - inquisitive by nature - seeks to know himself; he wants to know where he come from, where he will go, things around him, revolutions and metamorphosis occurring in every corner of humanity; he wants to think about the miserable fate of those high-voiced people who descended from an incomparable majesty. Bringing in mind all these, he sees the decay by which everything in this word is sentenced. He trembles, because he is one of them on whom the weight of such decay will befall. Thus, despair and grief arouse in his heart and undoubtedly it burns out from these grieves when reminds that he didn't know anything about his true existence, where he come from and where he will go and one day, finally he will freeze exactly like those stones he has in front of him, because the soul wishes to live forever and to exist eternally.

14. The truth prevailed over falsehood ...

Abstract

Exactly as in the first Mass held in the cemetery of Rrmaj on November 11, 1990, the ceremony held in the Lead Mosque on November 16 was also attended by many followers of all faiths. These were the first signs that Albania was opening and communist regime was crumbling. These two dates are remembered every year by Albanian people, as days which not only restored the freedom of religion and marked the religious institutions reopening after 23 years, but they were also a demonstration of the Albanian citizens unity regardless of religion belonging.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.